


Llambi
Blido



SHËNIME
PËR PIKTURËN
DHE
SKULPTURËN

Artikuj, studime dhe ese



SHTËPIA BOTUESE
«NAIM FRASHËRI»

Redaktore
ISKRA THOMA

THJESHTËSIA DHE LARMIA E TRADITËS SONË NË ART

Kolë Idromenoja, Ndoc Martini, Odhise Pas-kali, Zef Kolombi, Vangjush Mio, Abdurrahim Buza, si dhe nxënësit e brezit të parë të tyre, krijuan atë traditë artistike të kultivuar në pik-turë dhe skulpturë, që shërbeu si pikënisje për artin tonë figurativ të realizmit socialist. Dashuria dhe respekti për historinë e lavdishme të atdheut, përjetimi i halleve, i shqetësimeve dhe aspiratave të njerëzve të popullit, frys-mëzimi nga idetë përparimtare të kohës për drejtësi shoqërore, për liri dhe përparim, karakterizojnë frys-mën e përgjithshme të këtyre veprave, që u krijuan në vitet 30 e 40.

Nën diktaturën e egër antipopullore të çifligarëve dhe borgjezisë reaksionare të mbretit Zog as që mund të bëhej fjalë për kushte të përshtatshme dhe inkurajim të artit dhe të kulturës kombëtare. Me sakrifica të mëdha, disa djem dhe vajza të apasionuara arritën të mbarojnë nga një shkollë arti në Itali, në Greqi, në Rumani, në Francë, sepse shkollat e larta në Shqipërinë e Paraçlirimit nuk ekzistonin.

Heronjtë legjendarë të historisë shqiptare,

luftëtarët popullorë, figura të shquara të Rilindjes Kombëtare dhe Pavarësisë, bij të thjeshtë të popullit, burra të ashpërsuar nga lufta për ekzistencë, pleq e të varfër, po fisionikë, gra të kërrusura nga pesha e varfërisë dhe e kanunit, fëmijë jetimë, po me shpresën e së ardhmes në sy, këta janë personazhet e tablove dhe të skulpturave të viteve 20 e 30. Para nesh kalon si një èndërr drama e realitetit të Shqipërisë së Paraçlirimit me pamjet e saj tipike të qytetit dhe fshatit, në peizazhet e Vangjush Mios, në portretet e Kolë Idromenos dhe të Abdurrahim Buzës, në pamjet e pazarit të vjetër të Tiranës të Foto Stamos, në tablotë e Zef Kolombit, në interierët e Nexhmedin Zajmit, në vështrimin e përgendruar e tronditës të «Katundarit» të Sadik Kacelit.

Kolë Idromenoja është mjeshtri më i lashtë i piktureës sonë moderne. Që nga «Autoportreti» i tij në Galerinë Kombëtare në Tiranë na vështron rreptë një plak i zyrtë. Ngashmëria mund të jetë e saktë si në fotografi, po Idromenoja nuk ka qenë i tillë, kaq i thatë e kaq i vrenjur. Ai ishte njeri me shpirt të pasur e kulturë, me fantazi. Arkitekt nga profesioni, ai qe fotograf e viktor dhe punoi edhe si skulptor. Humori i tij i pashtershëm, gjatë karnavaleve, i habiste shkodranët e viteve 20-30 me maskat oë përqeshnin fina realë. Është e kotë të kërkojmë në veprën e tij vazhdimësi, unitet dhe shkallë të njëjtë përgjegjësie. Pikturat shumë herë nuk janë vecse riprodhime të thjeshta të fotografive që ai i bënte vetë dhe në të cilat përgjithësisht modelet pozonin si në pikturë. Është autor i çuditshëm. Në

Galeri, në ndarjen e Idromenos, do të gjejmë pranë një pikture mjeshtërore — një bojatisje amator i dhe nuk ka përsë të dyshojmë që të dyja janë dorë e tij. Por ka punë, para të cilave detyrohem i të mbajmë këmbët, sidomos te «Motra Tone». Përparrë saj do të qëndrojmë si para një kryevepre. Është një pikture jo e madhe që, për nga vlerat, shkëputet nga veprat e tjera të autorit. Le të ndalem qoftë edhe në një aspekt të vetëm të mjeshtërisë së Idromenos si portretist i shkallës së parë.

Një nga problemet e përhershme të realizimit të një portreti në pikture, si edhe në skulpturë, ka qenë si t'i shpëtosh pozimit, pozave të modelit. Dhe, me gjithë lashtësinë e këtij arti dhe përvojat gjionale, deri më sot s'janë gjetur veçse tri mënyra si t'i shmangemi kësaj së keqe. Mënyra e parë është aftësia për të vendosur një komunikim shpirtëror, emocional dhe ideor ndërmjet modelit dhe spektatorit. Piktori ose skulptori në këtë rast luajnë rolin e kameras televizive, me ndryshimin që, ndërsa një model i studios televizive duhet të gjejë forca vetë që ta tejkalojë ftohtësinë mëkanike të objektivit, në rastin tonë është piktori vetë ose skulptori ai që duhet të zbulojë se çfarë fshihet prapa pamjes indiferente të modelit, për ta shpënë atë që zbulon aty deri te spektatori. Shembuj të kësaj mënyre janë të panumërt, që nga arti roman, Leonardo da Vinci, Rembrandti, Velaskezi, Ticiani, Dyreri etj. Mënyra e dytë është kur ky pozim shmanget nëpërmjet interpretimit dhe përpunimit të veçantë plastik, që në këtë rast bëhet shprehëse sintetike e gjithë vlerave ideo-emocionale, njerëzore, të subjektit të zgjedhur. Shembuj të shkëlqyer të kësaj mënyre gjejmë, midis të tjerash, në artin e lashtë grek, te Michelangelo, në periudhën baroke të neoklasicizmit etj. Mënyra e tretë është të gjejmë dhe të përligjim çdo lëvizje dhe qëndrim nëpërmjet një ve-

primi të caktuar konkret. Këtë mënyrë ka zgjedhur Idromenoja te «Motra Tone». Është një grua e re e veshur me kostum karakteristik shkodran, me qëndrim të rëndë e të respektuar. E vendosur pérballë spektatorit, interesimi i papritur i saj pér një objekt të nënkuptuar në të majtë dhe që është, më sa duket, jo plotësisht i lejuar, përligj gjithçka, kthimin e lehtë të kokës si jashtë vullnetit të saj, lëvizjen mbrojtëse instinktive të dorës së majtë, që bën sikur ngre një kind të vellos, shoqërimin e saj nga lëvizja e përbajtur e dorës së djathtë. Dualiteti ndërmjet kureshtjes thellësisht njerëzore që buron nga vështrimi i gjallë i syve të bukur, dhe të përbajturit, që është më tepër konvencional, përbën dhe bukurinë e rrallë dhe më kryesore të kësaj kryevepre të Idromenos. Mjeshteria e piktorimit të saj hyn në traditën më të mirë klasike të artit tonë. Nga kjo pikëpamje dhe nga vlerat e përgjithshme të saj, «Motra Tone» mund të krahasohet me veprat më të mira të Odhise Paskalit, personalitet tjetër, i cili u shqua që në moshë të re dhe që dha më tej ndihmesën e tij në zhvillimin dhe përparimin e artit tonë kombëtar.

Dihet se çdo krijim artistik niset nga entuziazmi që na ngjall një temë e një subjekt, të cilët i zbulojmë në jetë. Ashtu siç ndodh kur duam një njeri, të cilil jo vetëm që nuk i gjejmë dot të meta, por edhe vetë mangësitë e tij na duken interesante, sepse nuk e shohim me sytë e ballit, por me sytë e dashurisë, po ashtu edhe artisti i vërtetë e sheh realitetin më sytë e dashurisë së tij pér këtë realitet. Kështu që, kur i pëlqen, e ka vështirë t'i gjejë të meta subjektit të tij. Atë që ekziston dhe njihet si reale dhe objektive, vështrimi artistik e shndërron vetiu, duke e ngritur gjer në ideal, gjer në përsosmëri. Kjo e vërtetë, që shpjegon çdo vlerë estetike, u përket më tepër

se kujtdo autorëve klasikë. Në modelet e pavdekshme të artit klasik lumturia dhe fatkeqësia, e mira dhe e liga, lirikja dhe dramatikja, epikja dhe qesharakja janë të zhvilluara gjer në përsosmëri. Është art që flet me gjuhën e përsosmërisë, e kështu siguron pérjetësinë e tij. Ndaj dhe thuhet që në çdo vepër të madhe arti ka diçka nga ndjenja klasike e bukurisë. Me këtë ndjenjë estetike superiore Paskali i ri u kthye në atdheun e tij, të cilin pushtimi shekullor e kishte lënë në prapambetje, në varfëri dhe injorancë të thellë. Si Idromenoja më parë, edhe Paskali më pas e patën admiruar dhe patën mësuar prej artit klasik, po përmbi çdo ndjenjë artistike qëndron ndjenja patriotike e dashurisë pér atdheun, pér njerëzit e thjeshtë, pér këtë tokë dhe historinë e lashtë të saj. Prandaj Paskali i ri nuk e kërkoi madhështinë klasike të modelimeve të tij te heronjtë imagjinare të eposit të Greqisë antike, po te psikologjia tronditëse e të uriturat, te tiparet legjendare të Kastriotit, te shtatorja e luftëtarit kombëtar pér liri. Këshu, arti realist i një epoke, duke humbur rrugës së gjatë të kohës ato tipare të dorës së dytë, që vdesin bashkë me epokën e tij, vjen i gjallë gjer te ne, me ato tipare thelbësore, që përbëjnë ligjshmëri të thella në të ndërtuarit e jetës e në të transmetuarit e saj në art, ligjshmëri që lidhen me vetë natyrën e njeriut, me aspiratat e tij të larta pér liri, pér dinjitet dhe përparim.

Paskali është autor që e kuption formimin dhe zhvillimin e një personaliteti artistik si zhvillim ihe thellim të mendimit të tij filozofik pér botën dhe njeriun, kurse veprën e artit si konvergjim në vlera estetike dhe materiale të këtij menjimi filozofik. Ai mundohet ta shpjegojë vetë veprën e tij duke shfaqur bindjen se «stili i tij nuk i krijuar nga shqetësimet pér formën, por u përkactua gjithnjë duke krijuar vepra ashtu siç u

pëlgenin bashkatdhetarëve, me atë formë që shprehte sa më qartë ndjenjat dhe përfytyrimet e popullit pér heroizmin dhe dashurinë pér at-dhe». «Në fillim, — kujton ai, — kam pasur raste që nuk kam arritur në vepër të jap mendimin që përfytyrohej pér atë figurë, së cilës do t'i ngrihej monumenti...» («Drita», 19 qershori 1983).

Duke e kuptuar drejt mjeshtrin Paskali, do të mundohemi edhe ne të paraqesim mendimin tonë, që del nga analiza dhe studimi i veprës së Paskalit, si dhe i asaj tradite, e cila gjen vazhdimësi në veprën e tij realiste. Kujdesi pér formën, ja një problem i krijimtarisë dhe preokupim i përjetshëm e i lodhshëm i profesionit të artistit. Edhe natyra, nëna e të gjitha gjérave, kujdeset gjer në fund pér formën, sepse pér formën nuk ka nevojë vetëm asgjëja, hiçi. Natyra e shpreh entuziazmin dhe habinë e saj në formën e përkryer të një trëndafili, në dëlirësinë, pafajësinë e në bardhësinë e një zambaku, ajo i jep luanit formën e përsosur të fuqisë e të krenarisë madhështore, gjarprit formën e përkryer të dredhisë dhe pabesisë, krimbit përsosmérinë e neverisë, ose krijon kryeveprën e saj — ndërgjegjen njerëzore dhe kujdeset t'ia paraqesë gjithësisë në formën e mbaruar të njeriut të zhvilluar harmonikisht pér nga trupi e nga shpirti. Dhe artisti, ky bir i natyrës dhe nxënës i saj, merr guximin dhe krijon piramat e Egjiptit pér të shprehur madhështinë dhe rrëptësinë e push-tetit të tij, Nikën e Samothrakës pér të shprehur triumfin e fitores që nuk njeh pengesë, Diskobolin e Mironit pér të shprehur bukurinë burrërore dhe ekulibrin e përsosur të lëvizjes së përjetshme, Venerën e Milosit pér të shprehur mrekullinë e përpjektueshmërisë dhe të delikatesës femërore, «Davidin» e Mikelanxhelos pér shpirtin heroik e të pamposhtur të luftëtarit dhe prijësit të ndritur, Mona Lizën pér të na tronditur nga forca dhe men-

dimi filozofik, «Mendimtarin» e Rödenit pér t'i kënduar forcës së mendimit e të vullnetit njerëzor. Duke zbatuar me gjenialitet ligjet e mëdha të krijimit artistik, këta bij të natyrës arrijnë t'u japid veprave të tyre një formë të përsosur. Artistët realistë janë kujdesur pérherë e do të kujdesen edhe më tepër pér formën artistike. Dhe nga ky kujdes realizmi bëhet më i kuptueshëm, më i bukur, më i fuqishëm. Ja si e shpreh mjeshtri Paskali kërkesën që kanë masat e gjera artdashëse ndaj bukurisë plastike të artit: «populli e do heroin të bukur!»

Një nga kërkesat themelore të artit të realizmit socialist është identiteti i gjuhës së autorit, individualiteti i shprehjes artistike. Karakteri kombëtar i krijimtarisë, fryma popullore dhe misioni militant i artistit në shoqëri, jo vetëm që nuk e kundërshtojnë individualitetin e shprehjes, por mund të zbatohen në krijimtarinë artistike vetëm në formën individuale. Vlera e veprës së Paskalit do të kishte rënë mjaft në sytë tanë, në qoftë se nuk do të kishte vulën e personalitetit të tij... «Skënderbeu» i Paskalit dhe «Skënderbeu» i Paços ndryshojnë sa s'ka ku të vejë më, ndonëse i kushtohen të njëjtët hero kombëtar. Artisti e ka pér detyrë t'i prijë shipes artistike të masave të gjera dhe jo të qëndrojë në bisht dhe as të tertiqet nga ajo. Në këtë mënyrë artisti sa më i mirë e më i madh të jetë, aq më tepër është në gjendje të bëhet shprehës i ndërgjegjes estetike të bashkë-kohësve dhe të brezave që vijnë me forcën e përfytyrimit të tij, e cila buron nga realiteti dhe e ngre atë realitet objektiv në realitet artistik, në mënyrë individuale, të papërsëritshme.

Ai fill klasik që vihet re në krijimtarinë e Idromenos e të Paskalit, zbulon aspekte të reja te një portet i vogël, që mban titullin «Doktor Prela»

dhe firmën «Ndoc Martini». Kjo pikturë e vogël li-rike sentimentale, që paraqet një intelektual shkodran të fillimit të shekullit, është realizuar sipas mënyrës karavaxhiste. Vizatimi ka elegancën dhe përpikmérinë e mënyrës klasike, ndërsa shkalla e zotërimit të ndricimit, që nuk buron nga rastësia, por nga domosdoshmëria, dëshmon se për Martinin ndjenja poetike, analiza racionale dhe ideja filozofike qenë arkitektura e vetme, e denjë për një vepër arti.

Ndihamësë të një natyre tjetër dhanë në fillimet e pikturës sonë Vangjush Mios, Foto Stamo, Sadik Kaceli, Nexhmedin Zajmi, Qamil Grezda, Kelë Kodheli etj. Ata studuan në vende të ndryshme dhe studuan pikturën realiste. Me gjithë ndryshimet dhe prirjet vetjake, ka diçka që i bashkon në tiparet e njohura të asaj pikture realiste që bëhej atëherë në Evropë. Si ishte kjo pikturë dhe nga vinte?

Përsëritja e pambarim e formave madhështore të Rilindjes së Lartë e coi artin në manierizëm, në thatësi. Këtij manierizmi heroik iu kundërvu realizmi dramatik i Karavaxhis. Pas Engrit dhe Davidit, si dhe pas romantizmit të Zherikosë, të Dëlakruasë, stilizimit të formave në një bukuri ideale ia zuri vendin dëshira e përgjithshme për një interpretim më të shpenguar të realitetit në art. Ndihei kërkesa për t'u kthyer në përmasat e vetë njeriut. Ndjeshmëria e poetit dhe vështrimi i piktorit nisën të bëheshin më të vëmendshëm ndaj jetës së thjeshtë, të përditshme. Trualli i zbulimeve poetike bëhet toka dhe poezia gjysmëqiellore zë-vendësohet nga poezia e thjeshtë tokësore. Bëhet, në këtë mënyrë një përvparim i madh drejt realizmit gjatë shekullit të 19-të. Dhe piktorët ndiejnë nevojën për një gjuhë të drejtëpërdrejtë, të shpejtë, të aftë që të lejojë regjistrimin estetik imediat të kësaj bote reale që ndryshon në mënyrë të

pandërpërre. Është kjo përvojë e re e gjysmës së dytë të shekullit të 19-të që u zhvillua më tej në gjysmën e parë të shekullit tonë, që i fali pikture, bashkë me shkallën e re të freskisë e të vërtetësisë, edhe forcën emocionale të gjestit piktorik, që përjashton çdo mundësi të përpunimit të gjatë e të ftohtë akademik. Kjo pikturë realiste u bëri ballë me sukses të gjitha valëve zhurmëshuma të modernizmit.

Një vend i shquar në krijimtarinë e kësaj periudhe i takon Vangjush Mios. Ai hyri në pikturën shqiptare si një autor i talentuar dhe serioz, plotësisht i përgatitur dhe me ideale të qarta realiste. I frymëzuar nga dashuria e ngrohtë për vendin e tij, për mjediset ku u rrit dhe punoi, për bukurinë e papërsëritshme të Korçës e të rretheve të saj, për reliefin e larmishëm shqiptar, ai këndon poezinë spontane të natyrës. Mioja nuk e merr objektin dhe ta vërë në një dritë të re. Duket sikur ndërron shumë pak nga ajo që sheh, por harmonia e pikture së tij nuk është harmonia e natyrës, por e shpirtit të Mios. Emocionet tek ai janë të vërteta, të singerta, individuale. Zgjedh shumë dhe, kur bindet për atë që ka gjetur, i nënshtrohet si poet. Piktura e Mios nuk shpërthen me gjëzinin e saj, nuk bërtet e nuk thërrret me drithën dhe shkëltqimin. As ai vetë nuk ishte i tillë. Gëzimi i toneve të tij është më i heshtur, më i thellë. Peizazhet më të mira të piktorit burojnë qetësi, siguri dhe ekuilibër. Qëllon të trishtohet nganjëherë nga një mendim i hidhur për botën e kufizuar, mendim që shtrihet bashkë me penelatat e tij gjer tej në horizont, thellë toneve të mbytura, përtëj ndriçimeve të vrara, përtëj qillit të gërvishët. Por këto janë vetëm çaste në kalim, se përsëri drita nis dhe buron e qetë dhe e ngrohtë nga pikatura e Vangjush Mios, duke ardhur gjer te ne me af-

shin rrëqethës të asaj dashurie të përmalluar, që nuk u shua kurrë në zemrën e tij.

Foto Stamoja, Sadik Kaceli, Nexhmedin Zajmi qenë djem të rinj asaj kohe. Personazhet e pëlhurave të tyre nuk mbajnë as gravata e as papijke, por janë të veshur me rroba të arnuara, me qeleshe e ferekhe, siç vishej populli i varfër, i shfrytëzuar gjer në palcë.

Drama e realitetit të ashpër buron me thjeshtësi tronditëse nga fytyrat e jetimëve të Foto Stamos, nga «Malësori» i Sadik Kacelit, nga «Brendia e Thethit» e Nexhmedin Zajmit, e cila duket e zbrazur nga njerëzit dhe e mbushur me hallet e tyre. E gjithë kjo është thënë thjesht, pa fjalë të zgjatura, pa kapardisje e pa retorikë. E thjeshtë tavaloça, i thjeshtë vizatimi, e thjeshtë dhe e ngrohtë harmonia e ngjyrave kafe, por nuk është e thjeshtë mjeshteria me të cilën pikturomjnë këta djem të talentuar.

Le të marrim goftë edhe një tipar të vetëm të kësaj mjeshterie, përpunimin e sipërfaqes, endjen. Ne sot teknikish shqetësohami edhe pér atë përshtypje që do t'i bëjë spektatorit tekstura, endja e sipërfaqes së pikturës sonë, duke e vlerësuar këtë gjë si pjesë me rëndësi, të mjeshtërisë piktorike. Ky vlerësim është i drejtë, dhe rritja e rolit të teksturës ose fakturës është ndihmesë e kohëve të reja. Mirépo kujdesi pér sipërfaqen nuk ka munguar as më parë. Dhe çdo element shprehës, goftë edhe krejt i ri, është zbuluar nga pyetja: «Si ta shpreh këtë?» Parapëlqimi ndaj fakturave të ashpra dhe teksturave të forta që ka hyrë në modë në ditët tona dhe që gjejnë vend në pëlhurat edhe kur nuk i kërkon fare tema e zgjedhur, na duket po aq i padobishëm, sa edhe përbuzja ndaj sipërfaqeve të palëmuara. Është e vërtetë se fryma epike dhe monumentaliteti i figuracionit artistik përkon me ashpërsinë e endjes, por ka mjete

të tjera edhe më të fuqishme e të sprovuara në shekuj pér të arritur të njëjtën forcë. Strukturat e ashpra nuk janë në gjendje të flasin pér hovin rinor të jetës në lulëzim. Penelata e butë dhe format ajrore nuk janë në gjendje të maten me forcën dhe qëndrueshmérinë e një konturi të rrepertë, por as butësia dhe dëlirësia e pakrahasueshme e vështrimit të një nëne të lumtur nuk arrihet dot me konture të rënda dhe me modelim drusor. Në jetë, krahas forcës, qëndron delikatesa, krahas thjeshtësisë — finesa. Piktura e kësaj periudhe e Idromenos, e Martinit, e Kolombit, e Mios, Stamos, e Kacelit, Zajmit, e Grezdës, Sofia Papadimitrit etj. mund të na mësonte shumë në këtë pikë, duke shmangur njëanshmérinë teknike dhe duke na ndihmuar të zgjerojmë mundësitet e mjeteve tona të shprehjes realiste. Shembuj të shkëlqyer të butësissë së penelatës janë disa punë të Kolombit, ndërsa pér kombinimin inteligjent të teksturës së butë e të lëmuar me atë të gjallë e intensive, është «Motra Tone».

Ndihet njëfarë ndjeshmërie e veçantë e piktorëve ndaj përcaktimit në është, apo nuk është koloristike një vepër, dhe në është, apo nuk është kolorist autor. Mendoj se burimi i vërtetë i këtij shqetësimi është një keqkuptim ose pasaktësi. Kur kritika është «zemërgjerë», ky keqkuptim zgjidhet thjesht, duke vlerësuar kolorizmin e çdo vepre të mirë dhe duke i shpallur autorët e tyre koloristë. Një zgjidhje si kjo ka, të paktën këtë të keqe, që ia heq çdo kuptim fjalës «kolorist», që kurse çdo piktor i mirë është në të njëjtën kohë edhe kolorist; dhe, nga ana tjetër, krijon përshtypjen e gabuar se, pér të qenë piktor i mirë e i shkëlqyer, duhet të jesh patjetër kolorist. Mirépo, kur vjen fjalë pér të vlerësuar autorët e mëdhenj të një epoke të shquar, p.sh. të rilindjes, vlerësimi që u bëhet Ticianit, Veronezes dhe Xhorxhones si

koloristë, nuk i zhvlerëson dhe as ua zbeh madhështinë Mikelanxhelos dhe Rafaelit, të cilët nuk qenë aspak koloristë. Po të qe ngjyra një kriter kaq vendimtar në përcaktimin e vlerës së një autori, Francisko Goja nuk do të qe vlerësuar veçse si një piktor i rëndomtë i kohës së tij. Gjithë piktorët e mirë janë të ndjeshëm ndaj ngjyrave. Edhe ne kemi pasur dhe kemi piktorë me ndjeshmëri të lartë ndaj ngjyrës.

Por jo të gjithë piktorët janë *koloristë*, sepse te shumë nga ata ngjyra mbetet vetëm në rolin ndihmës. Interpretimi që u bëjnë këta autorë ngjyrave të realitetit, i shërben harmonisë së tablosë dhe unititet të shprehjes ideoemocionale, por ky interpretim i ngjyrës mbetet tek ata në kufijtë e raporteve sasiore. Përbajtja e fuqishme e vepgrave, të tyre është materializuar në vlera estetike po aq të fuqishme, gjë që i bën ato me vlerë të plotë. Por shprehjen artistike artistë të tillë e arrijnë pa ndier nevojë për ta aktivizuar më tepër ngjyrën.

Mbi bazë tjetër mjeshtërore e ka ndërtuar pikturen e tij Abdurrahim Buza. Duke përvetësuar në shkollë mjetet realiste të shprehjes piktorike sipas së njëjtës traditë të tetëqindëshit, ai ruajti, bashkë me mallin për atdheun, edhe ndjenjën e fortë dekorative të ngjyrës, gjë që e detyroi t'i futet një studimi të posaçëm serioz dhe të arrijë më në fund rritjen dhe fuqizimin e rolit ideoemocional të ngjyrës në pikturen e tij realiste. Te Buza, sikurse tek Onufri i shekullit XVI, ne gjejmë atë parim të ndërtimit me anë të ngjyrës, që e gjejmë pastaj vetëm te kryeveprat e artit populor. Ky është kolorizmi dhe këta janë koloristët. Kështu, që, mund të themi më në fund se te koloristët raportet sasiore të ngjyrave kthehen në raporte cilësore, gjë që mund ta bëjë çdo piktor veçse duke dhuanar harmoninë.

Megjithatë duhet thënë se piktura jonë ka pasur një humbje të madhe në këtë fushë: Zef Kolombin. Ai ishte kolorist, ndonësë nuk pati jetë gjatësinë për ta zhvilluar gjer në fund pikturen e tij. Nuk ngjante me bashkëkohësin e tij, Buzën, as nga natyra dhe as nga vepra. Sa i thjeshtë, populor dhe me ndjenjën e humorit të përhershëm ishte Buza, aq i myllur e meditativ ishte Kolumbi. Ëndrra e tij qe një pikture e kthjellët, e butë, e ndritur, ku tejdukshmëria e ngjyrave dhe përpikmëria e vizatimit elegant të shprehnin dëllirësinë, ndërsa gjallëria koloristike gëzimin dhe lumturinë. Ai shikim i rëndë që na drejtohet nga autoportreti i tij, fsheh një shpirt plot dritë, nga i cili buronte gëzimi i pruar dhe dashuria për jetën dhe njerëzit. Por është e nevojshme, ndoshta të shpjegojë se çfarë janë këto ngjyra të tejdukshme që dëshironë t'i arrinte Kolombi, dhe çfarë do të thotë, në përgjithësi, tejdukshmëri e pikturen me bojëra vaji, kur dihet se bojërat e vajit nuk janë të tejdukshme, por viskoze dhe opake. Bukuria e pikturen me bojëra vaji mbështetet te vetia e mbulimit të plotë të një ngyre nga tjetra. Hollimi në këtë ose atë masë i bojës dhe vendosja e saj në mbishtresa të njëpasnjëshme arrin disa vlera që janë të dorës së dytë dhe praktikisht të papërfillshme. «Cudirat» që arrinin mjeshtrat e vjetër me velaturat e bojës së vajit, janë fryrë shumë nga kritika dhe restauratorët, duke u kthyer në një legjendë që nuk ka asnjë bazë. Ekziston me të vërtetë një mundësi e sigurt për të arritur përshtypjen e tejdukshmërisë me bojëra vaji. Kjo është mjeshtëria për të krijuar ndërmjet ngjyrash atë veprim të ndërsjellë që harmonizon në mënyrë të papritur edhe skajet më të largëta të spektrit, që siguron unitetin e kundërtive më të cuditshme, pa pasur nevojë për ndërmjetësira. Është fjala për atë veprim të ndërsjellë që mund

të karahasohet me fushën elektromagnetike që krijohet ndërmjet dy trupave në fizikë, ose me forcën e gravitetit brenda sferës vepruese të një planeti. Një gjë e tillë ndihet menjëherë nga spektatori i veprës së artit në formën e asaj «goditjeje» emocionale që shikakton «çudia» e ngjyrës. Është ajo «çudi» që na mbërthen tek El Greko, te Ticiani, te Dëlakrua, Rembrandti, te gjithë koloristët dhe që, përderisa mund të shpjegohet, nuk është çudi, por mjeshtëri prej koloristi. Përveç kjo mjeshtëri krijon raporte, që i kthejnë bojérat qenësisht opake, në ngjyra të tejdukshme dhe që i jep tejdukshmërinë një sipërfaqeje të mbuluar tërësisht me bojë të trashë, viskoze, opake, aspak të tejdukshme, pa qenë nevoja për asnjë lloj vellature. Por njihet edhe njëlloj tejdukshmërie tjetër, të cilën e kanë përdorur gjithmonë gjithë piktorët dhe do ta përdorin, me sukses të plotë. Kjo është një tejkdushmëri e arritur sipas parimit tonal. Me fjalë të tjera, në qoftë se në një zonë të tablosë, të mbuluar plotësisht me ton të errët e gjysmë të errët, pavarësisht se çfarë ngjyre ka ky ton, vizatjmë me linja ose penelata të shkëputura një formë konkrete më të njëjtën ngjyrë, por më të errët, e tërë kjo zonë fiton përnjëherë tejdukshmëri. E njëjta gjë mund të provohet edhe me një laps të thjeshtë ose me karbon, gjë që vërteton se kjo lloj tejdukshmërie nuk ka të bëjë aspak me kualitetë të ngjyrës.

Mirëpo tejdukshmëria që kërkonte të arrinte Kolombi, ndryshon nga ajo që arriti edhe një kolorist si Buza. Kjo tejdukshmëri e Kolombit ka lidhje me ato zbulime dhe përparime që u bënë në fizikë dhe që u zbatuan në pikturë në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar, mbi natyrën e vërtetë të dritës diellore dhe ndërtimin e saj. Ishte një zbulim i madh, që hapi mundësi të pakufishme

jo vetëm për ta transmetuar një peizazh me vërtetësi dhe duke i flakur tej hijet e errëta, të shurdhëta dhe empirike të klasikëve, por edhe përgjithë zhvillimin e mëtejshëm të pikturës realiste. Thelbi i këtij shpjegimi shkencor që iu bë dritës, ishte njohja e së vërtetës objektive mbi hijen, e cila doli më e ndërlikuar e jo e thjeshtë, siç besohet e zbatohej gjer atëherë. U shpjegua se objekti në tablo do të ketë dritë të vërtetë vetëm në qoftë se do të ketë dritë hija vetë. Ka pasur piktorë që e kanë zbatuar në mënyrë të gabuar këtë zbulim, duke futur nëpër hijet reflekse arbitrale të familijs së të kaltrave, pa marrë parasysh as gamën e përgjithshme të pikturës dhe as ngjyrën e vëçantë të objektit që ndriçohej. Por Zef Kolombi është piktor veçanërisht i hollë dhe kishte një dashuri kaq të madhe për të vërtetën, saqë nuk mund ta bënte këtë gabim. Tek ai mund të gjejmë dëshmira të druajtjes e të pasigurisë, por jo të arbitratitetit viziv. Nuk ishte as snob. Qe një autor serioz, që e kuptonte artin si një formë të rëndësishme të njohjes së jetës. Ndaj të gjitha zbulimet dhe përparimet e tij mbajnë vulën e vlerave të mirëfillta, duke përjashtuar çdo falsitet. Të marrim dy natyrëmortet e tij, që ndodhen të ekspozuara në Galeri. «Rrush e dardhë» gjëzon simpatinë dhe vlerësimin e përgjithshëm. Është një pikturë, për harmoninë e softme të së cilës besoj se autori i saj do të ishte kundër, sepse është harmoni e arritur nga pluhuri i kohës, ngaqë nuk është i pastruar nga restauratorët, dhe se nuk ka asgjë të përbashkët me harmoninë që kërkonte nga piktura Kolombi. Është natyrëmorti tjetër, i titulluar «Rrush e pjeshkë» i piktuuar në të njëtin vit, që tregon Kolombin e vërtetë. Ky kuadër paraqet objekte të thjeshta, por me një gjallëri të jashtëzakonshme, e cila buron kryesisht nga ngjyra. Kjo gjallëri është arritja më e rëndësishme e Zef Ko-

lombit. Jo larg veprave të tij qëndron një natyrë-mort tjetër i vogël me titull «Natyrë e qetë me rrush», ku penelatat e ngjyrave intensive, të plota dhe opake godasin kartonin e vogël si të qenë copa mozaiku. Këto penelata, të vogla si grimca kristalesh, janë të shumta dhe të ngjyrave të ndryshme, qoftë edhe brenda një kokrre të vetme rrushi, sepse artisti gjen edhe atje lojën e madhe të natyrës. Ky natyrëmort është i Abdurrahim Buzës. Ai ndryshon mjaft nga natyrëmorti i Kolombit, i cili kërkon ta arrijë gjallérinë e natyrës me një ndërtim krejt të ndryshëm të ngjyrës. Dhe efektet janë qartësisht të ndryshme. Për të shijuar dhe vlerësuar pikturën e Kolombit, g'është e vërteta, duhet një shkallë e caktuar modestie.

* * *

Ajo që i bashkon këta autorë dhe veprat e tyre, është jo vetëm përbajtja demokratike-popullore e kësaj tradite, por edhe gjhuha artistike realiste e shprehjes. Ndryshimet e mëdha, nganjëherë të skajshme, të individualiteteve, të shijeve dhe të temperamenteve, nuk cenojnë në asnjë rast realizimin e shprehjes. Portretet e Stamos, peizazhet e Mios, subjektit e ndryshme të Buzës, tabloë e Kolombit, janë të ndryshme sa s'ka ku të vejë më, por realizimi dhe vërtetësia e tyre artistike është e garantuar, sepse interpretimi artistik është i singertë, i ndier. Njohuritë profesionale të marrë në shkollë dhe nga kontakti me veprat e mjeshtërve të artit evropian janë asimiluar drejt, duke ruajtur tiparet individuale dhe kombëtare të ndjeshmërisë artistike. Në mes të korrenteve të shumëlojshme të artit evropian të viteve 30 e 40, artistët tanë ditën të zgjedhin e të marrin nga pë-

voja përparimtare atë që ishte më e mirë, që përpunohet me shijet tona, me kërkesat e temperamenti tonë shqiptar, me psikologjinë e popullit tonë.

Nga ana tjetër, thjeshtësia e shprehjes, që është karakteristika e përgjithshme e këtyre veprave, përbën një shembull pozitiv, nga i cili kanë nxjerrë mësimë brezat më të rinj të piktorëve tanë dhe të skulptorëve. Arti ynë i realizmit socialist e ka ruajtur dhe e ka zhvilluar më tej edhe këtë tipar të çmuar. Kërkesat e reja të ditëve tona të vrullshme të ndërtimit socialist kanë grumbulluar një përvojë të madhe, në të cilën kanë dhënë ndihmesën e tyre edhe mjaft nga këta autorë, që e nisën rrugën e tyre krijuese që para Çlirimt. Veprat e tyre të epokës së realizmit socialist janë gjithashtu zhvillime të reja me interes.

Shoku Enver na mëson: «Partia ka theksuar vazhdimisht nevojën që të mbështetemi në traditat e shëndosha e t'i kultivojmë ato më tej. Ajo ka nxjerrë në pah vlerat e mëdha të traditave më të mira kulturore, fryshtat patriotike popullore të tyre». Duke u mbështetur fuqimisht në këto tradita, si dhe në krijimtarinë madhështore të mjeshtetrave të artit dekorativ popullor, artistët tanë të rinj do të dinë ta çojnë më tej dhe ta pasurojnë fondin kombëtar të artit tonë të ri, të partishëm, revolucionar.

ARTISTI I POPULLIT ODHISE PASKALI

Në vitin 1927, kur Paskali ishte ende një talent i ri, një kritike arti pa rastësisht në një eksposítë dy punë të tij. Njëra nga këto punë që modeluar sipas mësimeve të klasikëve, ndërsa tjetra që realiste. E impresionuar nga forca e talentit të këtij të riu, por dhe e habitur prej dualitetit në punën e tij, ajo shkroi: «Si do të ecë më tej ky i ri? Këtej apo andej?»

Është një dualitet që e ka shoqëruar tërë jetën Paskalin, mjeshtrin e shquar të skulpturës sonë. Sikurse në jetë, edhe në art dualitetet janë nganjëherë burim gjallërie dhe forcë krijuese, kur gjejnë harmoni brenda së njëjtës natyrë. Dhe ndoshta është tepër vështirë ta hedhësh të sigurt çdo hap në rrugën e gjatë dhe të vështirë të artit. Megjithatë, nuk pérjashtohen rastet e veçanta kur artistë të rinj dallohen nga një qartësi instinktive që në pikënisje të rrugës së tyre krijuese. Në rastin e Paskalit, kjo qartësi instinktive ia linte vendin një konceptimi më të llogaritur, më cerebral më konceptimin e veprës.

Në mbrojtjen e diplomave të vitit 1983 ndodhesha rastësisht edhe unë në liceun Artistik «Jordan Misja», në klasën e skulpturës. I ftuar ishte Skulptori i Popullit Odhise Paskali. «Do të

dëshiroja, — vërejti mjeshtri, duke parë punët e diplomave, — që për sa i përket estetikës të keni kujdes më shumë. Vërtet kopjohet natyra, por jo të kopjohet ekzakt, sepse është natyralizëm. Një punë që bëhet sot, duhet të kuptohet që është bërë sot, jo para 100 vjetësh!»

Paskali e kishte kuptuar që në rininë e tij të hershme se e vërteta nuk është e rëndomta, ajo që sheh përditë syri i zakonshëm. Ishte një nga mësimet që kishte nxjerrë nga arti klasik.

Paskali u dallua që në fillim të karrierës së tij artistike për shijen e tij superiore, në mes të një mqedisi thellësisht të prapambetur, feudal.

I qetë, i përbajtj, meditativ, i myllur brenda botës së skulpturës së tij, ai ishte artist që mendohej thellë për gjithçka që kishte të bënte me krijimtarinë e tij. Duke qenë tradicionalist në tërë konstitucionin e tij estetik dhe shpirtëror, formimi i tij u bë mishërim i qartë i kryqëzimit të modelit klasik me përvojën realiste të fundit të shekullit XIX. Pa qenë aspak novator në formën artistike të skulpturës së tij, Paskali diti të zbulonte me ndjenjë tema dhe subjekte të reja nga historia e vendit të vet.

Paskali e kuptoi që në fillim se një artist që do të déshironte të shikonte realitetin e kohës së tij me sytë e Mironit dhe të Praksitelit, do të désh-tonte. Ai vazhdoi t'i kérkonte ata në një fytyrë shqiptare, në shtatin e hedhur të një luftëtari të lirisë, te gjesti heroik i Kastriotit.

Paskali dinte të qëndronte te një fytyrë, te një vështrim i rënduar, te një mendim i fuqishëm, i burgosur prapa një pamjeje indiferente. Me sigurinë e mjeshtrit arrinte të zbulonte ai dhembjen dhe mallin e pasuar të shpirtit të tij në rrudhat e thella të De Radës, madhështinë e ashpër të një burri, mprehtësinë e një plaku të rreptë, bukurinë

e rëndë të një drame njerëzore. Dhe, në të njëjtën kohë e për çudi, admirimi i tij vazhdonte të drejtohej nga «Diskoboli», kjo harmoni e përsosur e vrullit djaloshar të përbajtj. Vepra e tij, që në fillim dhe deri në fund, mbeti modeli i gjallë i frysës romantike, që gjen strehim dhe ekuilibër brenda ndjenjës klasike të masës. Në këtë mënyrë i shërbeu ai kohës sonë, idealeve të reja të një sistemi të ri. Përherë të ri, na duket sikur e shohim të gjallë tek kalon përmes sheshit «Skënderbej» qdo mëngjes, në të njëjtën orë, me trupin përherë drejt, me hap djaloshar, me atë vështrim të imprehtë, të përqendruar, duke përvëndetur me mirësjellje dhe buzëqeshje të përbajtj të njohurit dhe admiruesit e shumtë të artit të tij.

ÇFARË BËRI DHE ÇFARË NUK BËRI VANGJUSH MIOJA

(*Shënim nga ekspozita retrospektive e veprës së tij*)

*«Nuk piktuohet me ngjyra,
piktuohet me ndjenja»

SHARDEN

Piktori i Popullit Vangjush Mio ishte nga ata artistë që e duan natyrën me gjithë zemër dhe që përipiqen ta japid bukurinë e saj duke iu larguar sa më pak që është e mundur.

Mioja e nisi krijimtarinë e tij në vitet 10 të këtij shekulli me portrete të trajtuarë në mënyrë studimore, shkollore, në të cilat përqendrohet te vizatimi. Këtë e zbaton, pa u shqetësuar fare, nga një portret te tjetri. Është e qartë se ai nuk ndiente kërkesa të veçanta ndaj elementeve të tjera në atë periudhë të gjatë. E tërë vëmendja e piktorit të ri përqendrohet te veçantitë dhe karakteri, te vizatimi.

Pas kësaj erdhën peizazhet e tij të një frysë disi romantike. «Peizazh me pellg», 1917. «Peizazh me figurën e bariut të vogël», 1919, «Peizazh i 1919-tës», «Venecia», 1923, «Peizazh», 1921.

«Në Venecia», 1924. Shenjat e para të pikturës së tij të ardhshme. Qartësi e kuadrit, qetësi e ngjyrës, frysëmarrje e gjerë e kompozimit. Mungesa e çdo mbingarkese me objekte dhe grupime. Pak objekte, shumë hapësirë. Që në këtë kohë vëmë re se piktori i ri nuk vuan shumë nga paragjykimet formale mbi kompozimin. «Venecia» 1922 ndryshon krejtësisht nga «Venecia» 1912, sikurse «Pamje nga Venediku» 1924, i ngarkuar me gondola në plan të parë, nuk ka asgjë të përbashkët me «Në Venecia»* 1924.

Interesant është «Autoportreti» i tij i vitit 1918. Një djalosh me besim në vetvete. Kërkon të duket pak më i rritur nga ç'është, si çdo i ri, gjë që kuptohet lehtë kur e krahasojmë me vizatimin e bërë vetëm një vit më parë. Vetëm më 1919 kemi një autoportret që na ringjall Mion e vërtetë, një piktor serioz, të përqendruar, me ambicie. Lëvizja e figurës shoqëron shikimin e tij, duke e shmangur pozimin e thjeshtë. Baluket i bien mbi sy, duke i dhënë një pamje romantike.

Në këto portrete të viteve 1917-1919, sikurse dhe në portretet e tjera të kësaj periudhe, piktori e ndien veten më të sigurt brenda grisë, sesa kur hyn në kufijtë e së gjelbrës, ose kur provon edhe pak më tej. Autoportreti gri i vitit 1919, i pikturuar me bojëra vaji, pak i thatë në realizim, na paraqet një piktor mjaf të përqendruar, të zhveshur nga pozat. Në përgjithësi, te këto portrete, sidomos në portretet e femrave të viteve 1917-1918, nuk shohim asnjë interesim të veçantë për linjën, për melodinë e saj. Ato janë trajtuar thjesht, të modeluara po aq thjesht, në mënyrë tonale, pa bërë as përnjekjen më të vogël për ndonjë farë kultivimi plastik, për ndonjë seleksionim të formës vëllimore. Vërejmë, në të njëjtën kohë, një shkathësi etvdi në portretin e një gruaje të pikturuar më 1918, që dëshmon për një shkallë të

çaktuar profesionalizmi. (Piktura është realizuar mbi sargjinë rozë të myllur, të paintonuar dhe vizatuar me shkathësi me të zezë vandajk). Janë portrete në qëndrime shkollore dhe që nuk pretendojnë për më tepër.

Me gjithë rjobjen që mund të ketë pasur edhe nëpërmjet shkollës me elemente të artit klasik, natyra e Mios nuk kishte asgjë të përbashkët me kërkuesat klasike. Edhe kur e vendos kavaletin përparrë arkitekturave klasike, kuptohet që atje tej se nuk ishte në gjendje të merrej me vizatime të ndërlikuara, me elementet e arkitekturës, sikurse nuk ishte në gjendje të trajtonte materiale komplekse e shumëplanshe, si uji me tejdhukshtërinë e tij, varkat që pasqyrohen aty, pallatet e Venecias etj, me ndërthurje të ngjyrave, të formave dhe të reflekseve. Nuk arrinte t'i zotëronte këto, t'i kontrollonte dhe t'i disiplinonte brenda vështrimit të tij. Ose, që të shprehemi ndryshtë, të gjitha këto e mërzitnin shpirtin e tij të thjeshtë. Ndaj edhe ngjyrat aty i dilnin të rënda, duke e humbur plasticitetin kromatik.

Ndërsa në peizazhin e vitit 1921, të mbajtur në kafe e rozë, piktori arrin të shprehet në mënyrë më të shpenguar.

Më 1922 i bëjnë përshtypje drita që bie nga drittaret në rrugën e mbuluar nga muzgu, por kjo dritë e ngrohtë nuk është ende e mjaftueshme ta ndihmojë piktorin të dalë nga mjegullia e përgjithshme e periudhës së parë të krijimtarisë së tij. Ndonsë mund të vihet re se një frysë e re po depërtón në kuadrot e tij: një vëmendje më e madhe ndaj dritës: «Peizazhi», 1922.

Le të krahasojmë peizazhet e viteve 1917-18-19-22 me «Rrugën në Pogradec» 1930 dhe do të gjemë një ndryshim mjaf të madh, rrënjesor. Në fillimet e tij Mioja nuk ia dinte vlerën arkitekturës së dritës, ndërtimit të saj të organizuar,

efektet e fuqishme që mund të arrihen nëpërmjet këtij organizimi. Një nevojë të tillë ai arrin tandejë që më 1922, por, ndërsa ia del të vlerësojë kontrastin në planin e parë të peizazhit të tij mbi tokë dhe te tendat e dyqaneve, duket sikur humbet përpara kontrastit të murit të fasadës me qellin dhe i trajton ato si biloqe dekorative të paaktivizuara, asnjanëse.

Më 1924 ka ecur disi me ndërgjegje në ndërtimin e dritës. Në peizazhin «Në Venecia», 1924, hija e nderur tërthor planit të parë bën efekt, ndonëse jo në masën e déshiruar. Si hijet dhe dritat vendosen ende me mjaft druajtje.

Në vitet 1925-1926 Mioja ndien vështirësi ende. Natyra e peizazhit të atdheut të tij nuk dëgjon t'u nënshtrohet me lehtësi normave të shkollës që ka bërë, dhe as shprehive të fituara në një mjeshtëri huaj. Dhe është ndoshta vërtet e vështirë që ta pikturossh natyrën shqiptare me tone masive gri, me biloqe opake, që i nënshtronët një të përgjithshme gri, siç bën Mioja në periudhën 1917-21. Përplasja e recetave shkollore me tiparet e gjalla të një realiteti të ri mëndoymë se është shkaku që e gjejmë më të hutuar para natyrës («Mullarët», «Në Korçë»), ose të mos ndihet i sigurt («Korça e viti 1925»), ose të mos arrijë t'i harmonizojë ngjyrat si duhet: «Manat në Drenovë», 1927, «Rrugë në Korçë», 1927. Dhe paprituria arrin të realizojë një përparim të madh: «Currellat e Durrësit», 1927. Kuadri i gjerë, i shtrirë, kompozimi madhështor. Kundërvëniet e buta, penelata që burojnë nga gjerësia dhe qetësia e pamjes së detit. Qielli i ngrohtë, i shtrirë, i lartë. Është një nga pikurat e Mios, që déshmon për një kthesë të rëndësishme për nga drita e vërtetë e pikturës së tij. Por një kthesë e tillë nuk realizohet menjëherë dhe as në vijë të drejtë. Kështu, peizazhet e viteve 1925-27 déshmojnë për vështirësitet e

mëdha që haste piktori në përpjekjet e tij këmbëngulëse për të arritur dritën e atdheut të tij. Sepse nuk ishte aspak e thjeshtë të dilte menjëherë nga drita dhe ngjyrat e mbyllura e të shurdhëta me të cilat që mësuar. Te «Mullarët», p.sh., ka dështuar; e blerta në të verdhë nuk i lë hijet e zymta e të ndotura të krijojnë njëfarë raporti, qoftë dhe të kushtëzuar. Mullarët e pluhurosur në mënyrë tonale dalin shumë keq në qellin e papastër, të një të kaltreje të ndotur. E njëjtë gjë i ndodh edhe te «Në Korçë» 1925, ku mundohet të errësojë vijat dhe hijet artificialisht.

Më 1927, te «Rrugë në Korçë», piktori është më i qetë dhe më i sigurt, por përsëri mbetet i zbehtë, megjithëse përparimi është i dukshëm. Qëllimit ia arrin po atë vit te «Currellat e Durrësit» dhe në «Durrës», si dhe në peizazhin «Porti i Durrësit». Në këtë periudhë takohemi, më në fund, me Mion si individualitet i veçantë, takohemi me pikturen e tij të vërtetë.

C'ndodhi në këtë kohë? Në paletën e tij hyr bluja si një «çelës i artë» për të rritur frymëmarrjen në pikturne e tij. Por kjo nuk do të thotë se nuk ka më asnjë lëkundje. «Fshati Tushemisht», 1931, «Natyre e qetë», 1932, «Butrinti», 1932, madje edhe më vonë, më 1938, «Rrugë në Korçë».

Janë raste kur piktura e tij bie përsëri, nganjëherë, te gria dhe, sigurisht, përfundimi nuk është i mirë. Shembulli më i qartë, «Malet e Moravës», i ndërtuar në raportet e grisë së rëndë me rozën në portokalli të shuar të perëndimit. Më tepër se pasigurinë dhe gabimin, kjo pikture tregon sa i lidhur ishte ende piktori më riprodhimin e thjeshtë të natyrës.

* * *

Vitet 30 qenë vite të begata në krijimtarinë e Mios, vitet e vrullit të pjekur rino. Syri i tij i mprehtë zbulon ngado bukurinë e pamjeve të atdheut, edhe aty ku ndonjë tjetër nuk do të mund të gjente gjë. Një faqe kodre («Kodrat në Dardhë»), një qzell me re të rënda, që grisën nga drita e dieillit («Duajt»), një tufë plepash («Vjeshtë»), një shteg i artë që të nxjerr në ligen («Fusha e Pogradecit»), një faqe ndërtuese («Në Tushemisht»), një leh grunoreje, mjaftojnë për të thurur poezi.

«Vjeshtë e vitiit 1934». Përmasat të vogla. E arta e okrës plotësohet butë në të gjelbrat. E kaltra qiellore i nënshtrohet plotësisht të ngrrohtës së vjeshtës. Dy kalorës ngasin kuajt me revan, të anuar paksa përpara, sipas ritmit.

«Në fushën e Korçës», penelatatat gjysmë të lëngshme të arta të okrës venë gjer te portokallia. E blerta hyn mes tyre dhe shuan etjen. Horizonti pajtohet me këtë shqërim të lumtur, në kaltërsinë e tij, në butësinë e ndritur e të praruar. Gjithçka bëhet e lehtë dhe e thjeshtë, e bukur.

«Në Durrës». Si një shënim i mbajtur në bllokun e xhepit, me bojë vaji magjike, me tone delikate. Çfarë sheh syri, kthehet vetiu në bukuri të materies, në këngë të saj, të spontaneitetit dhe thjeshtësisë së shprehjes.

«Natvrë e qetë». Ndjenja e vërtetësisë shfaqet e plotë përmbi telë, e mprehtë, e pagabuar. Zbulohet e bëkura edhe në gjérat e thjeshta, në jetën e gjallë. Gjashtë kokrra fiq të zinj, që për piktorin duan të thonë blu, dhe një vazo e vogël porcelani, me arabeska blu, një lugë përmbi të, dhe mjafton. Këto pak gjëra kthehen në një pikturë të vogël imoresionuese, të ngrrohtë në ngjyrë dhe të afërt sidomos për ndjenjën e vërtetësisë së saj.

«Pogradec 1936» në dritë hëne. Vjollca e heshitur, e papritur, e tkjeshtë, që bëhet melodioze për shkak të hënës së artë, e cila derdh reflekset e dritës përmbi valët e buta. Pluhuri i artë spërkat tërë këtë vegim mbi ligen.

Ka pasur çaste kur ndjenja e ndërtimit ua ka lënë vendin vizioneve të tretura në pafundësi, penelatave dhe ndjenjave kalimtare, thellësisht romantike, aty ku forma kufizon me mungesën e saj, aty ku kujtimet dhe mbresat këmbehen si flladi. Aty Mioja sikur s'është më ai; një vrull i ri e i panjohur ia pushton shpirtin. Ç'kujtime janë, mos është rinia e tij e largët, dashuria e hershme? «1939. Fusha e Korçës».

Mirëpo ja ku çdo gjë vjen e kthehet në gjendjen e saj të parë dhe realiteti kthehet sërishmi me tërë pamjen e tij të përcaktuar mirë. Konkrete, me të gjitha hollësitë, që nuk arrijnë ta dëmtoinë përfytyrimin e tij poetik. «Rrugë për në fshat. 1929». Është po ashtu një kuadër mjaft i vogël. Pa konture, se nuk duhen, nuk hyjnë në punë, as dhe kur fjala është për të vizatuar njerëzit që kthehen nga pazari. Natyra dhe njeriu shkrihen në një, penelatatat kalojnë lehtësisht nga niëra figurë te tjetra me forcën tërheqëse të befasisë.

«Liqeni i Pogradecit» është pikturuar më 1931. Okra që del nga e kaltra dhe që është qartësuar dëri në fund, zoteron përmbi plazhin, qellin dhe detin, i cili bën sikur e kundërshton, por kaq butë dhe ëmbëlsisht, saqë bashkëbisedimi i tyre është shfacia më e plotë e dashurisë. Njerëzit ndihen atv të lumtur si vetë natyra në harmoninë dhe vazhdimësinë e saj të përsosur. Çdo gjë ka falur dicka nga vetja për hir të harmonisë së plotë, të përgjithshme.

Më 1939, në sheshin «Skënderbej» në Tiranë.

Piktori arrin të shprehë diellin e artë të pasdites së vonë, duke e gjallëuar tërë pamjen me kundërvënien e dritës së artë ndaj hijeve vjollcë. Është një nga pikurat më të bukura që i janë bërë kullës së Sahatit dhe sheshit «Skënderbej». Linjat dhe penelatat burojnë qetësi dhe harmoni. Gjer dhe via prozaike e trotuarit është një linjë e artë, sikurse një grup i thjeshtë muresh të rënda një element shprehës.

«Vjeshtë 1932». Në një sipërfaqe të vogël në të verdhë, ose, më saktë, një kundërvënie e okrës së zbardhur ndaj së gjelbrës shumë të qartë, me të verdhë. Plani i parë, toka, është e zhveshur. Disa bisqe të holla barishtesh të thata krijojnë linja vertikale, që i ngjajnë grurit. Kontrasti grafik është kaq i lehtë, sa gati nuk vihet re. Gjesti i thjeshtë, i përzemërt.

«Në Tushemisht», 1930. Goditja kryesore është vjollca e ndërtuesës. Qielli i kaltër i bindet kësaj ndërtese, degët e gjelbra i nënshtronë gjithashtu disiplinës si çdo gjë tjetër, sikurse plani i parë, toka me shkurret, të cilat ky ndikim i ndërsjelltë i kthen, për çudi, në gri.

* * *

Çfarë i interesonte Mios kur vizatonte? Ndërtimi i thjeshtë i objekteve, vlerat tonale dhe drita. Nuk është se kërkon ndonjë cilësi të veçantë përtë hyrë në brendinë e vizatimit, të muzikës së tij plastike. Ai regjistron më thjeshtësi ato që i interesojnë. Dhe, si rregull, i interesojnë ato gjëra që i shërbejnë pikturës së tij. Por nuk është nga ata piktorë që edhe pikturen ia besojnë vizatimit. Ai e kupton, e ndien, se nga një pikturë e atillë do të krijohej përshtypja e thatësisë dhe manierizmit.

Jo, çfarëdo që të ketë arritur me vizatimin, ai merr kasetën dhe vete e ngulet para natyrës, duke i besuar asaj plotësisht, vetëm asaj, duke mos e ndërruar takimin e drejtpërdrejtë me të me asnjë lloj ndërmjetësie.

Për Mion e bukura është konkrete, reale, ajo ndodhet para syve tanë dhe s'ka kurrfarë nevoje përfantazinë, pér ndryshime dhe pér shpikje. Por kjo nuk do të thotë se Mioja nuk zgjidhë ose nuk dinte të zgjidhë. Përkundrazi, ai zgjidhë shumë dhe dinte çfarë zgjidhë.

Mioja kompozon shumë mirë, sepse shkon me vetëdije te peizazhi i ri, i zhveshur nga çdo paramëdim formal. Ai i nënshtronet plotësisht, në mënyrë të ndërgjegjshme, asaj që gjen aty, në gjirin e natyrës, pa u munduar asnjëherë ta shtrëngojë natyrën të futet në skema kompozicionale të mësuara më parë. Këtu qëndron edhe shkaku i përshtypjes së të papriturës që bëjnë mjaft kompozime të tij, ndërsa e papritura më e rëndësi shme e këtyre peizazheve është vërtetësia e kompozimit, e vendosjes së planeve dhe objekteve. Prandaj edhe i mbante me vete ai ata dy katërkëndëshat prej teli.

* * *

Cilat janë disa nga tiparet e pikture së Vangjush Mios? Mund të thuhet se bukuria e peizazheve të tij qëndron në qartësinë e vështrimit të artistit. Me këtë nuk duam të themi se Mioja i pjekur e i formuar kishte arritur t'i flakte tej të gjitha mësimet e shkollave që njozu, dhe të mjesdit ku u formua. Piktura e tij mbetet brenda shijes së kohës së tij, në kuptimin më të saktë të fjalës, dhe nuk gjemë dot asnjë përpjekje serioze

në veprën e tij që të dëshmojë se piktori donte të dilte në ndonjë farë mënyre nga kufijtë e praktikës së tij, që është edhe praktika e përgjithshme, e mirënjohur e piktorëve realistë të çerekut të parë të shekullit tonë në Evropë.

Mioja nuk shtroi probleme të ndërlikuara dhe as probleme të reja në zgjedhjen e temës, në interpretimin e saj, në ndërtimin e subjektit, të strukturës piktorike, të konvertimit fë natyrës në pikturë.

Nga ana tjeter, nuk mund të thuhet se piktura e Mios është ajo e toneve të ndritura optimiste, një pikturë e gjuar dhe tërë dritë e shkëlqim. Përkundrazi, ajo është një pikturë e qetë, siç ishte vetë ai: i shtruar, pak i ngadalshëm, i sigurt në fjalë dhe në gjeste. Drita e peizazheve të tij, është gjithashtu e qetë, e përbajtur, e shuar.

Mioja pikuron me kafe, më ngjyra të thyera, të neutralizuara, në këtë ose atë shkallë. Për të nuk kanë ekzistuar problemet e zhvillimit të pavarur të ngjyrës, probleme të intensifikimit të ndërgjegjshëm të saj përfundimisht e shprehjes artistike. Mioja ishte plotësish i kënaqur me organizimin natyror që gjente, dhe përpiquej t'ia nënshtonte një disipline të caktuar, që të kapej nga syri normal. Ai nuk përpiquej t'i largohej aspak ngjyrave që gjente te natyra, sikurse nuk përpiquej të zbulonte jehonën e thellë që përbanë në vjetvete çdo ngjyrë që natyra propozon. Atëherë, ku qëndron vlera e ngjyrave në peizazhet e Mios?

Harmonia kromatike që kërkon dhe arrin Mioja, është harmoni e kërkuar jo në paletë, por në natyrë. Ai e nis punën pasi ka zbuluar një lidhje të caktuar ndërmjet toneve të natyrës. Tërësia e kuadrit që ndërtion pastaj, përbëhet prej tonesh, të cilat e arrijnë vërtetësinë kromatike secili më

vete dhe jo nga raporti i këtij toni me tërësinë. Pasuria e nuancave për Mion nuk ka ndonjë rëndësi vendimtare.

Mioja nuk është piktor i ngjyrave të pastra. Këtë ai nuk arrin ta realizojë as në peizazhet e preferuara me ngjyra vjeshte, më ngjyra ku zotërojnë okrat e arta, të gjelbrat e tokës, e kuqja në kafe, të cilat, siç dihet, nuk hyjnë në ngjyrat e pastra.

Hijet te Mioja janë ndërtuar sipas parimit tonal, siç praktikohen përgjithësisht në pikturen tonë. Është mjaft e vështirë të gjesh në pikturen e Mios penelata ngjyre të pastër; të vetmet që arrijmë të gjejmë, janë disa grimca të verdha që «i kanë shpëtuar» te «Studimi» 1956. Te «Vjeshta» e vitit 1938 e verdha nuk guxon të shtyhet më tej nga e verdha napolitane. Hijet nuk janë të tejdukshme, por opake. Në përgjithësi, piktorët tanë punojnë me hije opake.

Mioja nuk është piktor i diellit të fortë. Moti tek ai është i vrenjtur, dielli i zbehtë dhe, të shumtë që ai arrin, është një kthjellësi pas shiut, pa diell, ose një agim herët. Edhe kur ka diell në tablonë e tij, ai është i vrenjtur. Kjo e vërtetë shtrihet mbi gjithë pikturen tonë dhe, natyrish, përbën mangësi. Dielli i fortë dhe drita e shkëlqyer e natyrës së Shqipërisë, dritë që u bën përshtypje gjithë të huajve që vizitojnë vendin tonë, nuk ka mundur të gjejë zgjidhjen e duhur në laboratorin krijues të piktorëve tanë gjer dhe sot e kësaj dite.

Mion e ka tërhequr më tepër vjeshta nga pranvera, anësi ose parapëlgim ky i njohur dhe karakteristik përfundimisht e piktorët tanë, dhe kjo flet përfundimisht e pastërtisë së ngjyrave. Dihet që vjeshta nënkuption «ngjyrat e pjekura», okrat, të kuqet terra, terrat vete, të gjelbrat e tokës, d.m.th., të kundërtat e ngjyrave të pastra.

Sa për atë që Mioja në pikturen e tij niset ndoshta nga arti popullor, kjo mund të jetë vetëm një dëshirë jona. Karakteri popullor i veprës së Mios fshihet në vetë shpirtin e Mios dhe jo në ndonjë strukturë vizive. Përkundrazi. Po të gjy-kosh duke u nisur nga analiza gjakftohite e strukturës piktorike, piktura e tij nuk ka të bëjë me temperamentin e shquar të dekoracioneve tonë popullore. Piktura e Mios është pjesë e një tradite dhe trashëgimie të caktuar, e asaj tradite që përgatiti piktura e Stamos, e Zajmit, e Kacelit, Reçit, Kodhelit, e motrave Zengo, e Grezdzës etj.

* * *

Në pikturen e Mios drita dhe hija janë thelbësore. Ai modelon nëpërmjet dritës dhe hijes ashtu siç pikuron nëpërmjet të ngrohtës dhe të ftohtës. E ndan dritën nga hija qartë, në mënyrë opake, në zona masive.

Në pikturen e Mios nuk gjen dot asnjë hije të tejdukshme. Tejdukshmëria në pikturen e tij ka një kuptim krejt relativ. Ndërtimet e tij janë opake. Madje mund të themi se Mioja është një piktor që nuk ka ndonjë konsideratë të lartë për tejdukshmërinë e ngjyrës. Ngjyrën e kupton të plotë, «të njegjeshur», në çdo pjesë të tablosë, pikë-pamje kjo mjaft e përhapur për hir të thjeshtësisë së saj praktike, por që nuk ka ndonjë bazë shkençore.

T'u hedhim një sy trungjeve të drurëve që ai pikuron, nga një kuadër në tjetrin. Ndërmjet dritës, hijes dhe gjysmëhiges, si dhe refleksit, nuk ka asnjë ndryshim cilësor. Ndryshojnë vetëm numancat e ngjyrës.

Kështu p.sh., në pikturat «Vjeshtë» «Grua

me fëmijë» dhe «Bujku duke lexuar» 1941, piktori ka të bëjë me diell të fortë. Meqenëse detyrohet t'i mbajë parasysh këto fakte, nis dhe i ngarkon degët nga njëra anë me të verdhë napolitane (d.m.th. me okër shumë të zbardhur), e cila nuk ka ndonjë ndryshim cilësor nga kafeja e trungut. Në gjysmëhijet shtrëngohet të shtojë blu, e cila gjithashtu gllabërohet nga kafeja, duke humbur çdo forcë dhe vullnet për të kundërshtuar.

Mungesa e tejdukshmërisë së ngjyrave të Mios zbulohet edhe më qartë në motive më reflekse të objekteve në ujë, në pasqyrimin e tyre në ujë. «Ura në Shën Naum», 1941. Ura reflektohet jo sipas ligjeve të vërteta të tejdukshmërisë së ujit, por nëpërmjet po atyre ngjyrave, krejtësisht të njëjta, duke ndërhyrë pa shkathësi me disa penelata që vizatojnë, por nuk piktuojnë asgjë. Kështu, pjesa ku reflektohet ura, të jep më tepër përshtypjen e një tabani pa ujë. Kjo mund të vihet re në të gjitha peizazhet me ujë.

Jo vetëm që është dëshirë e kotë dhe e pakuptimitë ta quash Mion kolorist dhe mjeshtër të ngjyrës, sic mund të ndodhë në ndonjë cast entuziazmi të falshëm, po mund të provohen lehtë çaste të caktuara pasigurie të Mios në ngjyrë. Çaste të tillë nuk e ulin vlerën e veprës së Mios në tërësi, vetëm se provojnë që harmonitetë kromatike të tij janë frymëzime të drejtpërdrejta nga realiteti, dhe vetëm kaq. Ato provojnë edhe nga një pikë tjetër se te Mioja nuk duhet të kërkojmë ndërtimë të pavarura të një mjeshtri të ngjyrës.

Shkëlqimi i vërtetë i mjeshtërisë piktorike të Mios është drita, drita e arritur në mënyrë krejtësisht empirike, por që piktori ia rrëmbente natyrës me mprehtësinë e jashtëzakonshme të syrit.

Ishët kjo mprehtësi vështrimi që e kthente pamjen reale në art nepërmjet një ndjeshmërie po kaq të jashtëzakonshme ndaj toneve, shkallëzimeve tonale, ndaj bukurisë së papërsëritshme tonale që paraqet pamja reale e zgjedhur nga ai. Për këtë Mios i mjaftonin plotësisht ngjyrat e ngrohta, të thyera.

* * *

I tillë mbetet Mioja në pikturen tonë.

Në veprën e tij të gjerë mund të gjejmë edhe fjalë e vargje të palidhura mirë me tërësinë, vargje prozaike të regjistruara në çaste rënjeje shpirtërore a ftohtësie. Po dielli i fshehtë i shpirtit të tij të mirë përsëri ndriçon dhe ngroh me dritën e tij të qetë një vepër të frymëzuar. Me këmbëngulje dhe pasion shembullor, ky usta korçar i penelit, në dukje tepër i sigurt dhe paksa ironik, por në brendësi mjaft i ndjeshëm dhe çuditërisht delikat, mblodhi gjatë jetës së tij kaq shumë nga drita e qetë dhe ngrohtësia e natyrës shqiptare, nga thjeshtësia dhe përzemërsia e shpirtit të popullit tonë!

MJESHTRI I PIKTURËS ABDURRAHIM BUZA

Abdurrahim Buza, njëri nga personalitetet më origjinale të pikture sonë, ishte në radhë të parë një tregimtar me kujtesë të mrekullueshme. Ai e kishte lehtë të vizatonte me hollësi gjëra dhe pamje që i kishte parë dikur, në fëmijërinë e tij të largët, si t'i kishte parë dje.

Tematika e veprave të Buzës buron nga vetëjeta e tij. Aty shikojmë mqedise, tipa, qëndrime, gjestikulacione, që janë njojur dhe thithur në mënyrë të pandërgjegjshme që në fëmijëri, me mallin që jep koha dhe largësia. Sepse Buza ishte kosovar.

Nuk është një botë e vogël kjo e Buzës. Kujtesa e tij, me forcën e përfytyrimit, arriti të rindgjallte një botë shqiptare të pasur. Duke parë skicat e tij të panumërtë — dora nuk i pushonte, si të ishte një organizëm që merr frymë — bindesh se këto kompozime me luftëtarë, beteja, me jetën e fshatit, të shtëpive, të grave e të foshnjave, me kafshët, pajimet, nuk mund të jepeshin më mirë sesa nga dora e këtij artisti.

Është një larmi që rrjedh prej fëmijërisë, nga kujtimet për trimat e Bacë Bajramit, për të

mëdhenjtë e shtëpisë, me në ballë të oxhakut trimin, të rëndin, por edhe hokatarin, të lëkundurin.

Ai na bën të kujtjmë diçka nga mjediset e fshatit, këngën mëngjesore të tundësit me aromën e gjalpit të freskët, diçka nga vështrimi i drithëruar i nënës në netët e errëta të frikshme të dimrit, jehonën e dasmorëve të krisur tek turren në garat e tyre plot bujë dhe zhurmë, më kuajt e bardhë, të lehtë e të shpejtë, nën klithmat e gëzuara të malipherëve, diçka nga turpi i ëmbël i nuses së re kosovare me zigomatikë të plotë dhe me qëndrim të respektuar, diçka nga vezullimi krenar i syve të trimit tek zbret shkallët e kullës me dyfekun e hedhur krahëve, në një skorçio monumentale të kokës, krenarinë plot elegancë të Shote Galicës, trimat e çartun.

Para syve tanë ai kompozon tërë një panair shqiptar të ngjyrshëm, fshatarë të largët, njerëz të sigurt në truallin e tyre, hallexhinj, të këputur, por përherë shqiptarë. Buza është një piktor që ringjall para nesh përfytyrimin e shekujve kur Shqipëria lidhej me Lindjen nëpërmjet udhëve, karvaneve, qilimave, sepeteve, veshjeve, stolive, pazareve; por mjafton prania e njeriut në tablonë e tij, që të gjallërohet aty një shpirt rrënjosht shqiptar.

Te piktura e Buzës njeriu shikon kombin tonë të shpëtar nga valangat e një shkeljeje orientale, dhe kjo i jep vetë aktit të soditjes dramacitet dhe mallëngjim. Spektatori ndien te ky piktor atë që mund të ketë ndier katundari i thjeshtë shqiptar kur doli më në fund «në selamet»: një triumf të shpirtit shqiptar mbi çdo peshë të huaj. Dhe të gjitha këto janë të shprehura me një thjeshtësi që të bën përshtypje,

* * *

«Kur vizatoj malësorët, vizatoj trimninë».

«Rafaeli e të tjerë i banin të bukra madonat, se dojshin që, kur t'shkojshin njerëzit, t'i pëlqenin, t'i adhuronin. Një madonë të shëmtuet kurkush nuk do të shkonte me e pa».

«Figura e njeriut nuk ka nevojë vetëm për kolorit, por për poezinë!»

«Bane njeriun njeri... Kur asht në luftë, tjetër fytyrë ka, kur asht në punë, tjetër».

(Bisedë me A. Buzën).

Tematika e re e realitetit socialist të Shqipërisë përbën një vazhdimësi organike në talentin e Buzës. Në mënyrën e tij të qetë dhe pa bujë ai zbulon me thjeshtësi poezinë e viteve të para të Çlirimt, portretet e partizanëve të thjeshtë — cilirintarë të Tiranës, të heronje të revolucionit popullor, tiparet e shtrenjta rinore të Komandanit. Ai kthehet sërishtmi te flakët e betejave partizane, te reflekset e përgjakta të barrikadave në sheshin «Skënderbej», e edhe më prapa, te masakra fashiste e 4 shkurtit 1944. Dhe kudo është i pranishëm me kasetën e tij, kur «Vullnetarët e kombinatit» hedhin kazmat e para në themelët e industrisë sonë tekstile, kur nisin hidrocentralet dhe ngrihen digat e drithës, kur thahen kënetat dhe bëhet bonifikimi, kur hidhen shinat dhe digjet kanuni i zi, kur vajza e mbyllur e malësisë zbret në qytet dhe i ndritin sytë në auditorët e universitetit të parë shqiptar, nga drita e shkencës dhe e diturisë. Në malësitë e «Mujit dhe të Halilit» hyn drita e qytetërimit, drita e socializmit. Në shtëpitë e reja moderne, që u ndërtuan mbi themelët e kullave të shembura, dhe në vatrat e

kulturës hynë radioja dhe televizori, kumbon fjalë e Partisë dhe e Enver Hoxhës, fjalë e marksi-zëm-leninizmit fitimtar. Fëmijët e së sotmes, që Buza i pikturon përherë me faqe të kuqe si pjeshka dhe me buzët-qershi, hidhen dhe lodrojnë me qengjat borëbardhë. Bariu i gëzuar ka lënë për një çast fyellin, se në radiotranzistorin e tij Tirana transmeton një prelud të Shopenit. Dhe vetë natyra sikur është zgjuar nga një dritë e re aty ku pishat e Divjakës shpërthejnë kurora të reja ngjyrë smeraldi në qiellin e artë të bregut të ngrohtë myzeqar.

* * *

Abdurrahim Buza ishte i afruar dhe i thjeshtë, sikurse mbetet e thjeshtë përherë dhe e kuptueshme piktura e tij.

Gjëja e parë që të bën përshtypje në tërë krijimtarinë e tij, është fryma rimore e piktorit të moshuar me shpirt djaloshar, të dashuruar me njerëzit, me jetën, me artin. Vizatimet dhe pikaturat e tij i shquan optimizmi dhe humori dashamirës. Duke mbetur përherë artist i rrallë, Buza u drejtohej zemrave me gjuhën e sinqertë të artit të vërtetë. Në qoftë se thuhet që jeta e artistit të vërtetë dhe ajo e popullit të tij janë një simbiozë e pambërim, një nga shprehjet e kësaj së vërtete e gjejmë në jetën dhe punën krijuese të Abdurrahim Buzës.

Nuk do të gabonim po të thoshim — dhe sidomos në dritën e gamës së larme të personaliteteve të sotme të pikturës dhe artit tonë — që Buza është bërë klasik.

Buza është shembull i artistit që ka punuar përherë për cilësinë. Me kërkime të pandërprera,

me durim të veçantë, arriti ai të bëjë në sipërfaqe të vogla zbulime të mëdha. Ishte një artist plot vitalitet, artist i të papriturave dhe i shkumeve të vërteta krijuese. Që në fillimet e para ai ndoqi me besnikëri frymëzimin e tij nga populli. Në këtë mënyrë, shumë shpejt arriti t'i afrohet shikuesit me personalitetin e tij të veçantë.

* * *

«Mjeshteria asht me e lanë të freskët pikturën. Aty ku s'duhet, nuk e prek ma! Artisti ka forcën e vizionit!»

«Ticiani i shkruante një mikut të vet një letër kur ishte 86 vjeç: «Më vjen keq me vdekë, se njitash kam fillue me e kuptue artin...»

(Bisedë me A. Buzën)

Abdurrahim Buza jetoi tërë jetën në harmoni me vizionin e tij artistik. Në shikim të parë ai dukej i drujtur, por, kush e njihte nga afër, bindëj shpejt për besimin që kishte në vetvete dhe në artin e tij, besim që është tipar i originaliteteve të lindura dhe nuk ka të bëjë me vetëbesimin e mjerë të mediokrit. Kjo i dha mundësi Abdurrahim Buzës që të mos i merrte parasysh shijet e ndryshme vetjake dhe ta shpëtonte natyrën e tij nga ndikimet dhe ndërhyrjet e pavend. Sepse ka pasur edhe ndër kolegët e tij njerëz të artit, që e kanë pasë parë për një kohë të gjatë si një dukuri të rastit dhe të pajustifikuar.

Ndër veprat e piktorit ndodhet edhe një autoportret i vitit 1953. Buza e ka bërë nën presionin e disa shokëve, të cilët qenë të bindur se në këtë mënyrë niseshin nga pozitat e «realizmit». Për ne sot ata janë nisur thjesht nga pozitat e jokoloriz-

mit. Duke mos pasur në brendësinë e tyre burime ngjyre të forcës së Buzës, ose, më saktë, duke mos mundur të zbulojnë në realitetin objektiv një fuqi shprehëse më të madhe të ngjyrës, ata çuditeshin me pikturen përherë intensive të tij dhe kërkonin me ngulm ta shikonin edhe atë në përmasat e tyre. Vërtet që kjo pikture e Abdurrahim Buzës bie në sy menjëherë mes shoqeve të saj të mëparshme dhe të mëvonshme, dhe nuk ka të bëjë me ndjeshmérinë e Buzës. Nuk dimë se në ç'gjendje e piktuori ai këtë shmangie të krijimtarisë së tij, që një sfidë, apo një lëkundje? Por, ashtu si në Itali, djalosh i ardhur nga një botë e prapambetur, i bëri ballë ndikimit të bashkëstudentëve dhe shpëtoi mënyrën e tij origjinale, edhe këtë radhë ky nuk qe veçse një episod, që e bindi edhe më tepër për pikturen e tij.

Të gjithë janë të zotë të hedhin ngjyra të forta, të pakontrolluara përmbi pëlburë, qoftë edhe duke pandehur se po dridhen nga emocionet. Tek ai ekuilibër i dëshiruar, ku ngjyra arrin mësën e ndjenjës, artistët arrijnë vetëm pas një kohe të gjatë vëzhgimi të kujdesshëm të realitetit, ose nuk arrijnë kurrë, duke mbetur sklevër të një keqkuptimi, që i ka rrënjet në mungesën e talentit dhe të inteligjencës. Abdurrahim Buza e ka pasur një ekuilibër të tillë, gjithmonë e prej natyre. Kjo gjë duket qartë në gjithë krijimtarinë e tij.

* * *

«Në fillim fare mua më banin përshtypjë kristalët, gurët me ngjyra të unazave, kapakët preqelqi me ngjyra të bukurë; i shihja ato kundrejt diellit dhe kënaqeshë. Ato ngjyra u përpolla t'i nxjerr në pikture.

Një ditë, në Akademinë e Arteve në Florence zura miqësi me një italian. Njëherë ai, si shok, ma mori tavaloçën dhe filloi të më mësojë se si vihen ngjyrat. Për këtë ai filloi të punojet te piktura ime. Pas një ore vjen profesori, i pa të gjithë; kur vjen tek unë, sa e sheh punën time, vrenjtë, vete tek ai studenti, se e kuptoi dora e kujt qe. E shau, e bani qepaže dhe pastaj iku i zemruem, duke e quajtur fajtor. Gjer atëherë nuk i kisha pasë pa punët e tyre, që të mos kujtonin se po i kopjoj. Profesori më shpëgoi se tek unë ai shilte ngjyra. Ata nuk kishin ngjyra, ua humbshin atë kristalin ngjyrave, i përzijshin, i banin pis me të zezë. Ua humbshin ngjyrat...»

(Bisedë me A. Buzën).

Buza është një artist që ka ruajtur spontaneitetin dhe natyrshmérinë e zhvillimit të tij harmonik. Shumë shpejt tërroqi vëmendjen dhe u imponua me personalitetin e tij të veçantë. Ka kohë që asjeri nuk çuditet nga shprehjet «të vizatosh si Buza», ose «të piktuosh si Buza».

Vizioni i tij ka diçka groteske, groteskë në mënyrë fëmijërore. Te shumë nga figurat dhe ndërtimet e tij ndiejmë çudinë dhe dëlirësinë e vështrimit të jetës. Ai di të jetë i guximshëm, pa u bërë kurrë i çuditshëm, di të të rrëmbejë, pa të hutuar e pa të trulloj.

Me thjeshtësinë e mjeshtrit popullor dhe pa u kthyer aspak nga shembulli klasik i artit, Buza ka shfrytëzuar në mënyrë origjinale elemente të teknikës së klasikëve.

Mjeti i tij i preferuar mbetet ngjyra. Sapo fillon të modelojë volumet dhe hapësirat me penelata të lira, të pakushtëzuara prej konturesh e vizatimi të hollësishëm paraprak, krahу i tij fiton

forcë, fantazia i merr fletë. Tiparet e shquara të këtij piktori lidhen shumë me vështrimin e tij prej koloristi. Origjinaliteti i këtij vështrimi dallohet që në punët e tij të rinisë. Ndjeshmëria e veçantë ndaj ngjyrës, e cila është ndoshta cilësia kryesore e tij, e udhëhoqi më tej këtë shikim, zbuloi teknikën dhe përcaktoi tiparet stilistike origjinale të pikturës së tij. Ndaj është e kuptueshme që në sferën e ngjyrës përvoja e Buzës përbën një kapitull të veçantë në historinë tonë të artit të realizmit socialist.

Natyra piktorike e përfytyrimit të Buzës nuk ka asgjë të përbashkët me atë të një piktori dekorator. Ndonëse ka punuar dhe ka krijuar vepra të rëndësishme të pikturës së aplikuar në nivel të denjë për të, vështrimi koloristik i tij ka mbetur ai i piktorit të kavaletit. Modelimi i Buzës mbetet vëllimore me kalime të njëpasnjëshme plastike dhe koloristike, i mbështetur pjesërisht në teknikën e mjeshtreve të vjetër, të së qartës mbi të errëtën, d.m.th. i gdhendjes së figurës dhe vëllimeve që dalin nga thellësia.

Historia e gjatë e pikturës realiste dhe klasike të kavaletit dhe ajo e pikturës klasike në përgjithësi japid mënyra pafundësish të larmishme të modelimit nëpërmjet ngjyrës. Duke u nisur nga kriteri i rolit që luan ngjyra në tërësinë e veprés, mund të dallojmë dy tipa piktorësh: piktorë, të cilët ngjyrën nuk e kanë kryesore, që kënaqen me një harmoni të thjeshtë, të përpunuar sipas kriteresh të trashëguara nga tradita, të mirënjoitura në kohën e tyre, ose të marra drejtpërdrejt nga natyra, këta ia lënë përparësinë vizatimit, d.m.th. modelimit plastik, tonal dhe linear. Të tjerë piktorë, të tipit të dytë, e vënë ngjyrën në plan të parë për nga rëndësia dhe jo vetëm që e ndërtojnë tablonë sipas një akordi zotërues, por edhe

e pastrojnë gjuhën e saj gjer në shkallën më të lartë, duke shfrytëzuar të gjitha mundësitë muzikore të saj. Është e padobishme të polemizojnë se kush qëndron më lart, «Xhokonda» e ndërtuar mbi poezinë gjeniale të «sfumatos» së toneve të Leonardos, apo «Klaudis Civilis», që Rembrandti e ka ngritur krejtësisht mbi çudinë e së verdhës së artë. Megjithatë, koloristët kanë favorin të jenë më të rrallë.

Për Buzën mund të thuhet se «mendon me ngjyra», sikurse poetët e mirë që «mendojnë me figura». Këto ngjyra nuk janë kopjuar nga realiteti, por frymëzuar nga ai, janë ngjyrat e realitetit të interpretuara me guxim dhe mjeshtëri nga artisti realist. Në interpretimin artistik të ngjyrave vepron i njëjtligj i realizmit, që i ka shërbypër mjeshtrit Paskali për të dhënë në forma vëllimore të interpretuara madhështinë epike dhe pasionin e vrullshëm burrëror në portretin e Kastriotit. Gjuha e mjeshtreve është gjuhë e passioneve të mëdha dhe mjetet e tyre shprehëse janë gjithashtu interpretime të guximshme dhe të fuqishme të së vërtetës së përditshme. Ekuilibri i rëndomtë natyror nuk mjaftron për një artist të shkallës së Buzës, ndaj ai, duke shtuar forcën shprehëse të ngjyrës, arrin në një ekuilibër të ri, më të lartë, duke e ngritur kështu të vërtetët e përditshme në të vërtetë artistike.

Ndihmesa e Buzës në pikturën tonë është veçanërisht e shquar edhe për interpretimin e fuqishëm realist të ngjyrës. Vitet nuk ia turbulluan e nuk ia zbehën vështrimin, ai mbeti i pastër, i pandikuar, i mprejtë deri në fund. Ekuilibret e tij koloristike, si edhe zhvillimet e ngjyrës, brenda çdo kuadri janë përherë zbulime dhe asnijëherë balancime të fjetura e asnjanëse.

Buza nuk e sakrifikon asnijëherë gjallërinë je-

tësore të ngjyrës për hir të ndonjë harmonie të sprovuar ose përshtypjeje kalintare. Në këtë pikë ai u ngjan mjeshturve tanë popullorë, të cilët, me intuitën gjeniale të artistit spontan, kanë mundur të ndërtojnë ansamble të vogla mrekullie të ngjyrave të freskëta e tingëlluese.

Organizimi i ngjyrës te Buza buron nga frymëzimi i mirëfilltë dhe i drejtpërdrejtë. Larmia e jashtëzakonshme e gamave flet për gjallérinë e shumanshme të lidhjeve të tij me realitetin, me jetën dhe për pasurinë e veçantë të mbresave të tij. Ndaj është e pamundur të nxjerrësh nga Buza rregulla të marrëdhienieve të ngjyrës, ose të har-tosh nga piktura e tij ndonjë kod ngjyrash.

Abdurrahim Buza e shikon gjallérinë e ngjyrës si një çështje themelore të shprehjes artistike, si përqendrim të forcës jetësore në shkallën më të lartë. Edhe në qoftë se në skicime të shpejta të rastit mund të gjejmë lëshime ndaj kompozimit, psikologjisë, vizatimit, të tilla nuk do të mund të gjejmë kurrrë në ngjyrë. Gjallëria jetësore e ngjyrave të Buzës është po aq e garantuar, sa edhe fryma kombëtare e pikture së tij.

Për këtë kolorizëm original të vështrimit të tij dhe për të gjitha tiparet e tjera kryesore që e karakterizojnë pikturën e tij, mund të thuhet se, sa herë që do të na duhet të kërkojmë thellë në burimet e frymës kombëtare të artit shqiptar, do të gjejmë aty edhe Abdurrahim Buzën.

NE PËRMASA NJERËZORE

Duke i parë me vëmendje skulpturat e Artistit të Popullit Kristaq Rama, të bien në sy tipare që e dallojnë dhe që janë ruajtur te vepra e tij gjatë viteve. Para së gjithash ai punon për individualizimin e personazheve, nëpërmjet të të cilëve dëshiron të shprehë idetë dhe mendimet e kohës. Ky tipar i tij organik shpjegon dhe atë vend të rëndësishëm që zë portreti në tërësinë e veprës së tij. Tipari tjetër që të bën përshtypje te ky autor është këmbëngulja për ta realizuar idenë me një teknikë sa më të saktë. Ndjenja e së përkryerës e ka shoqëruar teknikën e tij të modelimit thaujse si një ide fiksë që në fillim. Së treti, në ndërtimet e tij plastike tridimensionale, krahas thellësisë, densitetit plastik dhe fakturës piktorike, ndihet përherë kujdesi për linjën, ndjenja e linjës, zëri i saj i tërthortë.

Është e natyrshme të mendohet se një kërkësë e theksuar dhe e vazduar ndaj teknikës së përkryerës mund ta conte artistin drejt thallisë, uniformitetit, në uljen e interesit ndaj jetës së gjallë dhe larmisë së saj. Kjo s'ka ndodhur me Kristaq Ramën. Atij nuk i ka humbur kureshtja ndaj portretit. Jo të gjithë njerëzit mund të krenohen se janë të bukur fizikisht, por, pa dyshim,

që të gjithë kanë vënë re se janë të ndryshëm. Një cilësi e tillë natyrore përbën një fushë të pakanë për eksplorimet skulpturore dhe plastike. Pasioni dhe tërheqja drejt portretit ka shërbyer si një fushë ndihmëse elektromagnetike, që e ka ruajtur ndjeshmérinë plastike të Kristaq Ramës nga ai adaptim i shmangshëm që pëson një autor kur merret për një kohë të gjatë me përmasat e mëdha të skulpturës monumentale, e cila ka epërsitë e saj të një lloji tjetër. Më 1963 ai realizon bustin e Dalip Tabakut, ku për hir të ngjashmërisë dhe të karakterit lë mënjanë çdo stilizim të mundshëm. Më 1966 përurohet në Krutje të Lushnjës një grup skulpturor i realizuar nga skulptori në përvjetorin e formimit të së parës kooperativë bujqësore në vendin tonë. Figurat e myzeqarëve janë trajtuar aty me thjeshtësi dhe përzemërsi. Më 1967 realizohet prej tij busti i Ndrec Ndure Giokës në Rrëshen. Një model krejt i ndryshëm nga ato që nati trajtuar deri atëherë, një malësor i ri me sunet thuajse të ngushta, por oë spikat me zguarsinë dhe forcën e karakterit. Thjeshtësia e heroit dhe thjeshtësia me të cilën është interpretuar ai janë prekëse.

Më 1977 gjejmë të realizuar bustin e militanit të shquar komunist Ali Kelmendit dhe figurën heroike të «Guerilasit» të vendosur në Korçë. Te portreti i parë interpretimi artistik dhe kujdesi i madh për modelimin e përpiktë nuk e ka penguar skulptorin për të hyrë tërësisht në karakterin e modelit. Buzët e holla të shtrënguara fort, shprehje e vullnetit të papërkulur, hunda pak e varur dhe burrërore; asgjë nuk mbulohet dhe as zbulohet. «Guerilasi», i nisur nga pamja e vërtetë e heroit Midhi Kostani, është një figurë dinamike me një portret shumë të bukur. Bukuria e veçantë e tij qëndron jo në tiparet e zgjedhura

ideale, ose në manipulimin e tyre sipas ndonjë modeli të përfytyruar, por në atë njohje të vërtetë të tipave korçarë të arritur me mprehtësinë e vëzhgimit. Skulptori qëndroi disa vjet në Korçë dhe punoi atje. Portreti i guerilasit mund të themi se është tipizuar me zotësi, duke studiuar modele vendas, tiparet karakteristike të të cilëve nuk mund t'i ngatërrosh me tipat e krahinave të tjera të Shqipërisë.

Skulptura, sikurse tërë arti, nëpërmjet ekivalencash artistike, arrin të shprehë çaste të ndryshme të jetës njerëzore. Arti është në gjendje të shprehë me forcë të barabartë si gjëzinin, ashtu dhe hidhërimin, fitoren dhe shpirtin kryengritës, trishtimin, rënien, keqardhjen, dëshpërimin, shpresën, dashurinë, urrejtjen. Për të gjitha këto arti ka gjetur gjuhë të përshtatshme realiste, se të gjitha janë ndjenja njerëzore.

Kur e bëjmë një luftëtar si shkëmb, nuk e bëjmë për hir të zakonit, por sepse duam të tregojmë me këtë që ai luftëtar ka qenë i fortë e i pamposhtur, se edhe ne krenohemi me këto cilësi të larta njerëzore që ka pasur ai. Po kur e vizatojmë këtë luftëtar që kthehet nga lufta, përmbi djepin ku fle i biri i tij i vogël, që ai e sheh për herë të parë, dhe pranë tij vështrimin e mallëngjyer të nuses së tij të re, këtë luftëtar nuk do ta bëjmë përsëri si shkëmb e si hekur.

Në këtë kuptim, arritet jetë mira të artit tonë të realizmit socialist dhe vepra e artistëve të shquar si Kristaq Rama mund të shërbejnë edhe si shembull pozitiv i luftës që duhet bërë kundër qëndrimit skematik, kundër trajtimeve të thata, artificiale. Duke parë portretin e «Pianistes» të Kristaq Ramës, të eksposuar më 1983, të bën përshtypje pikërisht që e ka tërhequr autorin te kjo artiste e re jo bukuria fizike, por bukuria dhe pa-

suria shpirtërore e saj. E qetë, e përqendruar, ajo thuajse ka humbur në atë zhvillim thellësisht një-rëzor që transmetojnë tingujt e tastierës. Autori, pa kërkuar aspak të na imponohet me mjetet e tij, na detyron të përqendrohem i kryesorja — njeriu.

Kur flet për veprën e Kristaq Ramës, mund të lësh mënjanë veprat e rëndësishme monumentale ku ai është bashkautor me skulptorët e popullit Shaban Hadëri dhe Muntaz Dhrami, si një kapitull tjetër që meriton studim të vecantë, por nuk mund të lësh «Shote Galicën». Kjo vepër është bërë si shembulli më i pëlqyer dhe më i plotë i gjithçkaje më të mirë që ka dalë nga dalta e tij, ndonëse vetë ideja që të kërkojmë të gjejmë në një vepër të vetme të cilitdo qoftë nga artistët «cilësitë më të mira» të përqendruara aty, është jashtë natyrës së krijimtarisë artistike. Por është e vërtetë se te «Shote Galica» dalin në pah disa nga karakteristikat që shënuam që në fillim, dhe që e dallojnë individualitetin e tij artistik. Te kjo vepër e skulptorit gjejmë, më tepër se te ndonjë tjetër, atë vazhdimësi të traditave më të mira të skulpturës sonë, të frysës epike dhe të zbulimit nëpërmjet gjuhës së tërthortë të linjës së kësaj force epike. Te «Shote Galica» e Kristaq Ramës gjejmë atë identifikim të heroit me imazhin artistik që e gjejmë edhe, p.sh., te «Skënderbeu» i Paskalit, te «Mic Sokoli» i Sali Shijakut, te «Liri Gero» e Muntaz Dhramit, te «Isa Boletini» i Shaban Hadërit, «Haxhi Qamili» i Myrteza Fushekatit.

Në veprat më të arritura të tij, Kristaq Rama ia ka dalë ta shprehë veten plotësisht me tiparet më të mira të frysësimit të tij. Vlerat e skulpturës së tij janë tipare që burojnë në mënyrë organike nga individualizimi i personazheve. Kë-

shtu, në qoftë se «Malësori», 1957, ka rënë në mendime, dhe këtë e shpreh jo vetëm me qëndrimin e tij, por edhe me atë gërshetim linjash të ndërthurura të kokës, të qafës, të veshjes, si dhe me fakturën, kjo fakturë vjen e bëhet me kohë një element i fuqishëm shprehës. Te «Sulejman Vokshi» (1978) shprehët forca burrërore e patriotit të shqipërisë, te «Haxhi Qamili» (1979) — ndjenja e revoltës dhe, në të dyja, modelimi, faktura, vendosja, veçanërisht e efektshme te busti i dytë i figurës dhe i aksesorëve, janë në shërbim të një individualizmi shprehës.

Ka raste jo të pakta kur në kompozimin e figurës te Kristaq Rama bie në sy përpjekja për raporte dinamike veçanërisht të efektshme ndërmjet piedestalit dhe bustit, ndërmjet aksesorëve dhe figurës, prerje të llogaritura për një efekt të caktuar. Ka raste kur një efekt i tillë arrihet vërtet, por, në përgjithësi, jemi të mendimit se ndërhyrje të tilla nuk ia vlejnë, kur arrihen me sakrifica të mëdha. Jo vetëm këq, por nganjëherë ato tingëllojnë të jashtme, si p.sh. te busti i dëshmorit Gjikë Kuqali.

Ka raste kur vepra e Kristaq Ramës dëmitohet nga forca e ndikimeve anësore të skematizmit, nga inercia e përfytyrimeve të trashëgura. Kështu, në punë si «Metalurgu», statujë në përmasa të mëdha, ndërtimi, duke filluar që nga lëvizja karakteristike, por gjëresisht e shfrytëzuar si nga pikatura, ashtu dhe nga skulptura, nuk sjell asgjë të re. Ndoshta është pikërisht skulptura monumentale, e praktikuar për një kohë të gjatë, e cila, krahë pasurimit me mjete të fuqishme të shprehjes, i ndikon nganjëherë autorët edhe me ca shprehi që nuk janë pozitive, sepse burojnë nga ato efekte të lira, krejt të jashtme dhe të pavlera, ku ajo vetë, skulptura jonë monumentale, ka rënë

disa herë. Një nga këto efekte është gjigantomania.

Dy veprat e fundit të Kristaq Ramës, në ekspositën kombëtare të vitit 1986, flasin për një shkallë të re pjekurie të veprës së tij. Njëra është busti i shokut Enver dhe tjetra, një kokë fëmije veshillapush e skalitur në gur, vepër mjaft simpatike.

Busti i shokut Enver është gdhendur në dru. Çfarë e dallon atë? Jo thjesht ngashmëria, por sepse karakteri i udhëheqësit është dhënë me forcë shprehëse dhe me daltë energjike. Në këtë pikë ajo rivalizon me sukses me portretin e mirënjohur, të realizuar vite më parë nga Paskali, ndonëse te mjeshtri i vjetër i skulpturës sonë nuk ekziston ai dualitet ndërmjet së përgjithshmes djaloshare dhe detajeve të pleqërisë, që bie në sy te portreti i Ramës. Paskali, me taktin e tij të mirënjohur estetik, kishte arritur të jepet një harmoni të plotë fizike, ndërsa harmonia që realizon Rama është më tepër psikologjike, shpirtërore.

INTEGRIMI LIRIKO-EPIK I DRITËS

Kur Vilson Kilica eksposoi tablonë e tij të parë «Këngë në mbrëmje» më 1959, ajo bëri përshtypje si një zhvillim i ri në pikturën tonë të realizmit socialist.

Më 1960, në ekspositën vjetore të arteve figurative, hapur në ndërtesën pranë Teatrit Popullor, «Portreti i punëtorit» i Vilson Kilicës tërroqi sérishmi vëmendjen e publikut tonë. Një punëtor i ri që kthehet nga puna, me xhaketën hedhur në njërin sup dhe cigaretën në dorën tjetër, në një qëndrim të lirë e vështirim të drejt-përdrejtë, që shpreh thjeshtësi dhe besim. Prerja e thjeshtë dhe shprehëse, pikturimi energjik. Duhet thënë se veprat e periudhës së parë të krijimtarisë së Vilson Kilicës mund të duken me më pak drithë. Por vetë fakti i qenësisë së etapave që dallohen qartë në krijimtarinë e një autori, vërteton seriozitetin e ecjes së tij.

Si tabloja «Këngë në mbrëmje», ashtu edhe «Portret i skulptorit», «Portreti i punëtorit», «Balerina» etj, janë piktuuar me tone të mesme, pa shkëlgime të dritisë dhe pa hije të rënda, në një orkestrim të ndjeshëm dhe të pasur, të disiplinuar.

«Këngë në mbrëmje». Vetë titulli e shpreh subjektin poetik të kësaj tabloje të parë, pas diplomës, të piktorit të ri. Pas betejës së egër fitimtare, partizanët janë mbledhur bashkë dhe ia nisin shtruar një këngë, këngës së heroizmit e të besimit të zjarrtë në fitoren përfundimtare, këngës së pikëllimit pér trimat që ranë. Pikëllimi kthehet në urrejtje pér armikun dhe në vendosmëri. Asgjë nuk del jashtë tonit të përgjithshëm, të rëndë, të përbajtur, të fuqishëm. Forca është më tepër e brendshme, shkëlqimi dhe pompoziteti janë lënë mënjanë. Ngjyra i përgjigjet plotësisht këtij përqendrimi emocional, duke e fshehur fuqinë e saj nën një pamje të qetë e të nënshtuar. Kafetë që anojnë nga vjollcat, okrat që kufizohen me vjollcat, oranzhi i druajtur nën pushtetin e okrës të kujton një akord të largët me violetin e shuar. Gjithçka zhvillohet rrëth këtij violeti, gjer vetë drita që rreh butë fytyrat, trupat, shoqërimet e tyre, tretet në këtë muzikë të qetë, të përmalluar. Kujtimi imbetet pérjetësisht i gjallë pér vëllanë e rënë, pér heroin e pavdekshëm. Është një pikturë e forcës së përbajtur, e krenarisë së heshtur, e mallit pér të rënët.

Në vlerësimin e një pikturë nuk është shkalla e ndriçimit të saj ajo që vendos. Dhe as që është nevoja të biem në vlerësime vulgare si ato që e ndajnë pikturën tonë ose krijimtarinë e një autori në pikturën e Paraçlirimt dhe atë të Pasçlirimt, si «pikturë e errët» dhe «pikturë me dritë». Rembrandti i madh e humbi kreditin e kohën e tij ngaqë bënte piktura «të errëta». Përbajtja e ngrirë dhe zymtësisht e trishtuar e ikonave dhe e pikturës mesjetare servirej në ngjyra intensive, të gjalla, në sfonde dhe kurora që rrezatonin ar diellor. Beteja e zjarrtë e Uçelos në «Shën Romano» është pikturuar në një mjeshtësia kafe të

errët, me kuaj kafe e të kuq, dhe është megjithatë e një dekoracioni shembullor. Buzëqeshja enigmatike e «Mona Lizës» del si një mrekulli nga thellësitë e errëta dhe ëndërruese të pikturës së Leonardo da Vinçit. «Dollibashi» i Jordansit, e mbushur me harenë e zhurmshme të një gostie, u pikturua me tone të errëta dhe me fare pak volume të ndriçuara. «Pranvera» e Grigoreskut, në Galerinë tonë të Arteve, ka vetëm një vatër të kufizuar, ku drita e shuar bie e qetë dhe e kufizuar. «Gratë algjeriane», kjo kryevepër e Dëlakruasë, që nuk ka punë me dramën, u pikturua mjeshtërisht në tone të rënda.

Pér pikturën tonë askush nuk mendon se «Bajram Currit» të Zajmit nuk i mjafton drita, se «Pazari i Tiranës» i Stamos nuk ka dritë, se «Ndërrimi i turnit» i Shijakut është mbuluar nga errësira. Shumë nga piktorët tanë parapëlqejnë ndriçimin e qetë, kur subjekti nuk kërkon aktivizimin e domosdoshém të tij. Por, duke folur në mënyrë krahasuese, mund të thuhet se Zef Shoshi piktuaron me dritë më të qetë nga Sali Shijaku, Kolë Idromenoja piktuaron me dritë më të thyer nga Abdurrahim Buza, Foto Stamoja piktuaron me dritë më diellore nga Guri Madhi etj. Natyra e vërtetë e vështrimit të Vilson Kilicës është drita e thyer, e qetë, ashtu siç është edhe ngjyra e plotë, pak e shuar, që i përgjigjet temperamentit të tij të butë.

Tabloja kompozicionale përbën arkitekturën e programuar të krijimtarisë së angazhuar të Vilson Kilicës. Hovi që mori zhvillimi i kësaj gjinie në pikturën tonë të realizmit socialist, është i posaçët kohë kur realizohen edhe disa nga veprat më të shquara të Vilson Kilicës, si «Brigadierët», «Shoku Enver Hoxha», «Gjyqi i Sinjës», «Mespatë mprehur», «U kthefsh me lirinë», «Kur

gdhiu 8 Nëntori» etj. Përqendrimi i ndërgjegjishëm dhe angazhimi për të pasqyruar në tablotë e tij kompozicionale temat e mëdha të kohës janë një fakt që flet pér ndihmesën e rëndësishme që ka dhënë ai në këtë fushë të artit. Nga ana tjetër, figura e punëtorit, si hero vendrор i epokës së ndërtimit socialist, zë një vend të nderuar në kompozicionet piktorike të Vilson Kilicës, krahas imazhit heroik të partizanit dhe të militantit komunist. Me dashuri të veçantë dhe respekt të thellë ka trajtuar artisti figurën e shokut Enver Hoxha, si në ditët e stuhishme të themelimit të Partisë dhe të organizimit e të drejtimit të luftës pér liri, ashtu edhe në vitet e ndërtimit socialist.

«Punëtorët» dhe «Dhjetor 1967» janë dy tablo të rëndësishme pér konsolidimin e mëtejshëm të pikturës së Kilicës. Tabloja e parë, «Punëtorët», trajton idenë e rolit pararojë që merr përsipër rinia ionë punëtore në revolucionin tekniko-shkençor, duke i vënë gjoksin jo vetëm prodhimit, por edhe shkencës, përparimit teknik. Kompozimi i saj eshtë mjaft kompleks, i gërshetuar, i pasur me momente psikologjike. Personazhet nuk janë modele aksidentale, por karaktere të të rinjve tanë në përgjithësi. Pasuria e mendimit gjë shprehjen e saj në pasurinë grafike dhe piktorike.

«Dhjetor 1967» trajton një motiv nga heroizmi masiv i punës me goditje të përqendruar që u bë në zonat e dëmtuara nga tërmeti. Ajo përshkohet e tëra nga tensioni i punës heroike dhe pa bujë në këtë mjedis të ngrirë nga acari. Sikurse në tërë pikturen e Vilson Kilicës, ashtu dhe në këtë tablo, ngjyra eshtë e integruar në tonin. Përherë eshtë vënë re në historinë e zhvillimeve të gjithanshme të pikturens realiste fenomeni i integrimit të tonit në ngjyrë dhe të ngjyrës në tonin.

Në të vërtetë piktura tonale që përdorin shumë nga piktorët tanë sot, e ka zanafilën që nga koha e Korosë, e Kurbesë dhe Silvestro Legës me shokë. Piktorët u cılıruan atëherë nga ai shërbim i posaçëm që i duhej bërë ngjyrës.

Integrimi i ngjyrës mund të shoqërohet ose jo nga integrimi i dritës. Për pikturen e Vilson Kilicës kjo eshtë një e vërtetë thelbësore e modelimit, burim force dhe energjie. Drita e integruar eshtë mjeti i vërtetë i tij.

Vilson Kilica ka mundur të ruajë një vazhdimësi organike në krijimtarinë e tij, duke e zhvilluar dhe duke e pasuruar artin e tij. Nuk eshtë pikturë e kontrasteve të rrepta, e ndriçimeve të papritura, e fakturave të ashpra materiale, e stilizimeve këmbëngulëse.

Arritjet më të mira të Vilson Kilicës në vitet e fundit, arritje që erdhën si fryt i një pune këmbëngulëse krijuese dhe i njohjes më të gjërë dhe të thellë të jetës në shtrirjen e saj, janë një shkallë e re e pjekurisë në krijimtarinë e tij. Më mirë nga çdo shenjë tjetër këtë e dëshmon thjeshtësia e shprehjes, e cila ka ardhur duke u forcuar në krijimtarinë e tij krahas pasurimit të tematikës dhe zbërthimit më të ndërlikuar të subjektit. Dhe arritjet janë më të dukshme kur pasurisë letrare të imazhit i përgjigjet larmia piktorike e realizimit të këtij imazhi.

«Gjyqi i Sinjës» eshtë konfirmim i atyre përpjekjeve dhe prirjeve që janë vënë re në krijimtarinë e Vilson Kilicës drejt forcimit të dekoracionit në pikturen e tij. Parimi dekorativ i ndërtimit të përgjithshëm piktorik ka qenë që në fillim kërkesë e tij dhe nuk eshtë vështirë t'ia gjesh zbatimin që në pikurat e para të Kilicës. Por interesimi i gjallë dhe konkret ndaj burimeve populllore kombëtare të artit e ka përforcuar dhe

sqaruar më tej këtë prirje. Dhe është i dukshëm pasurimi i pikturës së tij nga kjo ndjenjë dekoracioni. Ndërthurja lumenozë, gërs hetimi tonal dhe veprimi i ndërsjelltë i figurave, i bloqeve, i grupave, sikurse edhe i elementeve të tjera piktorike te «Gjyqi i Sinjës», shoqërohen nga një gjallëri koloristike më e madhe, e zbatuar sipas parimit dekorativ. Ky fakt shtrihet në gjithë krijimtarinë e dhjetëvjeçarit të fundit të Vilson Kilicës.

Një nga realizimet më të mira të Vilson Kilicës kohët e fundit është tabloja «U kthefsh me lirinë», e paraqitur në 1978 në ekspozitën e hapur në kryeqytet me rastin e 35-vjetorit të Ushtrisë Populllore. Fshatit myzeqar kalon njësiti partizan. Djem të fshatit hedhin pushkën krahut dhe bashkohen me të. Pas një pushimi të shkurtër njësiti niset rrugëve të luftës. Pranë një pusi nga ata me çikrik, një grua plakë dhe një myzeqar i moshuar përshtendet me njërin nga partizanët e rinj të fshatit të tyre, dhe i urojnë atij: «U kthefsh me lirinë!» Njohja nga afër e mjesdit myzeqar, e njerëzve, e tipave, e lëvizjeve dhe e qëndrimeve, e mënyrës së komunikimit, e mënyrës si e shprehin ata një gjendje të caktuar emocionale, i ka siguruar kësaj tabloje një komunikim të tillë psikologjik, që e dallon nga shumë tablo të pikturës sonë me temën e luftës. Nga pikëpamja e vërtetësisë artistike, e riprodhimit artistik të kohës për të cilën flet, nga pasuria e përbajtjes së saj dhe nga forcë emocionale me të cilën është përjetuar kjo përbajtje, tabloja «U kthefsh me lirinë» e Vilson Kilicës mund të krahasohet vetëm me arritet më të mira të artit tonë të viteve të fundit. Tërë piktura është mbajtur në raportin që krijon ngjyra kafe me zhvillimet e saj ndaj grisë së ngrohtë dhe ndriçimeve të saj. Dhe ky akord koloristik i thjeshtë e shpreh si jo më mirë liriz-

min e episodit dhe frymën luftarake që përshkon tablonë.

Vilson Kilica është në moshën më të përshtatshme për të dhënë veprat e tij më të mira. Kërkesat e reja pér ngritjen e cilësisë që shtron Partia para artistëve, do t'i jasin pa dyshim një hov të ri, të paparë, pikturës sonë. Autorë të tillë si Kilica, Jukniu, Shijaku etj, të dalluar sidomos në fushë të tablosë kompozicionale, do të jasin shembullin e parë për ta nxjerrë këtë gjini të rëndësishme nga njëfarë prapambetje. Arritet më të mira të deritanishme të Kilicës me shokë do të shërbejnë si pararendëse të një dinamizmi të ri, për një frymëmarrje të re. Proceset e reja jetësore dhe aspektet e reja që shpalos zhvillimi ynë revolucionar, kërkojnë një shkallëzim të ri të forcës shprehëse, qëndrim të ri ideoemocional, flakjen e disa skemave të vjetra kompozicionale, nganjëherë të ngathëta dhe shterpa, tej mase të konsumuara, konceptimin e strukturave të reja realiste, që do ta cojnë më përpara traditën tonë të deritanishme si dhe stilin individual të çdo autori.

LIRIZMI QË MERR JETË DHE GJEN FORÇË TË RE NË FORMAT MONUMENTALE

Krijimtaria e Skulptorit të Popullit Mumtaz Dhrami zë fill në prag të viteve 60. Ajo që i dallon përpjekjet e para të skulptorit të ri, janë kërkasa pér kompaktësi të kompozimit, pér formë vëllimore të stilizuar në mënyrë po aq kompakte, pér lëvizje të kufizuara të figurave dhe gjymtyrëve të tyre në kufijtë e këtyre kompozimeve të myllura («Minatorët», 1962-1963, «Shigjetarët», 1959). Por pikërisht në të njëjtën kohë ai realizon dhe një portret të Çerciz Topullit në dru, vepër që shfaqet disi e papritur me temperamentin e vrullshëm piktorik të modelimit, i cili nuk e dëmontr frymën e përgjithshme të ndërtimit.

Më 1967, në aksionin e rinisë pér ndërtimin e hekurudhës Rrogozhinë—Fier ra heroikisht Shkurte Pal Vata. Skulptori e përfjetësoi heroinën e re të malësisë në një bust, që është nga më të mirët e krijimtarisë së tij. Vizioni i saj i hajthëm hedh shtat, si të ishte zambak, nga masa e tokës gjysmëshkëmbore. E re, pak e imët, me freskinë, me gjallërinë dhe shkathësinë e rinisë së saj të përfjetshme. Me dorën e majtë lart ajo ngre kaz-

mën, simbolin e aksioneve, dhe me tjetrën nderon me grusht. Kontrasti që krijojnë krahët përbën edhe efektin kryesor plastik të bustit. Këtë kontrast e shoqërojnë natyrshëm si torsi në kontrapostin e tij të lehtë, ashtu edhe koka me qafën. Tërë figura ruan thjeshtësinë e moshës së saj.

Në këtë periudhë të viteve 60-70 vëmë re të zhvillohen dy prirje deri-diku të ndryshme në skulpturën e Mumtaz Dhramit. Nga njëra anë zhvillimi i mëtejshëm i grupeve dhe figurave skulpturore, ku lëvizja ndërtohet brenda një ekilibri të kontrolluar mirë («Nëna», «Monumentet e varrezave të dëshmorëve në Pezë», «Shkurte Vata» etj.), nga ana tjeter shqetësimi i tij dhe kërkimet këmbëngulëse pér të dhënë simbolikën e ditëve tona me gjuhën e skulpturës realiste bashkëkohore. Ishte e natyrshme që një detyrë e tillë do të dilte para skulpturës sonë si pasojë e motiveve krejtësisht të reja që solli revolucioni, e kërkesave pér shprehi të fuaishme si të realitetit të përditshëm, ashtu edhe të momenteve më të shquara dhe heroike të historisë sonë të re. Flamuri i Partisë, në përfytyrimin e tij, kthehet në një ansambël të vërtetë skulpturor. Përfytyrimi i artistit e kthen atë në një bllok plastik, ku gjenë zhvillim dhe bashkësi jo vetëm kontrastet vëllimore, por edhe dy grupe të mëdha basore-livesh, që ilustrojnë faqe nga historia e lavdishme e Partisë së Punës. Ky pikësynim pér të trupëzuar në forma plastike aspekte të reja, të patrajuara më parë, me një frymë të tillë novatore në skulpturën tonë, ishte një ndihmesë me rrëndësi e skulptorit të ri pér atë etapë.

«Obelisku» në Gjirokastër u ngrit në kujtim të gjithë atyre atdhetarëve që vunë diturinë, shpirtin dhe jetën e tyre në shërbim të gjuhës shqipe, të kulturës shqiptare, të çlirimt dhe përparimit

të Shqipërisë. Autori lë mënjanë format e njo-hura dhe krijon një formë të re, ideja plastike e së cilës niset nga një objekt fare i thjeshtë, nga forma e një mase letre gjysmë të mbështjellë. Ndoshta nuk arrin efektin e dëshiruar nga çdo pikë shikimi, por konceptimi i saj dallohet pa dyshim nga kurajoja krijuese dhe dëshira për invencion.

Fundi i viteve 70 dhe fillimi i viteve 80 përbëjnë periudhën e pjekurisë artistike të Mumtaz Dhramit. Në këta vjet, nga njëra anë mendimi artistik gjen në veprën e skulptorit zhvillim të plotë dhe të gjithanshëm, dhe, nga ana tjetër, kompleksitetit të vizionit i përgjigjet një përpunim më i vëmendshëm i volumeve dhe i sipërfaqes. Shenjë e zhvillimit harmonik të personalitetit janë notat përherë në rritje të lirizmit në veprën e tij. Paralajmërimin e një prirjeje të këtillë e kemi gjetur që në rininë e tij të hershme, në atë spontaneitet të penelatave skulpturore dhe në atë bu-tësi që na bën përshtypje në figurën e një male-soreje të krijuar në atë periudhë. Lirizmi i periudhës së pjekurisë artistike të Mumtaz Dhramit arrin të ushqejë format monumentale të skulpturës së tij me energji të re. Kjo frymë lirike nuk shkon përherë në kundërshtim me frymën dinamike që ai dëshiron t'u japë veprave të tij, ndërsa, nga ana tjetër, vepra, të cilat nuk kanë nevojë përmadheshtinë dhe monumentalitet, komunikojnë me spektatorin me ngrohtësinë dhe thjeshtësinë e tyre.

«Bariu i vogël» është një skulpturë e Dhramit e viti 1982. Ky personazh i preferuar i poetëve, por edhe i piktorëve, është modeluar duke i rënë fyellit, i humbur në njëfarë endërrimi. Në krah ka shokun e tij të pandarë, pushkën, dhe te këmbët dy shqerra përmbi bar. Zhdërvjelltësia dhe

natyrshmëria e ndërtimit të figurës, vazhdimësia plastike që transmetohet gjer te qengjat, dhe mjesdi rrëth tij, përpunimi i butë dhe i ndier i palëve, i qëndismave, i volumeve dhe detajeve ruajnë atë rrjedhmëri melodike, që thuaqse e ndiejmë edhe në ajrin rrëth tij.

«Begati», 1982. Verë e begatë, grurë i rëndë. Korrësja e re dhe e shëndetshme mbështet kra-hun e djathtë llérëpërveshur në duajt e njësipur dhe me të majtën e fuqishme ka marrë foshnjën e saj, të cilit i ka ardhur ora për të pirë. Kraha-roi i saj i plotë dhe buzëqeshja e butë dhe e ndritur plotësojnë këto forma vëllimore të shën-detit, të rinisë dhe të begatisë.

Dy peshq të mëdhenj, që ngrihen vertikalish papritur përmbi ujë dhe një djalë i vogël atje përtet, që hidhet si delfin për të pritur në dockat e tij currilat, që burojnë shatërvan nga gojët e peshqve lozonjarë. Qartësia dhe hareja burojnë nga një motiv kaq i vjetër dhe kaq i ri. Është «Dali me peshk», eksposuar më 1983 në ekspozitën e Tiranës.

Duket sikur në çaste të caktuara, i lodhur nga vepra që kërkojnë tension të lartë dhe përgjegjësi të madhe, të tilla si «Ura e Drashovicës» (1980), «Rugovasi» (1980) etj, dhe sidomos nga skulpturat monumentale të përmasave të mëdha, ku ai është bashkautor me K. Ramën dhe Sh. Hадërin, ndien nevojë për t'u clodhur, mbështetur për një shaka fëmijërore. Por nuk është kështu. Shfaqjet e papritura të lirizmit burojnë vetiu nga natyra e tij e ndjeshme.

Në krijimtarinë e Mumtaz Dhramit janë të shumta motivet epike të thjeshta, të transmetuara me figuracion të thjeshtë tradicional, si dhe subjekte të tjera, më komplekse, të trajtuar me një gjuhë të përshtatshme epike.

«Lart frymën revolucionare» është një vepër gjerësisht e njohur nga publiku ynë jo vetëm nga transmetimet tona televizive, ku ajo është bërë pjesë e emblemës së televizionit shqiptar, por edhe për vlerën emblematike që ka marrë përditët tona. Kjo skulpturë e Mumtaz Dhramit shpreh, me gjestin e thjeshtë e të njohur të ngrijtjes së flamurit në një majë të lartë, idenë e fitores dhe të qëndresës, të frymës së lartë revolucionare. Por gjuha plastike e saj mendoj se nuk është në lartësinë e idesë që mbart. Ndoshita i mungon ajo shkallë finese, që është e domosdoshme përfunduar e një femre dhe që e gjejmë në vepra të tjera të rëndësishme të këtij autori.

«Liri Gero» është një portret heroine dhe skulpturë nga më të arriturat e autorit. Bija e thjeshtë e popullit është dhënë me një thjeshtësi dhe frymëzim që të prekin. Duke u munduar ta ruajë heroinën e veprës së tij nga skemat e njohura dhe nga kallëpet e paramenduara, autori është munduar të zbulojë në tiparet e saj shpirtin heroik dhe ia ka arritur ta zbulojë këtë brenda plastikës së ngrohtë rinore të një vajze të re.

Duke u kthyer përsëri në periudhën e fundit të krijimtarisë së deritanishme të Mumtaz Dhramit, kujtojmë që penelata e dikurshme piktorike e modelimit skulpturor të Mumtaz Dhramit gjen zbatimin e saj më efektiv tanë në një formë tjetër, në një mënyrë tjetër, me një forcë tjetër. Raporte vëllimore origjinale (monumenti i varrezave në Pezë), grupime ekspressive (boceti për Drashovicë), prerje të papritura plastike, që shkaktojnë emocione të fuqishme (lapidari te rruga për Pezë) etj. Kjo frymë dhe energji e bërimeve të tij lirike merr jetë sérishmi dhe gjen forcë të re në format monumentale të kompleksit skulpturor të «Urës së Drashovicës». Dekoracioni i kësaj vepre arrihet

me kundërvënien e fuqishme të së bardhës me të errtën e thellë. Ky kontrast i jep ansamblit frymë rinore, tingëllimin e ditëve tona. Masa plastike madhështore e urës reale dhe kuptimi i faktit historik që përfaqëson, bashkohen dhe zhvillohen në grupin e madh dyfigurësh në qendër dhe në thellësi të saj, si dhe në reliefet anësore. Në organizimin e tërësisë së kësaj vepre kanë punuar tek artisti fantazia e skulptorit, shija dekorative e piktorit dhe kërkkesat e rrepta të grafistit.

Shembulli i monumentit të «Drashovicës» në krijimtarinë e Skulptorit të Popullit Mumtaz Dhrami përbën një tregues të sigurt të pasurimit të mëtejshëm, të atij gërshtetimi të mundësive krijuese të artistit, që i zbulojnë puna e gjatë, pasioni përherë i gjallë dhe fryma novatore e natyrës së tij artistike.

Me një dashuri dhe përqendrim të madh skulptori po merret me-krijimin dhe modelimin e shtatorës së shokut Enver Hoxha për qytetin e Gjirokastrës. Kjo vepër e përmasave të mëdha monumentale do të shënojë, sigurisht, një moment me rëndësi në rrugën e ngritjes së mëtejshme të krijimtarisë së tij, krijimtar nga e cila spektatori, me të drejtë, pret zhvillime të reja.

SHPIRTI KËRKUES I ARTISTIT

Ka artistë që gjithë forcën e talentit të tyre e përqendrojnë në një drejtim të vetëm, të përcak-tuar mirë dhe qartësish të vetëkufizuar. Si këta pasur pérherë, si të vegjël, ashtu dhe të më-ka dhenj. Kur arrijnë të bëhen mjeshta, mbeten përgjithmonë në historinë e artit.

Por ka dhe artistë krejt të tjerë, të cilët ve-prat dhe zhvillimin e tyre artistik e gjejnë pikë-rişt në endjen nga një formë e artit viziv në tjetrën, nga njëra teknikë në tjetrën, nga njëri material në tjetrin. Një artist i tillë është edhe Sali Shijaku, Piktori i Popullit, personalitet i shquar i artit tonë të realizmit socialist.

Veprat e artit janë shprehje e dashurisë në shkallën më të lartë. Cili është objekti i kësaj dashurie të Sali Shjakut? Historia e lavdishme e popullit shqiptar, jeta jonë socialiste, njerëzit tanë.

Heroizmi është tema qendrore e tij, heroizmi që ka qenë i pandarë nga imazhi i shqiptarit ndër-shekuj dhe që Partia e socializmi i dhanë një kup-tim dhe përbajtje të re. Shpirti heroik i sakritificës së lartë përbën edhe arkitekturën e frys-mezuar të veprës së tij. Është një vepër që ekzalton pabar-trimërini, burrërinë, fitoren në betejë të pabara-

bartë për lirinë, atdheun, socializmin. Duke mbetur gjithmonë artist i pikturës së kavaletit, interesat e tij shtrihen përtëj saj, gjer te grafika, piktura monumentale, skulptura dhe qeramika artistike, ku arrin të thotë një fjalë të tijën. Që nga «Heronjtë e Vigut», punë diplome e vitit 1962, e deri sot, ai ka këruar me kujdes dhe këmbëngulje tema që i përshtateshin natyrës së tij, dhe ku përbajtja shfaqej që në fillim me një fytyrë të qartë piktore. Në këtë mënyrë ai është munduar të mos bëjë në pikturë atë që mund të bëhet më mirë në letërsi.

Te Shijaku ka diçka nga përfytyrimi populor, siç është edhe ai vetë me humorin, zgjuarsinë, thjeshtësinë dhe ngrohtësinë e komunikimit, një njeri i dalë nga populli.

I lindur më 1933 në një mjedis shoqëror me tradita atdhetare, ai u rrit në ato vite kur maleve buçiste pushka partizane. U rrit dhe u formua në atmosferën e stuhishme të ndryshimeve e të shndërrimeve të thella revolucionare. Liceu artistik, të cilin e mbaroi më 1952, mësuesit e tij të dashur e të vëmendshëm, Abdurrahim Buza dhe Nexhmedin Zajmi, si dhe shkolla e lartë, i dhanë kulturën dhe shprehëtë profesionale dhe e ndih-muan të njihët vetveten. Është kjo natyrë e tij që fillon të na shfaqet më vonë, kur arrin të gjejë zérin e tij, me prirjen për figuracion të fuqishëm, kundërvënie të imprehta, tone të rrepta. E jashtëzakonshmja, hiperbola, metafora janë pjesë përbërëse të përfytyrimit të tij artistik. Pikërisht këto elementë shprehëse i gjen ai te legjendat dhe tregimet popullore, te përrallat: fantazinë e bujshme, groteskun e shquar, që përputhen aq mirë me ndjeshmërinë e tij. Kështu arriti ai te kreshnikët, që mund të thuhet se jetonin prej kohësh në ndërgjegjen e tij krijuese.

Tanimë është vështirë të dallosh qartë kufirin ndërmjet përfytyrimit të tij vetjak dhe frymës së imagjinatës popullore. Në veprat e tij më të mira, heronjtë e ditëve tona gjejnë të ngjashmit e tyre në legjendat e lashta, ndërsa tiparet e kreashnikëve të lashtësisë piktori arrin t'i zbulojë te një luftëtar i vjetër në malësitë e Mbishkodrës.

Gjerësia e përfytyrimit kërkon gjerësinë dhe forcën e realizimit. Gjërat e tépërt bien, faktet anësore humbin rëndësinë e tyre, lihen mënjanë. Mbahet vetëm ajo që është e domosdoshme, thelbësore. Kompozimi sintetizohet, figurat reduktohen, gjer në një, objekti afrohet, artikulacioni i veprës përforcohet dhe fuqizohet në kulm. Siç e ndërton skulptori statujën e rreptë monolite, ashtu e gdhend Shijaku pikturën e tij.

Epizmi i përfytyrimit kërkon rreptësinë e gjuhës shprehëse. Kështu ai merr dhe e thjeshton në kulm tavacën e tij, mbeten thuajse vetëm e bardha, grija, e zeza, e kuqja, kafeja. Okrat dhe të kaltrat vetëm sa plotësojnë.

Thonë se Saliu punon shpejt. Ai punon shpejt, se mendon gjatë. Dhe pasi e ka shpënë gjer në fund tablonë e tij, s'e ka për gjë ta prishë fare e ta nisë nga e para, kur bindet se nuk ia ka arritur qëllimit. Kërkimi, korrigimi, ripunimi, të gjitha këto janë bërë natyrë e tij e dytë. Për Shijakun, më tepër se pér cilindo tjetër, gjeologjia artistike e «kërkim-zbulimit», e filluar në jetën e gjallë, nuk ndërpritet dhe as frenohet, por vazhdon më tej, me gjithë frymëzimin dhe kompleksitetin e saj, përbëri sipërfaqen e telës, brenda kornizës së veprës së ardhme. Ai zbaton mësimin e Dëlakruasë, se «etydi bëhet nga natyra, ndërsa tabloja nga koka», duke e kuptuar kështu më mirë nga shumë të tjerë rëndësinë që ka interpretimi i së vërtetës jetësore. Për të nxjerrë në dukje ti-

paret individuale të këtij piktori më duket se mund të jap një bisedë që kam zhvilluar me të në studio.

— Cilët kanë qenë mësuesit e tu të parë?

— Në fillim mësoja nga Abdurrahim Buza. Pastaj nga Nexhmedin Zajmi.

— Në ç'masë është i vërtetë ndikimi i Buzës mbi veprën tênde?

— I Buzës? Subjektet e mia përbajnjë ngjarje të tilla, që kërkojnë një vizatim tëpër realist. Dekorativiteti i fortë do më kishte prishur punë.

— Më kujtohet diploma jote. Unë atëherë isha student i vitit të dytë dhe më pati bërë përshtypje. Diplomat e institutit mbroheshin në sallën e madhe të klubit të Lidhjes, pranë Teatrit Popullor. Atëherë tregohej mjaft kujdes dhe mbrojtjet e diplomave qenë festë për artëdashësit e kryeqytetit. Tablotë ndriçoheshin me projektorë, diskutimet ishin të gjalla. Është pér të ardhur keq që heqim dorë nga traditat e mira dhe e kemi zhveshur këtë ditë të shënuar në jetën e artistit të ri nga çdo popullaritet, nga shkëlqimi i festës, që shkon kaq mirë me moskën e rinisë. Tani mbrojtja e diplomave është katandisur në një procedurë të thjeshtë dhe të mërzitshme provimi para komisionit. Nejse. Më kujtohet që tabloja që mbroje ti, «Heronjtë e Vigut», më pati bërë përshtypje pér freskinë dhe romantizmin e saj. Kur e kam parë më vonë, më është dukur më e zbehtë dhe jo kaq e pastër, por në atë kohë pata përshtypjen se autorit të saj i pëlgente shumë piktura e Dëlakruasë. Besoj se grunti nuk ka qenë përgatitur mirë dhe ngjyra e ka humbur shkëlqimin e saj.

— Dëlakruai më ka pëlgyer. Por tani më duket më interesant Françisko Goja.

— Cilat janë temat kryesore që të kanë interesar më tepër?

— Më ka tërhequr përherë heroikja, sakrifica për atdheun, vetësakrifiki. Ndërsa tanë ndiej dëshirën të trajtoj ca tema të qeta.

— Dhe subjektet?

— Subjekte ka shumë, por vlen ai që vjen në kokën e piktorit në mënyrë të figurshme.

— Herë pas here të kam dëgjuar të flasësh me admirim për pikurat e fëmijëve.

— Pikturat dhe vizatimet e fëmijëve janë ilaci i përshtatshëm për t'u pastruar nga shprehitë-rutinë, nga parapëlqimet e ngurtësuara. Fëmijët janë krejt të pastër nga paragjykimet, të cilat e kanë burimin te shkollat e pikturev.

— I jep shumë rëndësi modelit?

— Për mua është krejt e mundur që nga fotografia të bësh pikture dhe nga natyra fotografi. Varet nga shkalla e aftësisë.

— Ndoshta është pikërisht fotografia burimi i frymëzimit për një kompozim tëndin në dëborë?

— Për «Zjarret partizane» e ke fjalën? E vërtetë. Më pati pëlqyer mjart një fotografi e shokut Enver. Aty Komandantin e pashë duke ngrohur duart në një ziarr të vockël, që nxirrte shumë tym. Ishte prekëse...

— U jep ndonjë rëndësi vërejtjeve të të tjerëve?

— Varet nga vërejtja. Kisha në dorë «Vojo Kushin». Marangoz Faja e pa dhe tha: «E di çë, o Salë, sikur të qe ca më i hallakatun!» Atëherë iu luta Fajës, që kishte trup shumë të mirë, të zhvishej dhe të më pozonte. E vizatova me kë-mishë të nxjerrë, dhe doli fare ndryshe...

— I kërkon shumë tipat, zgjedh shumë?

— Nganjëherë gjen tipa të mrekullueshëm, por kjo qëllon fort rrallë. Bëra një udhëtim në

Mbishkodër. Rrugën e bëra në këmbë. Dhe gjeta modelin dhe vetë idenë për «Kreshnikun». Ishte një malësor i thjeshtë, i moshuar, Marash Pepa. Ia kishin plagosur një këmbë, që mjejet u detyruan t'ia prisnin. Qe plagosur në luftë me malazezët. Një vajzë e vogël kishte ardhur te kulla e tij dhe e kishte thirrur për të ndihmuar prindërit e saj. Marashi i shkoi pas, luftoi dhe u plagos. E piktuvara, m'u duk një kreshnik i gjallë.

— Në disa raste, mbi veprën tënde ndihet ndikimi i artit folklorik. Ornamentika folklorike të ka shërbyer?

— Ornamentika më pëlqen, por më interesojnë më tepër kontrastet, raportet e guximshme. Pa këto, ornamentika do të binte ndesh me frymën heroike të tablove të mia.

— Kam përshtypjen se në disa raste vizioni yt është disi pllakatik...

— Ndoshta është komunikimi i shpejtë i vepres me spektatorin, karakteristikë për pllakatin, komunikim që e kanë disa nga punët e mia, por në një mënyrë tjetër. Plakatizmi nuk më ka shqetësuar kurre.

— Ndoshta, në raste të vecanta, vizatimi yt mbart një prirje drejt karikaturës?

— Jo, deri te karikatura jo! Pak me humor mund të jetë, kur e do puna. Ja p.sh., këto qeramika, këtu...

— Cili është qëllimi i këtyre qeramikave?

— Kur e bëj një gjë, nuk e bëj se është e porositur. Këtë qeramikë do ta bëj, do ta bëj se dua të çlrohem prej saj. Ti pastaj thyeje po deshe.

— Kohët e fundit në paletën tënde është vënë re një ndryshim me rëndësi drejt ngjyrave të pastra. Është për të ardhur keq që ky ndryshim me rëndësi shumë të madhe nuk ka gjetur mirë-

kuptim dhe vlerësimin e duhur. Po për mua është krejt e qartë pse nuk e ka gjetur.

— Po. Piktura ime ka qenë përbërë nga okrat, kafetë, të kuqet angleze, gritë. Tani përpiqem të përdor ngjyra më spektrale. Pastaj qeramika më ndihmon që të dal edhe më mirë te ngjyrat spektrale.

— A të kujtohet ndonjëherë fëmijëria në Tiranën e vjetër?

— Gjer në hollësi... Shtëpia jonë përdhese... Nëna shtronte postiqe dhe, që të mos hynte era, e zinte derën me to...

* * *

Për të nxjerrë disa tipare të piktorit, po ndihim një vështrim në disa préj punëve më të spikatura.

«Agimi i nëntorit 1941». Pikturë e vitit 1971. Një nga veprat më interesante të Sali Shijakut. E intonuar në vandajk, me rrugët e bardha që duken vjollcë, ajo të jep përshtypjen e një agimi të pazakontë. Dy dritaret e katit të parë vezullojnë nga e verdha napolitane. Zhvillimet jashtëzakonisht të matura drejt së gjelbrës, drejt vjollcës së shuar në gri, drejt të zezës.

«Peizazh», 1974. Prirja e tij për trajtimin e gjerë të sipërfaqes. Dëshira për të mos mbetur në vartësi të pamjes së jashtme të objektit.

«Fshati kufitar», 1976. Ngastra të gjelbra, të gjelbra në kafe, shkëmb i bardhë, qell i qartë. Shpërndarje zonale e ngjyrës, brenda një harmonie të freskët të dalë nga ngjyra kafe.

«Stregat e kooperativës», 1975. Trajtimi dekorativ, me ngjyra të rrafshëta të ndara në zona, por të gjetura me finesë. E verdhë e artë, e ver-

dhë e zbehtë, me qiellin që zë një vend të dukshëm në vjollcë të zbehtë dhe një brez i hollë i një të kaltre të brishtë, që mbulon portokallinë e zjarrtë. Kompozimi po aq mjeshtëror sa edhe trajtimi. Theksi është në të verdhën indiane, që gjen jehonë te një rrip i ngushtë i portokallisë së thellë në largësi.

«Kuajt e kooperativës», 1976. Me ngjyra të shuara, kafe, që gjallërohen nga një gardh fusharak vjollcë. Muzg, nëpër shtëpitë e fshatit janë ndezur dritat. Mullarët në kafe. Ajo që të bën përshtypje më tepër është shkalla e vërtetësisë me të cilën është dhënë atmosfera e fshatit myzeqar.

«Mic Sokoli». Me një gjest të furishëm heroik kosovar hidhet përmbi grykën e topit armik. Figura është e hiperbolizuar si dhe raporti ndërmjet figurës dhe objektit, por të gjitha janë të përligjura më frymëzim. Kundërvënia e njeriut, ndaj armës së tmerrshme është tronditëse. Qielli i copëtuar dhe i përvajshëm, i gjelbër në të verdhë. Gjithçka është sjellë në një drejtpeshim madhështor. E vërteta kalon lehtësisht në legjendë dhe heroizmi legjendar modelohet gjer në hollësi në forma konkrete. Një nga veprat më të fuqishme dhe më të realizuara të Sali Shijakut.

«Vojo Kushi». Piktori arriti të gjjejë një zgjdhje që ishte më e mira nga të gjitha përpjekjet e mëparshme të disa piktorëve. Aktin heroik të komandantit të pavdekshëm të gueriljeve të Tiranës Shijaku e ka dhënë në përmasa monumentale, në një gamë të rreptë gri në të errët, me flakërimat e së kuqes së zjarrtë, që reflektohet thuajse në tërë figurën e Vojos. Raporti i figurës në sipërfaqen e tablosë është në kufijtë e tepërimit, përmasat dhe gjestet gjithashu. Mirëpo përqendrimi i papritur i ndriçimit të zjarrtë fla-

kërues në torsin e heroit, vizioni i tij rinor i përgjakur në mes të asaj mase armiqësore të hapësirës gri, përligj gjithçka.

«Portret vajze», 1980. Një nga punët më të bukura. Një vajzë e thjeshtë, brune, me një hundë të hollë e sy të zez, me veshje kombëtare. Vështrimi jashtëzakonisht i gjallë i syve të zhytur në gjysmëhije. Gjithçka e plotë, opake dhe në të njëjtën kohë e gjallë, e lehtë, e gjëzuar. Me gjallëri të papritur e godasin të gjelbrën e thellë e kuqja e butë, e bardha e shkëlqyer, vjollca e papritur e luleshpatëzës. Penelata mbetet e fuqishme me shpengimin që shpreh forcë dhe saktësi. Figura e hajthme e vajzës është plot gjallëri.

«Peizazh», 1982. Një pikturë me përmasa fare të vogla, por që është vështirë ta harrosh, kaq e papritur është. Freskia që buron nga sipërfaqja e sai të ndjell kujtimin e një lugine të blertë, gjymë të vërtetë dhe gjysmëpërrallore, që ke takuar në fëmijëri, të një burimi të kthjellët që ke zbuluar papritur në mes të gjelberimit, rrugës së gjatë e të mundimshme në pisk të vapës.

* * *

Ndjenja e fuqishme e kërkimit, që jeton e gjallë në gjithë rrjedhën e gjerë të krijimtarisë së tij, është dhe burimi i asaj këmbënguljeje dhe energjiie me të cilën Shijaku ka këruar hap pas hapi, herë me sukses e herë jo, tema nga më të papriturat, zhvillime nga më të ndryshmet, alternativa të befasishme teknike dhe artistike, shtigje të reja për imagjinatën e tij.

Ajo që e ka tërhequr interesimin e Shijakut te skulptura, është gjuha e zhvillimeve të rrëmbyera plastike, e të papriturave vëllimore impresionuese, e dritë-hijkeve të intensifikuara.

Të qenit tip sportiv e ka shpënë Shijakun gjer në një skaj kaq të largët siç është qeramika artistike.

Dëshira për të thënë sa më tepër me elemente sa më të pakta e bën të domosdoshme praninë e imagjinatë në çdo vepër arti. Me këtë nënkuptohet që natyra e fantazisë së zbatuar në një peizazh realist ndryshon nga ajo që përdoret në ilustrimin e një legjende a të një përralle. Përqindja e fantazisë që ka përdorur Shijaku në portretin e shokut Enver Hoxha, nuk është sigurisht e tillë si ajo që është përdorur te Vojo Kushi.

Kur ndërtojmë skenën fantastike të një përralle a të një legjende, është e kuptueshme se nuk mjaftojnë kriteret e ndërtimit të një tabloje ku kooperativistët, p.sh., shkulini paxhar. Nuk mund ta paraqesim, p.sh., fluturimin e Doruntinës si një fluturim të rëndomtë, përmbi një kështjellë të rëndomtë dhe në kushte atmosferike të rëndomta. Këtë nuk mund ta bëjmë në qoftë se dëshirojmë që fluturimi i saj të besohet si një e vërtetë artistike e padiskuteshme. Fluturimi i saj në poemë është fantastik dhe mbetet i besueshëm vetëm me kusht që të kryhet në rrethana të një bote tërësisht fantastike, ku mund të ndodhë çdo gjë. Jashtë këtij kushtëzimi, fluturimi i Doruntinës kthehet në lodër fëmijësh, që nuk e beson asnjë spektator serioz, në një akt që s'ka asgjë të përbashkët me frymën e eposit.

Një kukull fëmijësh mbetet e tillë jo sepse nuk është një krijim fantastik. Ajo është sigurisht një ndërtim fantastik, po kthehet papritur në lodër fëmijësh, ngaqë ka fatin e lig të kundrohet në kushte reale, midis nesh, në mjedisin real familjar. Kjo është arsyaja që, kur kjo kukull ndodhet mes nesh, p.sh. përtetë xhamit të një bufeje, nuk bën përshtypje, ndërsa kur e shohim të hyjë në një

film multiplikativ, bëhet e çuditshme, e bukur, shprehëse, e gjallë. Ndodh kjo ngaqë kukulla bëhet pjesëtare e një bote të re, kukullore, artistike, ku hyjnë në veprim ligjet e qenësisë kukullore.

Nuk mund të ketë sukses, p.sh., te Sali Shijaku paraqitja e Rozafës dhe e heroizmit të saj, në qoftë se në mes të Rozafës dhe të një gruaje të zakonshme, që i shpie drekën bashkëshortit të saj që hap ugar diku larg shtëpisë; nuk gjejmë ndonjë ndryshim thelbësor. Ndërsa gjetjet kompozicionale, zgjedhja e ngjyrave ose e elementeve të tjera shprehëse nuk janë në gjendje të plotësojnë atë që mungon.

Letërsia dhe muzika zotërojnë mundësi të pakufishme për fantazinë shprehëse. Fluturime nga më të çuditshmet u lejohet të bëjnë shkrimitarëve të zotë dhe kompozitorëve, mjaftron që këto fluturime t'i shërbejnë plotësisht idesë së veprës. Me këtë nuk duam të themi se një shkrimitarështë i lirë ta dhunojë të vërtetën jetësore pa u ndëshkuar, por që e vërteta jetësore qëndron në radhë të parë në idetë që transmeton vepra te lexuesi. Është fakt që si letërsia e ca më tepër muzika zotërojnë mundësi të pakufishme për stilizim, për ta intensifikuar në mënyrë jashtëzakonisht shprehëse imazhin letrar a muzikor. Ato kanë mundësi të krijojnë metafora me elemente përrallore, për të shprehur më këto metafora të vërtetën qind për qind tokësore. Këtë mund ta bëjnë jo vetëm se «i kanë duart të lira» nga modeli, nga dëshmia e tij e pamëshirshme, por edhe sepse si letërsia, ashtu edhe muzika janë një shprehje «eterike», jo e dukshme dhe as e prekshme, shprehje artistike jomateriale e ideve tona njerëzore mbi realitetin material.

Realiteti material, duam apo nuk duam ne, është realitet i përmasave, si dhe i parametrave

të tjerë që karakterizojnë materien. Përpjekjet e kësaj ose e asaj forme të krijimtarisë artistike, letrare, muzikore, për t'i shprehur përfytyrimet mbi realitetin objektiv nëpërmjet më tepër a më pak parametrave à përmasave çojnë në forcimin ose dobësimin e përfytyrimit material, lëndor të realitetit të paraqitur. Skulptura është ajo formë e paraqitjes vizive, që i bindet më tepër nga çdo art tjetër ligjt të imitimt, meqenëse pikërisht ajo është paraqitja disi më e plotë e objektit. Paraqitja në tri përmasa, qenësia e forcës së rëndësës, natyra lëndore e të folurit të saj e bëjnë skulpturën artin më të papërshtatshém, më të ngathët për të ndjekur fluturimet e imaginatës letrare. Për hir të krahasimit mund të shtojmë këtu se, ndër mënyrat lëndore të shprehjes artistike, do të ishte arkitektura ajo që do t'i lejonte ndjenjës së pastër plastike një hapësirë disi më të gjerë. Këtë mundësi arkitektura e ka, sepse pikërisht ajo ka shpëtuar prej modelit, duke u bërë shprehje jofigurative, abstrakte, ndonëse po aq lëndore.

Sipas këtij arsyetimi mund të arrijmë në përfundimin se Sali Shijaku, duke zgjedhur qeramikën si formë plastike dhe si teknikë për të ilustruar ciklin e kreshnikëve, ka zgjedhur për fat të keq formën më të papërshtatshme. Qeramika, kjo skulpturë e vogël e ngjyruar, nuk ka as mundësinë që të imponohet të paktën fizikisht, gjë që e ka, p.sh., skulptura monumentale. Skulptura qeramikë mbetet e dënuar në rolin e thjeshtë të objektit të zbukurimit, me një prirje të natyrshme e të vëtvetishme nga buzëqeshja, humor. E, sa për humorin, siç dihet, është skaji tjetër i madhështisë. Kështu, lexuesi i dhënë pas mrekullive të

eposit i sheh me keqardhje të thellë heronjtë e tij të preferuar tek zbulohen papritur në një dritë disi qesharake, si lodra fëmijësh. Kjo rrjedhojë e padëshiruar mendojmë se është edhe shkaku që intuita i dha autorit një këshillë të urtë: t'i paraqesë qeramikat e tij në ekspozitë jo drejt-përdrejt, por nëpërmjet artit të fotografisë, e cila, nga ana e saj, zotëron mjete të fuqishme, si ndriçimin e kushtëzuar, ngjyrimin e tërë sipërfaqes dhe teknikën fotografike. Dhe për këtë shërbim asaj i paguhet një qira që nuk është e paktë.

Po pse e ka zgjedhur piktori qeramikën si formë shprehjeje? Sepse qeramika i ka bërë përshtypje me mundësitë e saj të veçanta, me të papriturat e formës e të ngjyrës. A qëndrojnë qeramikat e tij? Sigurisht, ato janë të mira në vettete, madje disa nga ato edhe mjaft interesante e térheqëse dhe qëndrojnë fare mirë me kusht që t'u hiqen emrat e heronjve të eposit të kreshnikëve. C'nevojë e ka shtyrë autorin t'i drejtohet eposit popullor për qeramikat e tij? Asnjë! Ato qëndrojnë në vettete dhe nuk kanë nevojë për përligjje, ashtu siç qëndrojnë në vettete kontrastet e veçanta të një gravure në linoleum pa qenë nevoja të përligjen. Prandaj të zgjedhësh qeramikën si gjuhë shprehjeje është po aq e drejtë sa dhe çdo teknikë tjetër, me kusht që të zbatohet për tema që ka mundësi t'i përballojë qeramika me mundësitë e saj térheqëse, por tepër të kufizuara.

Kjo ndjenjë e fuqishme plastike e temperamentit të tij nuk e pengon aspak të hidhet sot drejt territoreve të reja, ku është ngjyra ajo që bën ligjin, ku nisin të gjallërojnë si në një kopsht të lulëzuar portokallitë, të verdhat, të kaltrat, të blertat, të kuqet e zjarrta, të cilat, natyrisht,

nuk kanë asgjë të përbashkët me dietën që kërkon gjuha plastike, por që janë dëshmitare të një shpirti të gjërë.

Eshtë pikërisht ky shpirt sportiv, shpirti i garës me vetveten, që e ka pasuruar në mënyrë të dukshme dhe e ka nxjerrë në pah në mënyrë të veçantë krijimtarinë e piktorit dhe që do ta nxjerrë atë, padyshim, në shtigje të reja.

EKSPOZITA E SKËNDER KAMBERIT

Ekspozita e parë vetjake e piktorit të merituar Skënder Kamberi në kryeqytet na e zbulon autorin edhe si peizazhist.

Afirmimi i Skënder Kamberit është bërë në përmjet kompozimeve të tij të mirënjojura, si «Ndiham shokut», «Kruja e rrethuar», «Buka e duarve tonë» etj. Tabloja «Buka e duarve tonë» shquhet sidomos për freskinë e motivit, që ai e ka zbuluar me mprehtësi. Është një nga shembujt se si mund të zbulohen motive të bukura piktorike në atë realitet të përditshëm të zhvillimit socialist që kryhet para syve tanë në fshat dhe në qytet. Po për kompozimet e tij është folur nga kritika jo pak. Në këtë shkrim dëshirojmë të merremi me tipare të tjera të pikturës së tij, të cilat dalin në pah për herë të parë në mënyrë kaq të plotë në këtë ekpozitë vetjake.

Ngjyra në pikturën e Skënder Kamberit

Në fillim të rrugës së tij krijuese ngjyrat e Skënder Kamberit kanë qenë të rënda, tej mase të ngopura, të velura. Ajo që e vel ngjyrën më tepër

nga çdo gjë është e verdha. Te teprimi me të verdhën dhe me përfitimet që siguron «miqësia» e tepruar me familjen e saj, e ka burimin edhe dobësia e përgjithshme që kanë shumë piktorë për pamjet vjeshtore, dhe mund të ndodhë që një piktor, kur pikturnon pranverën, t'i dalë vjeshtë dhe kur pikturnon mëngjesin, t'i dalë mbrëmje.

Te Skënder Kamberi teprimi me të verdhën dhe pasojat e tij i shohim në kompozimin «Kavalona», 1966. Një tufë grash dhe vajzash, që kanë vajtur të mbushin ujë diku ndanë një pylli, në një lëndinë të gjelbëruar, ku ndodhet një pus. Në mes të një gjelbërimi, që nuk është i gjelbër, por vjeshtak, gratë të veshura dhe të piktuvara me të verdhë dhe me të kuqerremtë, rrethuar nga plepa jeshilë të ngrohtë dhe të thyer, në një horizont të ngrohtë dhe të rëndë, të verdhë, nën një qiell po aq të rënduar nga e ngrohta.

Kjo dashuri e tepruar për të verdhën vazhdon pak vjet dhe rikthehet tek ai herë pas here edhe më vonë, por në një formë më të pranueshme. «Vermosh», 1983. E gielbra e këndshme bashkohet me të verdhën. Për të fituar frymëmarrje, ndërhyjnë dy ngastra të grisë, e cila del nga përzierja e kësaj të gielbre me të kaltër a smerald, dhe shoqërohet nga shtëpia mes pyllit, ndërtuar me kafe.

Më kohë, te piktura e Skënder Kamberit e verdha lëshon terren dhe rivendoset një ekuilibër ndërmjet ngjyrave. Ai arrin më në fund tek ajo arkitekturë e ngjyrës, që është tipike për të.

Skënder Kamberi e nderton ngjyrën e pikturës së tij në një regjistër mjafth të kufizuar. Në këtë mënyrë ai ndodhet shumë më tepër në shtratin e pikturës sonë në përgjithësi, nga sa është bërë zakon të thuhet për të. Le të ndjekim ndërtimin e ngjyrave nëpër tablotë e tij.

Ngjyrat e pikturës së Skënder Kamberit janë

të natyrës tokësore, ose, siç quhen në zhargonin e piktorëve, «terra». Të marrim pikturen «Pranverë», që është një peizazh. Në qendër janë 3-4 drurë frutorë mbushur me lule. Toka ngjyrë toke, gjethet ngjyrë toke (jeshile terra), mali ngjyrë toke (kafë në vjollcë terra), qielli ngjyrë toke (e bardhë terra), lule ngjyrë toke (rozë toke e zbardhur mjaft). E tërë harmonia-ngjyrë toke, e cila anon herë për nga e gjelbra, herë për nga kafeja, herë për nga roza dhe herë drejt së bardhës.

«Rrugë në diell». Një grua e re punëtore shtyn një karrocë fëmijësh në një rrugicë të parkut të qytetit. Hija ngjyrë toke, që të kujton blunë, është në të vërtetë gri dhe kafë, sikurse dielli ngjyrë toke të kujton rozën fare pak. Në qoftë se e pranojmë këtë pamje si pamje të një dite me diell, duhet të pranojmë se ka qenë një diell jastëzakonisht i zbehtë. Në të vërtetë, ndërtimin koloristik në peizazhin «Rrugë në diell» nuk e përcakton drita e vërtetë diellore, por ngjyrat e tokës, që pushtojnë si hijen dhe dritën, ashtu siç arrijnë të pushtojnë shumicën dérrmuese të piktureve të Skënder Kamberit.

Me fjalë të tjera, mund të thuhet se Skënder Kamberi, në rrugën e gjatë për të kërkuar ngjyrën e tij individuale, ndoci një sens të kundërt me atë që ndiqte, p.sh., Zef Kolombi, dhe me atë që arriti është rininë e tij Abdurrahim Buza. Janë mënyra kreit të ndryshme të ndërtimit të ngjyrës në pikturen realiste. Bukuria e njërsës mënyrë qëndron në clirim e plotë të ngjyrës nga guaska natyrore, cliri i plotë dhe përfundimtar i energjisë së saj potenciale në dobi të shprehjes ideore. Bukuria e mënyrës tjetër qëndron në shkallëzimin e hollë të melodisë kromatike, por, më tepër se kjo, në pjesëmarrjen e rëndësishme të ngjyrës përkrah mosdelimit tonal. Kështu, në këtë rast bëhet fjalë jo

kaq për plasticitetin e ngjyrës, sesa për plasticitetin e formës nëpërmjet ngjyrës. Në rastin e piktures së Skënder Kamberit, ngjyra është vënë në shërbim të formës, duke e humbur pavarësinë e saj, për këtë nuk ka dyshim, por kjo ngjyrë, që i nënshtron tonit, është e një ndjeshmërie jo të zakonshme.

Finesa e ngjyrave të Skënder Kamberit shfaqet në shkallëzimin e hollë të ngjyrave të tokës, të cilat në këtë ose atë rast i afrohen blusë, rozës, vjollcës, i afrohen së blertës smerald, por nuk bëhen thuajse kurrë blu, nuk bëhen kurrë rozë, si nuk bëhen kurrë vjollcë, të kuqe, smeralde, madje as në ato raste kur shoku (sock) i vërtetë i frymëzimit të tij kanë qenë roza, vjollca ose e kaltra e modelit real. Nuk ka rast më të mirë që të arrish pa frikë gjer tek e kuqja e pastër, te portokalli e pastër dhe te vjollca e pastër sesa kur pikturen një tufë me lule të kuqe dhe rozë ose portokalli. Madje mund të thuash se në këtë rast arkitektura kromatike e tablosë duhet të niset pikërisht nga ngjyra e petaleve, sepse ato janë dhe subjekti i natyrëmortit. Mirëpo a ndodh kështu te natyrëmorti «Vazo me lule» e Skënder Kamberit, e piktuuar më 1980? Jo. Në morinë e ngjyrave dhe të nuancave që mbushin hapësirën dhe sipërfaqen e pëlhurës dhe që janë të gjitha të thyera dhe të gjitha të shuara, d.m.th. të përziera me një të trete, një rozë në portokalli mezi arrin gjer te petalet. Po si arrin? Me vështirësi të mëdha, duke vendosur bojë përbimi bojë, me një penel që duket qartë se nuk ka qenë fort i pastër dhe nga një tavaloçë që duket qartë se nuk ka qenë fort e pastër.

Kështu, regjistri i spektrit të piktures së Skënder Kamberit ka një shtrirje mjaft të kufizuar. Është një spektër tokësor, jo në kuptimin figurativ të fjalës, por në kuptimin e drejtpërdrejtës.

të. Pikërisht në këtë shtrirje të ngushtë, fort të ngushtë të kolorizmit të tij ai arrin me shumë talent, zotësi dhe temperament të realizojë pamjet e shumta dhe të larmishme të vizionit të tij për botën dhe realitetin.

«Mështeknat», 1982. Në një mjedis të ngrohtë, brenda së cilës gria gjershetohet çuditërisht me të gjelbrën e butë, ato dalin të papritura, të gjalla, të afërta.

«Oborri i vegjëlisë», 1985. Në tërësinë e muzgut të ngrohtë e të shuar, balli i shtëpisë, ku Komandanti kaloi fëmijërinë e tij, shkëlqen papritur nga oranzha që vezullon si ar. Qielli vjollcë. I téré kuadri shquhet nga butësia ëndërruese.

«Gryka e lumi», Vlorë, 1980. Peizazh mjaft i bukur, i nisur nga kafeja e gjelbër, që zhvillohet te bluja e thyer, te gria dhe deri tek oranzha.

«Dimër në Llogora». Dëborë. Penelatat e bardha dhe pastoze vezullojnë si xixëllonja të bardha në hapësirën e mjegullt dhe të ngrohtë.

«Fshati Kolonjës-Rushan», 1985. Vezullimi i preferuar, i kuqërrëmtë, ndriçon në mes të sfondit të tij të preferuar të së ftohtës shumë të thyer.

«Dimër në plazh». Mjaft piktorë që piktuojnë detin, i huton zakonisht pasuria e kalimeve të ngjyrës blu të detit nga njëri skaj në tjetrit. Por Skënder Kamberi e ka detin në shtëpi dhe ka ditur ta vërejë gjatë. Ai nuk hutohet aspak, por ia nënshtron kapriçot e kaltërsisë disiplinës së fortë të tavaloçës së tij të sprovuar. Ndaj vetëm kontrasti i së bardhës së valëve të shkumëzuara, i së bardhës që ngrohet nga rëra e artë, që e kthen në rozë të butë, që ftohet nga deti i thellë dhe e kthen në të blertë smerald, i mjafton. Në ekspositën vetjake të Skënder Kamberit është eksposuar dhe një autoportret i piktorit. Në të vërtetë nuk ngjan. Është më tepër një përfytyrim i lirë. Por le të shohim ngjyrat. Sigurisht që i ka zgjedhur

dhur me kujdes të veçantë, duke u shkëputur krejtësisht nga imitim i modelit dhe duke i lënë dorë të lirë fantazisë: gria që shndërrohet në kafe, gria që shndërrohet në të errët, gria që shndërrohet në të kuqe të thyer, në argjend, në okër. Mund të kthehet ndryshe dhe është e njëjtë gjë: ngjyrë argjend, okër, rozë në oranzhë dhe pak, fare pak të verdhë brenda masës gri.

«Myzeqeja», e zhytur butësisht në një muzg kafe të mjegulluar, të ngrohtë.

Natyrisht, nuk ndodh përherë kështu. Qëllon që frymëzimi zbehet, tregimi i tij bëhet prozaik, kthehet në manierë të thjeshtë. Elementet zbatohen mekanikisht, dora humbet saktësinë, ekuilibri kromatik prishet. «Pylli», 1983. Këtu as shija e mirë nuk i bën dobi. E zeza futet rëndë aty ku s'i takon, dhe prish gjithçka. Janë gjëra që ndodhin.

Kjo ekspositë të bind se për Skënder Kamberin bukuria e ngjyrës është bukuria e nuancës. Po që se takon në natyrë një akord të bukur, interesant, për piktorin tabloja është e zgjidhur nga pikëpamja e ngjyrës.

«Peizazh deti». Bukuria e raportit të blusë kobalt me rozën e ngrohtë, që të kujton si oranzhën, ashtu dhe kafenë.

«Fëmija Nefertita». Bluja mjaft e thyer, që kundërshton të bardhën e ngrohtë në okër.

«Studentja». Rozë e shuar, që del nga tërësia e kaltër e thyer.

Nganjëherë ndërtimi koloristik i kuadrit të tij nuk përbën kurrfarë akordi, por vetëm një kontrast të papritur tonal. «Netë me hënë». Kallarat. E gjithë ngjyra është tepër e papastër, e përzier, e rëndë, por e vendosur mbi reliefin, format, objektet, planin e parë dhe thellësinë me kaq ndjenjë, saqë piktura e vogël kthehet në një kuadër sugjektiv, ëndërrues, një natë me hënë, për mbi këtë siluetë fshati që duket si përrallë.

Dhe ja, arrijmë te peizazhi i tij «Dimër në Tiranë». Është një peizazh në një format jo të vogël. Artisti e ka parë qytetin ashtu siç mund të jetë në një mëngjes me dëborë. Në një tërësi ngjyre të ngrohtë, të papercaktuar, që është po aq afër së bardhës së ngrohtë, sa edhe grisë së qartë dhe okrës së lehtë, planet dhe objektet zhvillohen lirisht, thuaçse vjetveti që nga vjollca, te diçka që të kujton të verdhën, nga e kaltra fare e lehtë e deri te diçka që të kujton rozën. E parë nga terraca e katit të dytë të hotelit «Arberia», brenda grisë së ngrohtë, shëtitorja «Dëshmorët e kombit» zhytet butësisht dhe në mënyrë thuaçse fantastike drejt qendrës së kryeqytetit, që është shndërruar në mënyrë jo të zakonshme. Bora e bardhë mbi terracë, tymi vjollcë që del nga oxhaku i pallatit përballë, ndërtesa elegante e redaksisë së «Bashkimit», më tej hotel «Peza», hotel «Tirana», grupi arkitekturor i xhamisë dhe i ministrive. Me mprehtësinë intuitive, karakteristike për punët më të mira të Skënder Kamberit, janë gjetur në mënyrë optimale e përgjithshmja tonale dhe kromatike jashtëzakonisht e përbajtur, raporti sipërfaqësor ndërmjet qellit dhe qytetit, si dhe tërësia përpjesëtimore e gjithë gjymtyrëve. Me një ekuilibër të këndshëm emocional, peizazhi «Dimër në Tiranë» i Skënder Kamberit radhitet në arritjet më të mira të peizazhit tonë të ri.

Një vërejtje për portretet

Skënder Kamberi na paraqet në ekspozitën e tij edhe një numër portretesh. Cdo piktor mund të bëjë portrete pa qenë portretist, për këtë kemi pasur rast të bindemi jo një herë. Por tjetër është të bësh portrete dhe tjetër të jesh portretist. Jo

përherë portretet që dalin nga dora e Skënder Kamberit janë të realizuara deri në fund. Nganjëherë piktori mbetet në karakteristikat e jashtme të modelit. Besimi i tepruar te një këndvështrim optik i papritur, ose te një kthesë e pazakontë, te një prerje kompozicionale disi e veçantë nuk shoqërohet përherë nga një qëndrim serioz ndaj elementeve të tjera, edhe më të rëndësishme të një portreti, si thellimi në karakterin e modelit, në formacionin e tij shpirtëror, në vizatimin e saktë, që respekton jo vetëm ngashmérinë e fytyrës, por të gjithë figurës së tij, në plasticitetin individual të modelit, në ekuilibrin e domosdoshëm të të gjitha elementeve. Fytyrat e modeleve të piktorit mbeten nganjëherë indiferente, ose mbeten në poza të thjshta, nganjëherë të fryra.

Tipare individuale të veprës

Piktura e Skënder Kamberit gëzon me të drejtë ponullaritet të vecantë në svtë e amatorëve të shumtë të artit të pikturës te ne. Celia e ekspozitës vetiakë me vepra të tii të reia dhe retrospektive në krvedvitet u brit me interes.

Piktori i merituar Skënder Kamberi e ka nisur rrugën e krijuimtarisë së fii në mesin e viteve trishtëdhjetë. Tematika e vepraleve të tii përfshin një samë të gjerë dhe është vështirë të thuash se c'ësini e pikturës i pëloën më teoër. Ai nuk i zgiedh shumë modelet. Nuk ka rëndësi në është një veteran i luftës, një hero i punës socialiste, një mësues fshati, një nënë dëshmor, një studente, një shkrimtar shumë i njohur, ose një kooperativist krejt i panjohur. Nuk ka rëndësi në është një pamje e shëtitores «Dëshmorët e kombit», ose

një kënd i thjeshtë i një lëndine, ku vjeshta ka përpunuar ngjyrat e saj; çdo gjë që mund të piktuohet (dhe mund të piktuohet çdo gjë, natyrisht). Ndonëse është nga Vlora, kavaletin e tij mund ta gjesht të vendosur në shumë krahina të atdheut. Përmbytja e veprave të tij buron nga dashuria për realitetin tonë socialist, të piktuuar në çdo cast të mundshëm, në çdo rrethanë. Është në gjendje të ulet në mes të rrugës, në qoftë se ajo pamje e prek, dhe të piktuojë pa u druajtur aspak. Por është i gatshëm gjithashtu të kthejë vërojigje dhe të shkëmbejë dhe një cigare me kalimtarin kureshtar, qoftë ky një plak, një punëtor, një intelektual. Është i gatshëm t'u shpjegojë se çfarë po bën në atë peizazhi dhe pse po e bën, sikurse t'u mbajë, po të jetë e nevojshme, një leksion të vërtetë për pikturen, për artin, për qëllimin e artit dhe për shërbimin që i bëjnë artistët shodaërisë. Këtë e bën me thjeshtësi dhe përzemërsi, pa i shkuar ndër mend se mund të pozojë. Dhe përsëri vazhdon punën e tij, duke harruar që ju vazhdoni të jeni aty, duke mos u stepur aspak edhe sikur t'i mbledhësh dyzet vetë pas shpinës. Kur e rrëmbejn pasioni për të piktuuar, asgjë nuk mund ta shkëputë prej saj, ditën, natën, është ftohtë a është nxehjtë. I tillë ka qenë që student dhe më tej akoma, nxënës i liceut «Jordan Misja». Një nxënës disi i pazakontë, që e harxhonte kohën e lirë bër eksperimentet teknike të pikturen, një student disi i çuditshëm, që nganjëherë harronte dhe të flinte.

Skënder Kamberi, edhe kur vizaton, në të vërtetë pikturon. Objekti për të ka formën e përhershme të një sipërfaqeje materiale, të një strukturre materiale të shtrirë mbi sipërfaqen e sheshtë. Nuk do të qe e saktë të thuhet se ai e lyen pëlburën me anë të penelit, nuk do të qe e saktë të thuhet se e shtrin bojën mbi pëlburë, është më saktë të

thuhet se e vendos bojën mbi sargji. Me penela, me shpatel e me dorën e tij, kjo nuk ka rëndësi. Në qindra, mijëra copëza, grimca, bloqe, nganjëherë të rënda, të ashpra, «epike», nganjëherë të buta, të embla, «lirike», por përherë të tilla, që krijojnë së bashku një strukturë të vetme karakteristike, strukturën e mirënjohur të pikturen së tij.

Është një nga piktorët që e kanë gjetur shpejt gjuhën e tyre. Mund të thuhet se gjuha e pikturen së tij ka buruar kaq natyrshëm prej temperamentit të tij, sa edhe peizazhi vlonjat prej ndërtimit gjeologjik të zonës së Vlorës. Natyra e tij kolerike e ka shpënë vvetveti drejt ekspresioneve të vrullshme. Në çfarë pikërisht shfaqet kjo natyrë, në ngjyrën, në ndërtimin grafik, në linjat kompozicionale, apo në vizatimin e tij? Ngjyrat nuk janë shpërthyese, robëruese për vështrimin, pamja kromatike e tablove shumë herë mund edhe të të zhgënjejë me një ekuilibër thuajse asnjanës. Ka raste kur ky drejtpeshim shkon drejt grisë, ka raste kur shkon drejt kafesë.

Vizatimi i tij nuk shkëlqen. Nganjëherë në të ka edhe një përqindje arbitrariteti, nganjëherë edhe një përqindje naiviteti.

Teknika me të cilën pikturon Skënder Kamberi dhe që prej kohësh është bërë në këtë ose atë rast edhe objekt imitimi, nuk e shpjegon mënyrën e tij. Ai vetë mund të déshirojë ta nënvizojë rëndësinë e teknikës dhe mund ta rekomandojë si garanci për të ecur në rrugën e pikturen. Mund të arrini dhe të bini në ujdi me të se për këtë ose atë rast teknika ka qenë vendimtare; mund të ketë qenë, po për rastin e atij vetë nuk ka qenë.

E vetmja që ka rëndësi dhe që përbën forcën e vërtetë të pikturen së Skënder Kamberit është ngarkesa shpirtërore e pazakontë. Kjo mbetet e vërtetë për shumë gjëra që dalin nga dora e këtij piktori, një skicë, një bocet, një etyd, ose tablo.

Saktësia e paraqitjes që u bën ai modeleve që zgjedh nga realiteti i së sotmes dhe i së djeshmes së atdheut, nuk është vizive e ngjyrshme ose grafiqe, por emocionale, ndjesore.

A mund të thuhet se piktura e Skënder Kamberit është veçanërisht novatore? Është shumë më tradicionale nga sa mendohet, por guximi dhe dëshira e madhe me të cilën përpinqet të rrokë tema dhe tipare të reja të realitetit socialist të ditëve tona dhe këmbëngulja për interpretimin e tyre të fuqishëm, me gjuhë individuale, e shquan këtë artist të mirënjojur, dhe shërben si nxitje për piktorët më të rinj.

MBI NATYRALIZMIN

Marrëdhëniet ndërmjet shëmbëlltyrës dhe realitetit janë problem i përjetshëm i shprehjes artistike, që nga natyralizmi e deri te përparimet më të fundit të artit realist, te stilizimet dhe konvertimet më të guximshme e më të frysmezuara. Prandaj nuk mund të bëhet fjalë për shfaqjet konkrete të frysës natyraliste, pa përmendur më parë disa veçori të përgjithshme të kësaj dukurie të skajshme.

Natyralizmi ose elementët natyralistë në praktikën e pikturës e të skulpturës shfaqen si reaksion ndaj stilizimit. Kur artisti kërkon ta fuqizojë shprehjen e tij duke i intensifikuar përshtypjet ngajeta e gjallë dhe duke i përpunuuar, zbulon disa ligje estetike që janë të realitetit, por që bëhen kështu pronë e tij. Nëpërmjet tyre arrihet ai përqendrim që karakterizon veprat e artit në këtë ose atë shkallë. Një shesh me njerëz duhet të ngjishet që të hyjë në një tablo, por me një ngjeshje që nuk është e shkallës së topografëve, por e një shkallë të veçantë, e cila ua nënshtron trupat ligjeve të ritmit dhe të hierarkisë, ligje që hyjnë në sferën e figuracionit artistik dhe që janë një intensifikim i ndërgjegjshëm i pamjeve të zakonshme. Mungesa e perspektivës ajrore në artet figurative për një

periudhë prej mijëra vjetësh, mungesë që nuk ra në sy dhe nuk shqetësoi njeri, tregon se arti nuk është një pasqyrim i thjeshtë i natyrës dhe i realitetit, por paraqitje e tij në një formë të veçantë. Asnjeri nuk ankohet në teatër se përsë aty flitet me vargje dhe pse malet e sfondit janë të falsifi-kuara, por të gjithë zhgënjen kur aktorët interpretojnë dobët. Dhe, për më tepër, interpretimi e kënaq publikun kur është teatral. Madje, sikur të ndodhë që në mes të një skene të interpretuar me shumë mjeshtëri, një aktor të nxjerrë një fjalë të ligjërimit bisedor, spektatori do të mbledhë buzët. Nuk ka gjë më të panatyrrshme sesa pleksja e një aksioni dramatik me këngën, siç ngjet në opera. Mjeshrat tanë popullorë, në dekoracionet dhe kostumet dekorative, nuk riprodhojnë as dhe objekte te të cilat riprodhimi me stilizimin përkujnë vërsosmërisht, si p.sh. diellin me një rrëth, por kërkijnë dhe gjejnë shenja të tjera, më të tërthorta, por më shprehëse.

Kështu vërtetohet ajo që dihet prej kohësh, se arti nuk kërkon thjesht një pasqyrim të jetës, por nië raport intensiv me të.

Si shpjegohet atëherë që del natyralizmi në gjirin e artit, apo ngrënë kokë herë pas here shenjat e tij? Kjo ndodh, së pari, sepse ka artistë që nuk janë në gjendje të zbulojnë thelbin e dukurive të realitetit dhe mbeten te dukja, tek ana jashtme. Së dyti, sepse, në praktikën e sotme moderniste në botë, në vazhdim të shkëputjes së artit ngajeta, ka artistë që thellohen në formë dhe vetëm në formë, shkëputen nga përbajtja, bëhen më të vështirë, më të palexueshmë, të pa-kuptueshmë. Për këtë arsy, te njerëzit ringjallët dëshira për t'u rikthyer tek e vërteta e lexueshme artistike, tek ajo e vërtetë vizive që tregon për jetën me format e qarta të saj. Kjo dëshirë e

drejtë arrin nganjëherë deri aty saqë ringjall maliin për një figuracion të thjeshtë, pa probleme, të drejtpërdrejtë, ose, më saktë, për paraqitje jashtë gjuhës së figurashme. Dhe arrijmë kështu në pikën, nga e cila fillon e tatëpjeta e pikturës dhe skulpturës, e artit figurativ, që bëhen kështu të rëndomta, duke hyrë në pistën e garës me fotografinë artistike.

Cili ka qenë qëndrimi ndaj natyralizmit te ne?

Ka qenë një kohë para 30 vjetëve, kur mbizo-téronte ideja që kompozimi duhej të piktuhej patjetër dhe që nga fillimi e gjer në fund me model, si për figurat, ashtu dhe për mjedisin ku vepronin ato. Nganjëherë një gjë e tillë nuk bëhej për ta interpretuar modelin, por për t'iu nënshtuar plotësisht modelit. Ky ishte një qëndrim tipik natyralist dhe përpjekjet për të dhënë nëpërmjet këtij konceptimi motivet heroike të luftës dhe të rindërtimit sigurisht që do të dështonin. Dru-ajtja dhe vartësia fanaticë ndaj çdo gjëje që dukej, sido që të ishte ajo, e rëndësishme a e dorës së dytë, e karakterizonte këtë praktikë.

Shumë nga piktorët e mëvonshëm, duke e dënuar këtë mënyrë, pandehën se i lanë hesapet me natyralizmin. Mirëpo natyralizmi nuk ka vetëm një pamje. Duke qenë në thellësi një qëndrim i gabuar i artistit ndaj realitetit, natyralizmi mund të shfaqet, p.sh. vetëm në ngjyrë, kur piktorët kërkijnë me çdo kusht të riprodhojnë ngjyrat që shohin në realitet, pa menduar për asnjë çast se ngjyra është një nga elementet më shprehëse të pikturës dhe nuk mund të lihet kurrë pas dore. Por, duke qenë në thelb një qëndrim i gabuar i artistit ndaj realitetit, natyralizmi shfaqet, përbëti të gjitha, në përbajtje.

Me kohë, në rrjedhën e zhvillimeve të reja

të pikturës sonë të dekadave të fundit u rigjallërua tradita më e mirë dhe u shfaqën elemente të reja të shprehjes. Nga përkrimi i objektit, i cili gjente vend në një pjesë të krijimtarisë së viteve pesëdhjetë, u kalua në përdorimin e tij si dome-thënje. Këto zhvillime të reja u dhanë të rinxive teknikën e kompozimit dhe shumë elemente të tjera, që e forcuan fryshtësinë e profesionalizmit në artet tonë figurative.

Mirépo profesionalizmi nuk është i mirë në cdo rast. Në qoftë se një diletant natyralist i patalentuar e ka vështirë të fshihet pas padiges së tij, një i diplomuar mund të fshihet fare mirë pas artificeve të efektshme të nxjerra në formë shablonesh prej një shkolle arti. Prandaj edhe ka ndodhur që disa autorë të viteve 70, si dhe në ditët tonë, mjetet e reja dhe aftësinë thjesht teknike që iu dhanë i morën si një leje të përhershme për të prodhuar pa mundim vepra pa vlerë si në pikturë, ashtu dhe në skulpturë. Për hir të butesisë së komisioneve dhe të kritikës, disa nga këta dalin mjaft prodhimtarë nga afirmimi i lehtë prej zanatçiu.

Largimi nga natyralizmi nuk ka asnjë vlerë, po qe se nuk bëhet për hir të interpretimit artistik, në qoftë se shpërdorohet duke i hapur udhë punës pa fryshtësim. Është ai rast, kur përparimi që bën koha, shkakton nganjëherë dukuri regresive (sic mund të ndodhë, p.sh., me një mobilier artizan, i cili, sapo merr makinen elektrike, fillon e lëshon pak nga pak në mjeshtëri).

Nga ana tjetër, ta modelosh figurën ose objektin me kujdes dhe hollësi, nuk do të thotë se bën natyralizëm. Një vepër nuk është moderne vetëm sepse ka shumë stilizim. Stilizimi mund të jetë gati i padukshëm dhe vepra të flassë fuqimisht me gjuhën e kohës sonë. Shembull: portreti i Odhise Paskalit nga Sofokli Koçi, «Brendia» e Nexhme-

din Zajmit, 3-4 punë të vogla të bukura nga ekspozita e parë vetjake e të riut Agim Sulaj etj.

Si përfundim mund të themi se i vetmi ilaç me veprim të gjithanshëm ndaj natyralizmit është interpretimi i së vërtetës jetësore, i realitetit, në përbajtje, në formë.

SNOBIZMI — SHFAQJE E NDIKIMIT TË IDEOLOGJISË SË HUAJ

«Oh, ç'njeri i madh ky Prokokurantja,
s'ka gjë që t'i pëlqejë...!»

VOLTER

Përshtypja e përhapur se snobizmi i zë një rëzit vetëm në rini, është e gabuar. Prirja e natyrshme, e shpjegueshme dhe e ligjshme e rinisë ndaj së resë nuk ka të bëjë me snobizmin, që është një sëmundje. Është sëmundje që ndeshet në shtresa të ndryshme të popullsisë dhe jo vetëm tek intelektualët, por në çdo rast, në forma përkatësisht origjinale. Një snob e ka merakun e tij te mustaqet dhe te paraqitja e jashtme, tjetri te mobiljet veçanërisht origjinale, një i tretë te qëndrimi ironik ndaj gjithçkaje që e rrëthon (me përjashtim të vetes së tij), qëndrim që as ai vetë nuk ia di arsyen po ta pyesësh. Kur snobizmi shfaqet ndër artistët, atëherë bëhet shqetësues jo sa kohë që mbetet te pamja e tij e jashtme, por kur kalon te vepra e tij. Një artist i tillë, i infektuar nga sëmundja e snobizmit, mund ta ngatërrojë fryshtë novatore me snoben në art, me formalizmin.

Në shoqerinë tonë socialistë nuk ekzistojnë forca shoqërore që të janë posaçerisht të interesuara për ta nxitur shfaqjen dhe përhapjen e snobizmit. Snobizmi është plagë e mënyrës borgjeze dhe revisioniste të jetesës, dhe është sot mjaft i përhapur në këto vende. Raste të veçanta të shfaqjes së snobizmit ndër njerëzit tanë janë pasojë e qartë e ndikimit të presionit të ideologjisë së huaj.

Snobizmi në art tund flamurin e së resë. E reja në art është revolucionarja, e partishmja, që aspiron me gjuhën e artit përparimin dhe zhvillimin e mëtejshëm revolucionar të shoqërisë. Ndërsa kredoja e përjetshme e snobizmit ngul këmbë: «Thelbi s'është ndonjë gjë, dukja është gjithçka! «Snobi mund të bëjë mjaft lëshime, me përjashtim të njëres, dukjes. Ky është meraku i tij i përjetshëm, në dukjen është e përqendruar e tërë ndjeshmëria e tij, këtu nervi i tij mbetet përjetësisht i zbuluar. Sa herë që vjen puna t'i kërcënohet pamja e jashtme e çështjes së tij, ai është gati që për një plesht të djegë jorganin (kuptohet, kur ky jorgan nuk është pronë e tij).

Snobi është një kundërshti e gjallë. Ai bën çmos që të ruajë pamjen e tij që i është kushtuar artit me vetëmohim. Mirëpo mjafton t'i cenohet sadopak interesi vetjak dhe ai jo vetëm që e hedh tutje pa e zgjatur lëvozhgën idealiste dhe përtëj artistike, por zbulon në çast një natyrë ngushtësisht praktike. Në një rast të tillë snobi është gati ta çojë në djall çdo ideal estetik. Kështu, ai zbulon padashur natyrën e tij të mirëfilltë prej mikroborgjezi dhe pragmatisti.

Idetë e mëdha dhe kërkesat për fryshtësarrje të gjerë janë të huaja për shpirtin e imët të snobit. Pasionet e vërteta nuk janë për të. Si në jetë, ashtu edhe në art, vështrimi i pjesshëm është

karakteristikë e tij. Për këtë arsyé ai është koniunktural, i paparim dhe pa kritere të qëndrueshme. Snobi është mishërim i paqëndrueshmërisë. Të lidhesh me të është njësoj si të lidhesh me erën.

Nihilizmi është këndvështrimi i preferuar i snobit. Duke mohuar çdo vlerë rrëth tij, ai afiron vlerën e vet. Dhe duke qenë kritizer, as që e merr mundimin ta argumentojë nihilizmin e vet.

Snobi hiqet si original, ndërkoqë që vullnetarisht i është nënshtuar një modeli të caktuar. Në këtë mënyrë ai krenohet me daljen nga korizat e shijes së ngushtë kombëtare, duke mos kuptuar kështu që snobizmi, në përgjithësi, është varianti më qesharak i provincializmit.

Ka edhe raste kur snobit i pëlqen të luajë me «pasionin» e tij për artin populor kombëtar, por këtë e sheh si një luks, si çështje mode, si një rol që snobi e luan me kënaqësi, sepse i duket se i shton shkëlqimin, siç ia shton llaku një kartoline.

Kundërshtari i përjetshëm i snobit, armiku i tij i natyrshëm është thjeshtësia. Të jesh i thjeshtë dhe komunikues është për snobin shenjë vulgariiteti. Në veprat e tij, sikurse në marrëdhëniet me njerëzit, snobi shhang, para së gjithash, thjeshtësinë. Pish., dihet që kokrra e mollës është e rru-mbullakët? Snobi ta vizaton me cepa. E ke hundën të drejtë? Ta pikturen të shtremberuar, se, thotë, «është më interesante». Është i kaltër qielli? Ai e kthen në okër në pikturën e tij.

Snobi operon me gjysmë të vërtetat ose, më saktë, me të vërtetat të kuptuara në mënyrë të sipërfaqshme. P.sh., lufta që i shpall ai të rendomtës dhe rutinës, do të kishte qenë mjaft pozitive, po të mos merrte kuptimin e luftës për të ndjekur modën, shembullin e importuar verbërisht. Aspirata e tij për efekte të reja artistike do

të kishte qenë pozitive, pa dyshim, sikur këto efekte të reja të qenë zbulime të reja të së vërtetës jetësore të bëra nga ai dhe jo thjesht truke të formës. Fjala vjen, në goftë se ia ndërron ngjyrrën qilllit për të shtatën herë në peizazh dhe, në vend që t'i pastrojë të gjitha shtresat e bojës së vajit para se të vendosë të shtatën, e ngarkon pëlhurën me bojë togje-togje, dhe këtë nuk e bën se e sheh artistikisht të nevojshme, por se do që të imitojë dicka që i duket se e bën ky ose ai autor i shquar në këtë ose atë vepër, pa e vrarë mendjen aspak se përsë është bërë kjo në atë vepër dhe c'funkcion ka pasur aty materialiteti i bojës. Në goftë se lyen një kokë me bojë kafe dhe, në vend që të ndjekë me kujdes modelimin dhe materializimin e flokëve, e kthen penelin nga bishti dhe gërvishë mbi bojën e errët ca vija të bardha që të japid përshtypjen e flokëve, dhe e bën këtë jo se ka zbuluar një mënyrë të re, një ekuivalent të ri të realitetit, por se ka parë të bëjë kështu Pika-soja në ca portrete të tij kubiste. Mirëpo Pika-soja ndërtonte piktura të tillë mbi parimin e lojës, e cila është vërtet pjesë e çdo arti, por vetëm pjesë, ndërsa ai e çoi deri në absurditet dhe tallje me realitetin.

«Kultura, arti dhe muzika jonë, — thotë shoku Enver Hoxha, — duhet të përfitojnë dhe nga përvoja e kulturës, muzikës dhe artit të huaj. Unë kam theksuar edhe herë të tjera se ne nuk jemi ksenofobë.»

Në botë ka pasur përherë dhe ka individë, prirje dhe zhvillime përparimtare në art, dhe këto prirje lënë gjurmë e ndihmojnë në ecjen më tej të artit. Dihet ndihmesa e rëndësishme që ka dhënë lëvizja e impresionizmit në flakjen e pikturës akademiste, të skemave dhe recetave në ndërtimin e dritës, në daljen jo vetëm fizikisht, por edhe parimi shqiptar nga studioja në natyrë. Por

rolin e madh historik të impresionizmit e vlerësojmë duke kritikuar me të drejtë kufizimet e tij të mëdha, si dhe përfundimet e gabuara që nxoßen më tej këta piktorë nga përvoja e punës në natyrë. Ne njohim dhe vlerësojmë ndihmesën që dha neorealizmi në pikturën, në skulpturën dhe kinematografinë italiane dhe evropiane. Spektatori ynë është njojur gjérësisht dhe ka vlerësuar lart veprën pëparimtare të regjisoreve të tillë të shquar si Vitorio de Sika dhe Lukino Viskonti etj.

Kështu, artistët tanë mësojnë jo vetëm nga epokat e ndritura të lashta të artit botëror, si skulptura e Egjiptit të lashtë, arti klasik i Greqisë antike, Rilindja Italiane, nga piktorët e mëdhenj të Spanjës, nga romantizmi dhe realizmi frëng i shekullit XIX etj, por edhe nga gjërat më të reja të traditës së madhe realiste në art, traditë që vazhdon edhe sot e kësaj dite dhe do të vazhdojë si reaksion i natyrshëm ndaj atij sulmi modernist që iu bë artit në fillim të këtij shekulli dhe që nuk është ndërprerë aspak.

Snobizmi nuk shoqërohet përherë nga mungesë talenti. Prandaj rastet e dukurive të snobizmit, ndonëse janë të rralla dhe sporadike, janë të huaja e të dëmshme, sikurse janë të pavend në mjesisë tonë.

PËR NGJYRËN MUND TË BËHEJ MË SHUMË...

Të flasësh për ngjyrën në pikturë është vërtet kënaqësi, se piktura gjë më tërheqëse nga ngjyra nuk ka. Nga ana tjeter, ke qejf të gjesh banë me piktorët? Fol për ngjyrën!

Për ngjyrën është gati të japë mend çdo piktor. Megjithatë, nuk i gjen dot dy piktorë që të kenë të njëjtin mendim për ngjyrat e një pikture. Është tjeter gjë që mund të takosh edhe njëzet, të cilët piktuojnë me të njëjtat ngjyra. Ka të tjerë që janë të bindur se e vëtmja ményrë e drejtë në përdorimin e ngjyrave në pikturën realiste është ajo që praktikojnë ata vetë dhe se brezat e ardhshëm, në jetë të jetëve nuk do të kenë nevojë të kërkojnë gjë tjeter përvèç asaj që është gjetur nga këta piktorë. Pa mendoni pastaj sikur, larg qoftë, ndonjë nga këta të bëhet papritur anëtar i komisionit të pranimit të punëve në ekspozitë!

Të gjithë e kuptojnë dhe e pranojnë se arti nuk është kopjim i realitetit, por interpretim. E pranojnë se kompozimi është interpretim, se vizatimi është interpretim, se faktura është interpretim, po kur vjen radha te ngjyra, këtu s'ka burri që të marrë vesh se çfarë pikërisht kuptojnë

me fjalën «interpretim», si piktorët vetë, ashtu edhe spektatorët. Kur thonë se Abdurrahim Buza është kolorist, nuk janë dhe aq të shumtë ata që mendojnë kështu ngaqë janë të bindur vetë. Më të shumtët e kanë me të dëgjuar, Nuk janë pak ata që, duke qëndruar me respekt përpara piktrave të mjeshtrit plak, përtypen me vete: «Mirë xhanëm, po pse m'i bën faqet jeshile?!» Domethënë u vjen fort mirë që Buza është kolorist, por do të kishte qenë edhe më kolorist, po të mos kishte vënë dorë mbi «ngjyrën e mishit».

Eh, ç'të bësh! Është e vërtetë; mjeshtri i piktrës sonë, Abdurrahim Buza, ua bën faqet çikave të tij lozonjare edhe jeshile, edhe të kuqe, edhe të kaltra, edhe vjollcë, edhe të verdha. Jo jeshile të ngordhura, të kuqe, të kaltra, vjollcë e të verdha të shuara e të shurdhuara, por të freskëta si lule maji. Dhe keni parë ju që i dalin të bukura?!

Si shpjegohet pra, që Buza mbetet përbimi të gjithë, ndonëse nuk e imiton në veprat e tij ngjyrën e mishit, por e kthen në rozë, në portokalli, në të verdhë, të blertë, vjollcë, të kuqe? Po si shpjegohet që El Greku mbetet gjeni, ndonëse i bën fytyrat, në kompozimet e tij, të kaltra, vjollcë, të arta, të gjelbra, kafe? Po kur edhe një piktor mesjetar si Onufri, vete dhe ai dhe merr nëpër këmbë «ngjyrën e mishit», ngjyrë kaq e shtrenjtë për syrin njerëzor? E thonë se edhe ai është kolorist!

Ka edhe nga ata që mendojnë se arti i piktrës mund të jetë interpretim, por kjo nuk do të thotë, mendojnë ata, se edhe «ngjyra e mishit» duhet interpretuar. Dhe nga fytyra kalojnë te flokët, e kështu me radhë. Tani mund të bëhet një pyjetje: Që duhet ta ruajmë ngjyrën e fytrës kuptohet, por, më falni, cilën ngjyrë? Grinë e thyer me okërr, siç bën Guri Madhi në njérën nga dy

figurat kryesore të tablosë së tij «Heroinat e Kurveleshit»? Të zezen e thyer dhe reflekset inkandeshente që përdor Skënder Kamberi te fytyrat e kështjellarëve? Të gjelbrën e thyer siç bën Ksenofon Diloja te njëra nga tri fytyrat e piktrës «Të gjithë kufitarë?» Vjollcën e thyer, siç bën Foto Stamoja te portreti i Heroit të Popullit Muslim Peza? Të blertën e thyer në kafe siç bën Zef Shoshi me «Vjelësen e duhanit»? Apo të ruajmë kafenë me të zezë të thyer të fytrës së «Nënës» të Pandi Meles? Të ruajmë të kuqen e thyer në të verdhë, që propozon Shaban Hysa te «Besëlidhja»? Apo më mirë të ruajmë atë që pëlqen Sali Shijaku, të kuqen e zjarrtë te «Vojo Kushi» dhe grinë e thyer te «Kreshniku»? Më lejoni t'ju kujtoj se shembujt e mësipërm nuk janë dokudo.

Në qoftë se ndonjë lexuesi padashur i bie në sy që edhe nga këta shembuj, si dhe nga ekspositat del se mjaft piktura tonat vërtiten rrëth të zezës, okrës dhe të kuqes, ndonëse vendi ynë në brigjet e Adriatikut e të Jonit nuk vuan as për gjelbërim e as për kaltërsi, as për të verdhë diellore, se i ka këto me shumicë, fajin, sidoqoftë, nuk e mban autori i këtyre radhëve. Mos do të thotë kjo se përgjegjësinë duhet ta mbajnë stërgjyshët tanë, të cilët, duke na i kufizuar ngjyrat e flamurit në të kuqen dhe të zezën dhe duke mos derdhur në të gjithë ngjyrat e ylberit, mallkuani padashur për jetë të jetë tavacën e disa piktorëve tanë bashkëkohës? Apo rrënjet e së keqes duhet t'i kërkojmë gjetiu, te burrat e Lumës, të cilët, duke u treguar jashtëzakonisht të kursyer në ngjyrat e veshjes së tyre bardhezi, u bënë shkak përkëtë krizë kromatikë në shien e disa prej piktorëve tanë? Apo janë veshjet e burrave të Labërisë, që na e kanë bërë këtë mynxyrë? Por, fundi, kujt i takon të jetë më i gjerë në përdorimin e ngjyrave, më kurajoz dhe më me fantazi, piktorit

që ka bërë tetë a dhjetë vjet shkollë pikturë dhe që e kupton fort mirë se të gjitha ngjyrat janë të barabarta përpara ligjit, por që pikturon megjithatë me dy-tri ngjyra, apo vajzës së thjeshtë nga Zadrima. E cila guxon të vishet si buqetë lulesh të gialla? Mirëpo ja që po na bëhen goxha shumë piktore që bien në dashuri njëri pas tjetrit me të zezën, me okrën, të kuqen e thyer dhe nuk mbetet vecse të japid të vetmin shpjegim të mundshëm; dashuria nuk shpjegohet!

A është e mundur të shpjegohet se përsë e njëjta ngjyrë mund të duket herë kështu e herë ashtu? Një aksionist me këmishë rozë, i cili futet në hijen e nië rapi në ditë më diell. Kthethet në aksionist me këmishë vjollcë, ndërsa, kur del nga hija në diell, duket me këmishë portokalli. Nëjrrën e vërtetë të këmishës, d.m.th. rozën e realitetit obiektiv, a është e mundur ta shohim? Mund ta shohim vetëm me një kusht: që nga kuadri të përjashtohet një nga të dyja, ose hija e rravit, ose piesa me diell, ose përndryshe do ta shohim, kur të jemi me mot pa diell, të vrenjtur. Ky ligji objektiv i kolorizmit në pikturë nuk është zbulim laboratorik, por përgjithësim që del nga një vëzhgim i thjeshtë që mund ta bëjë kushdo. Po kështu, në ndriçimin e thjeshtë të një dite me diell, këmisha rozë nuk është e gjitha rozë, sepse piesa në hije kuptohet që nuk ruan të njëjtën ngjyrë me piesën e ndriçuar. Dhe të tjera dukuri që janë obiektive. Le t'u shtojmë këtyre ligjësive objektive dhe ligjësi të tjera objektive dhe subjektive, që i përkasin procesit të konvertimit artistik të realitetit, dhe kuptohen problemet që i duhet të përballojë artisti i vërtetë, probleme që e kanë zanafilën, megjithatë, te dukuritë e realitetit. Ligjësia obiektive, së cilës i nënshtronhet në kushtet reale këmisha rozë e aksionistik, vepron me të njëjtën mënyrë edhe mbi çdo pjesë

tjetër të figurës së njeriut, d.m.th. edhe mbi ftyrën.

Po mirë, mund të na thonë, ne bëjmë pikturë këtu, apo analizë dhe studim të natyrës? Bëjmë pikturë, por piktura çfarë është, në qoftë se nuk është analizë dhe studim i natyrës, i realitetit dhe i njeriut, i përkthyer në gjuhën e së bukurës?

Piktura, si mënyrë e vështrimit të botës në-përmjet ngjyrave, është një dhe e vetme, apo nënkupton mundësi të ndryshme të të vështruarit?

Mundësitë e pikturës janë praktikisht të pakufishme, por, duke u nisur nga kriteri i modelimit të formës vëllimore dhe i raportit të ngjyrës me tonin, mund të themi se kemi dy lloj të pikturuari, tonal dhe koloristik. Për ta bërë të qartë këtë ndarje, do të marrim nga një shembull për secilën mënyrë, një shembull të huaj dhe një shqiptar.

Një nga mjeshtrit gjenialë të modelimit tonal është Rembrandti i madh. Rembrandti ka qëlluar të jetë edhe kolorist, d.m.th. mjeshtër i ngjyrës, por mund edhe të mos ishte, sikurse nuk pati qenë mësuesi i tij i parë, Karavaxhioja. Megjithatë, vështrimi i Rembrandtit nuk udhëhiqet aspak nga ngjyra në modelimin e tij. Tabloja e Rembrandtit është, para së gjithash, një zhvillim muzikor i toneve, nga më e qarta, deri te më e errëta. Tërësia e toneve të një kuadri të Rembrandtit, si dhe zhvillimi i hollësishëm i tyre brenda kuadrit nuk është një regjistrim objektiv i një mjeshtësi real dhe as organizim i fantaksur, por vendosje me ndërgjegje e çdo toni, e çdo grimce driteje tonale dhe hixeje tonale në sipërfaqen e organizuar artistikisht, me një qëllim të qartë shprehës. Kur flasim për Rembrandtin, e kemi fjalën për një nga variantet e pafund të pikturës tonale, historiia e gjatë e së cilës përfshin jo vetëm Rembrand-

tin, por edhe shumë gjeni të mëdhenj para edhe pas tij, si Leonardo da Vinçin, Velaskezin, Engrin, Kurbenë etj.

Shembullin e dytë do ta marrim nga Shqipëria jonë, meqenëse e kemi këtu një rast tipik të modelimit nëpërmjet ngjyrës (mund të mos e kishim, ka vende që s'e kanë): Abdurrahim Buzën. Piktura e tij në themel të saj ka modelimin me anë të ngjyrës. Logjika piktorike që zbaton Buza në ndërtimin e kuadrit, është ajo e ngjyrës. Këtu nuk duhet të ngatérrohemë me ato vepra të Buzës, sidomos të periudhës së fundit, ku ai, duke i bërë një lëshim shipes sonë të përgjithshme të pikturës tonale (lëshim që nuk duhej ta kishte bërë në asnjë mënyrë), i shoqeron ngjyrat e tij (të thjeshtuara shumë në këtë rast) me konture grafike dhe ndërhyn aty-këtu me bloqe tonale, dhe që megjithatë, janë vepra që mbajnë vulën e tij. Kur flasim për Buzën si shembull i modelimit kromatik, kemi parasysh vepra si «Gruaja me dhi», «Autoportret» (1934), «Portret vajze», «Masakra» etj., si dhe një numër të madh akwarelesh në miniaturë, që janë kryevepra ngjyre dhe arti.

Si është zhvilluar piktura jonë deri sot? Ajo ka ndjekur kryesisht modelimin tonal me vazhdimi i dhe këmbëngulje. Që nga Idromenoja, Martini, Mioja, Zajmi, Stamoja, te Madhi, Jukniu, Shoshi, Haxhiu, Kamperi, deri tek Asllani, Ahmeti, dhe deri te më të rinjtë, piktura jonë ndjek në mënyrë të ndërgjegjshme parimin tonal.

Shkalla e shipes për ngjyrën, shije që ekziston te cdo piktor me përvojë, ndryshon, natyrisht, nga njëri piktor te tjetri. Kjo varet nga ndjeshmëria, nga kultura etj. Po kur përcaktojmë nëse një piktor ndjek këtë apo atë kriter, tonal apo koloristik, kemi parasysh rrjedhën e përgjithshme të pikturës së tij dhe jo një ose dy raste të veçanta, ose kërkimet që ai mund të bëjë nganjë-

herë, por që nuk dalin megjithatë jashtë shtratit të pikture së tij.

Këtu ia vlen të qëndrojmë pak dhe të mendohemi një çast për të mirën e pikture sonë dhe të brezave të rind të artistëve. A është mirë që pikatura jonë të flasë përfjetësisht me gjuhën e tonit, kur mund të flasë edhe me gjuhën e ngjyrës? A do të ketë përfitim, apo do të ketë humbje pikatura jonë nga zhvillimi paralel, i harmonishëm i parimit tonal dhe i parimit kromatik? Dhe a ka argumente të mjaftueshme për të qëndruar vetëm te parimi tonal, përdërisa në pronsinë tonë hyn fondi i artë i veprave më të mira të Abdurrahim Buzës, kolorizmi i të cilit ka bërë përshtypje kudo (kur është përfaqësuar drejt), siç kanë bërë përshtypje kostumet tona të mrekullueshme popullore, pjesa më e madhe e të cilave ndjekin parimin koloristik? Besoj se është një çështje që ia vlen të diskutohet.

PARA DY TABLOSH

«Mediokriteti pandeh se artisti mund tē krijojë rregullisht, si nēpunësi. Që këtej rrjedh fatkeqësia.»

BALZAK

Në katin e tretë të Galerisë Kombëtare të Artit ndodhen të ekspozuara edhe dy kompozime të përmasave të mëdha, që mbajnë të njëtin titull: «Naftëtarët». Njëra është e Agim Shamit dhe tregon se si u mbyll një fontanë, ndërsa tjetra e Pandeli Lenës, një çast manovrimi te gryka e sondës. Që të dy këto piktura kanë qenë paraqitur në ekspositën kombëtare të vitit 1981.

Dy tablotë janë mjaft të afërta nga subjekti dhe mënyra e të kompozuarit (skema piramidë, që përsëritet pa fund në praktikën e disa piktoreve dhe që është dëshmi e varfërisë së fantazisë), por nuk janë afër nga vlera: tabloja e Agim Shamit flet me gjuhën e artit, ndërsa ajo e Pandeli Lenës është një pikturë skematike.

Pandeli Lena ka viztuar në kompozimin e tij katër sondistë. Dy prej tyre janë duke térhequr kavon e celiktë, që zbret nga maja e kullës, dhe

kryejnë një manovër, i treti është duke térhequr fort një levë të pjesës qendrore, ndërsa i katërti mban drejtimin dhe komandon lëvizjet e shokëve të tij. Sipërfaqja e tablosë me figurat, objektet, planet është e organizuar drejt. Autori vizaton në mënyrë të kënaqshme dhe, me përjashtim të figurës së parë majtas, ndërtimi i çdo figure, si dhe modelimi i tyre janë bërë me qartësi dhe madje me një stilizim të thjeshtë, i cili arrin të përçojë njëfarë force. Jo vetëm organizimi tonal dhe linear, por edhe ai koloristik është arritur nga Pandeli Lena në mënyrë të kënaqshme. Duke i qëndruar pushtetit të kafesë, ose, më saktë, përzierjes së grisë me kafenë, ndërtimi i ngjyrave ruan tek ai parimin zonal, me sipërfaqe që hyjnë në marrëdhënie të ndërsjellta mjaft të përbajtura. Modelimi tonal udhëheq ndërtimin koloristik, duke e mbajtur ngjyrën në kufijtë e një shërbimi mjaft të njojur dhe po aq të përhapur, por që arrin të shprehë megjithatë efektet e nevojshme plastike. Në këtë mënyrë, kjo tablo nuk mund tē kritikohet për monotoni ngjyre a mungesë harmonie.

Kështu, në shikim të parë duket sikur te piktura e Pandeli Lenës gjithçka qëndron mirë ose përgjithësisht mirë. Por po aty ndien padashur që e tërë tabloja është një ndërtim piktorik i ftohtë. Aty diçka mungan. Çfarë?

Duke u thelluar më tej në përbajtjen e tablosë së Pandeli Lenës, fillon të kuptosh që personazhet nuk e kanë mendjen tërësisht te puna që kryejnë, por te ne që po i shikojmë, sido që vështrimet e tyre nuk janë të kthyera nga ne. Ata shqetësohen më tepër për përshtypjen që do të bëjnë pamja dhe lëvizjet e tyre sesa për veprit met që kërkon procesi i punës. Naftëtarë që térheq levën, përpinqet me çdo kusht të krijojë një siluetë

sa më të imprehtë, patetike, pa marrë parasysh që veprimi i tij është pjesë e veprimeve të përbashketa të të gjithë grupit dhe se ai hyn vetiunë raporte të caktuara plastike me ta, raporte që nuk mund të mos përfille. Dy sondistët majtas, që tërheqin kavot, nuk arrijnë të krijojnë përshtypjen se vërtet i tërheqin, por sikur deshirojnë më tepër të krijojnë, për hir të formës, një grup ayligurësh, i cili të arrijë një efekt kompozicional. Veçanërisht e fryrë në mënyrë të paperligjshme është rigura e punëtorit përballë, i cili nuk kuptohet se përsë e kap litarin vetëm me njëren dore, kur kërkohet forca, shkathësia dhe përgendrimi i skajshëm. Figura tjetër, e cila drejton manovrën, është shprehja më e qartë e mungesës së vërtetësisë së gjestit, si dhe e mungesës së thjeshtësisë së personazhit, i cili nuk arrin të qëndrojë në kufijtë e natyrshëm të rolit të tij, por kërkon të shtrihet edhe më përtëj subjektit të tablosë.

Te «Naftetarët» e Agim Shamit gjejmë të njëjtën dëshirë për një kompozim kompakt, ose, të paktën, për grupim «të fortë» të figurave, grupim që bëhet nëpërmjet skemës aspak origjinale të pirimidës. Nga ana tjetër mund të thuhet se edhe autori i kësaj tabloje, siç bëhet për çdo kompozim, e ka menduar dhe organizuar në mënyrë të ndërgjegjshme skemën e vendosjes dhe të vizatimit të çao figure dhe subjekti. Por te kompozimi i uj është ruajtur pikërisht ajo shkallë rastësie dhe spontaneiteti, e cila është veprimi të natyrshëm. Naftetarët e tij e kanë mendjen te puna. Ata thua jse nuk kanë dijeni, ose e kanë harruar fare se dikush po i vlerëson nga jashtë e po i pikturnon. Ata s'bëhen merak fare në ruajnë apo nuk ruajnë një pamje heroike në kohën që po mbyllin fontanën. Portreti i sondistit që thérret, nuk është aspak i bukur, mund të thuhet madje se është vi-

zatuar me primitivitet me atë hundën e rrudhur nga kontraktimi muskular, me buzën e poshtme dhe mjekrën e zgjatur tej masës. E megjithatë, ai bëhet qendra ekspressive e tablosë, kolona zanore e kuadrit, dhe jehona e britmës së tij shundohet plotësisht nga dhjetëra pompa zjarrëfikësish. që vërshojnë mbi të dhe mbi gjithë trupin e vogël të heronjve, për t'i mbrojtur në aktin e rezikshëm të mbylljes së një fontane. Bukuria e këtij personazhi qendror nuk është bukuri e tipareve a e modelimit te hekurt, por e forcës shprehëse të marrëdhënieve të tij me grupin.

Modelimi i forcës vëllimore tek Agim Shami është i rrjedhshëm, në mënyrë të vjetvetishme dhe nuk dallohet nga ndonjë aftësi skalitëse e vecantë a stilizim shprehës. Jo vetëm kaq, por atv-këtu mund të të kujtojë edhe fotografinë, gjë që sigurisht, nuk përbën meritë. Aty mund të gjesht edhe mangësira të dukshme të vizatimit, si p.sh. figura që na ka kthyer shpinën, në plan të parë. e cila është vizatuar me shumë ngathtësi.

Te tabloja e Agim Shamit nuk dallojmë ndonië aftësi të vecantë prej koloristi, ose ndonjë zbulim në këtë fushë. Jo. Në rastin më të mirë këtë pikture mund ta quash një «pikturë në vishnie», po të jetë se me këtë kuptojmë që vishnia është këtu vetëm një prirje. Për më tepër, po të mos qenë disa reflekse e penelata, portokalli, do ta quanim thjesht një pikture monokrome.

Duke e parë me vëmendje tablonë e Pandeli Lenës vetëm nga ana e mjeshtërisë viktorike, e pranon atë si të kënaqshme. Por edhe sikur të arrinim të gjenim në të prova të një shkalle më të lartë të mjeshtërisë dhe të kulturës së ndërtimit viziv, e papritura e një tabloje nuk mund të jetë e papritur e ndërtimit formal. Ajo është e papritur e ndërtimit ideoemocional. Është një çast je-

tësor i kapur në befasi. Vetëm në këtë mënyrë mund të shpresojmë se mund të arrijmë ta shpiem të gjallë deri te shikuesi vërtetësinë artistike të jetës. Në rastet kur nuk nisemi nga kjo, mund të arrijmë të ndërtojmë vetëm një pikturë me shprehë të njojura e të përsëritura, të cilat i përkasin atij fondi famëkeq, që në letërsi i thonë «letrarizma» dhe në pikturë mund t'i themi «piktorizma». Nga tablo të tilla mund të burojnë vetëm ndjenja të simluara, sepse kemi të bëjmë me emocione të trashëguara, që nuk kanë buruar vetiu nga kontakti me jetën.

Për të kriuar një veprë arti nuk mjaftojnë teknika dhe mjeshtëria në kuqtimin e ngushtë të fjalës, sikurse nuk mjafton as vetëm kontakti me materialin jetësor në përgjithësi. Arti nuk është në gjendje ta riprodhojë jetën realisht, por vetëm estetikisht. Një veprë e artit figurativ, njësoj si një poezi, një roman o një simfoni, arrin ta transmetojë jetën vetëm nëpërmjet ekuivalentesh të posaçme për atë art. Një piktor a një skulptor mund të preken e të tronditen sa t'u dalin lot, para një modeli, por kjo nuk i shërben askujt, në qoftë se ai di vetëm të kompozojë, të vizatojë e të pikturopyjë mirë, por nuk arrin të gjejë te modelli real një ekuivalent të dukshëm, viziv, të ndjenjave të tij. Ata piktorë dhe artistë që venë me shpresë se, duke e njojur zanatin e tyre emocionet që kanë ngajeta do ta gjejnë vetë shtratin estetik përtë rrjedhur ngajeta vetiu gjer te spektatori, gabohen. Ky është edhe shkaku që jo çdo pikturë është veprë arti, sikurse jo çdo këngë është muzikë dhe jo çdo vargëzim është poezi.

Çfarë ekuivalenti viziv, konkret ka mundur të zbulojë Agim Shami te këta naftëtarë që mbyllin një fontanë? Të thuash, hiçgjë: shkëlqimin e mushamave të zeza e të lagura, në një ndriçim prej

blici. Këto vezullime të befasishme dhe reflekset e imprehta si teh brisku e kthejnë gjithë tablonë në një burim të papritur tensioni dramatik, që shpreh përqendrim dhe rrezik. Të nëntë naftëtarët janë vërsulur përbimi atë masë metalike të ndriçimeve të zjarrta portokalli jo që ta mbytin, po që ta disiplinojnë, ta vënë në shërbim të ekonomisë, të njeriut. Gazi naftëmbajtës, që ka shpërthyer nga thellësitetë e tokës, mund të shndërrohet në një përbindësh të zjarrtë nga çasti në çast, duke bërë hi çdo gjë përreth, njerëz dhe makineri bashkë dhe duke e çuar dëm punën dhe mundimin e qindra njerëzve, si dhe vlera të mëdha monetare. Është një punë me tension, një çast në dukje i qetë dhe i ftohtë, një çast përgjegjësie të lartë. Pikërisht këtë përbajtje të vërtetë dhe peshën e rendë të përgjegjësisë autori i tablosë arrin ta japë me anë të këtij ekuivalenti viziv, që e ka zbuluar me mprehtësi dhe originalitet. Shkëlqimet e së zezës në vishnjë janë të ftohta e të papritura. Ato kundërshtohen me mjeshtëri nga portokalli i zjarrtë i pjesëve metalike dhe zjarri i metaltë i fytyrave dhe duarve. Në mënyrë të koncentruar dhe të gjallë, e tërë kjo kundërti vjen e përgendrohet vetiu dhe në mënyrën më të natyrshme te profili i rreptë i naftëtarit që therrët. Në këtë mënyrë syri i spektatorit arrin të ndjekë me lehtësi dhe kureshtje të gjallë atë zhvillim kompozicional, plastik e dinamik që niset nga e përgjithshmjë dhe mbaron te hollësitet. Nuk është një zhvillim thjesht plastik a koloristik, por ideoemocional.

REALITETI SI ĖNDERR

(Shënime nga ekspozitat e fëmijëve)

«Ua tregova tē rriturve kryeveprēn
time, duke i pyetur nē u vinte frikē
nga vizatimi im.

Ata m'u përgjigjën: «Pse, nga kapelja do të kemi frikë?

Ajo s'qe kapelē, po gjarpri boa, qe
kishte gëlltitur një elefant»

ANTUAN DE SENT EKZYPERI

«Princi i vogël»

Piktoret e vegjel janë të bindur se me vijat
dhe ngjyrat e tyre tregojnë të vërtetën për botën
dhe për gjërat që kanë parë e kanë dëgjuar. Ata
vizatojnë dhe pikturojnë siç këndon zogu, duke
shprehur ashtu si u vjen çudinë e tyre për mrekun-
linë e jetës që e rrethon.

Kur Beni, Entela ose Evisi ulen dhe vizatojnë, nuk dyshojnë pér asnjë çast pér atë që paraqesin dhe as ndër mend nuk iu shkon se pér realizimin e sai 'ekziston edhe diçka, që të rriturit e quajnë teknikë pikturimi. Dhe çdo piktor i rritur quditet pastaj se si ia del autor i vogël ta realizojë ta-

bloné e tij me vërtetësi artistike, pa pasur nevojë pér kurrfarë teknike.

Si janë veprat e ekspozitës së fëmijëve që u hap kohët e fundit në Pallatin e Kulturës të kryeqytetit dhe që mbajnë firma sot të panjohura e nesër ndoshta shumë të njohura?

Fationi 13-vjeçar ka vizuatuar një luftëtar me shpatë, që mban për freri dy kuaj, një të bardhë e një të kuq, dhe dy male të bardha te qelli i quartë. I kujt është ky kalë i dytë, i prijësët sypatrembur, apo i shokut të vrarë në betejë?

Skënderbe kaq të gëzuar sa i Altinit 9-vjeçar
sigurisht që nuk keni parë. Të gjithë armiqtë pë-
rreth tij bien si mizat, blu, jeshile, të verdha.

Ju pandehni se një betejë me shpata është vetëm e tmerrshme. Joni 5-vjeçar na bind se ajo ka edhe një pamje të gëzuar me kështjellarët krenarë dhe me armiqëtë e skuqur nga inati dhe bërë portokalli.

Dhe thellë në horizontin e qetë, anija e vogël e Suelës lëkundet mbi valë dhe nxjerr tym të kuq, gjë që na bind se kemi të bëjmë pikërisht me anijen e Suelës.

Nëntë vjetët e moshës së tij janë të njaf-tueshmëri për Gentin për të na treguar në kompo-zime të ndërtuara me fantazi dhe mjeshtëri sa trima sypatrembur qenë partizanët dhe sa heroi-ke betejat e tyre me armiqjtë.

Tek Irida zbulojmë sa i bukur është qyteti dhe sa i gëzuar kur bie shi i argjendtë.

Korrje gruri si kjo e Albanit nuk ka ndodhur tjetër herë, kaq e freskët në mes të vapës.

Ani dhjetëvjeçar është i dhënë pas një gjinie serioze të pikturës, pas natyrëmortit, dhe është e qartë se dhe vizatimi i tij përmban qëllime serioze.

E keni vënë re që piktorët e rritur shpesh

kanë frikë nga e gjelbra e barit në pranverë? Jona është vetëm 3 vjeç dhe nuk ka frikë! — Enjte Fwiri nuk arrin të kuptojë

Jo vetém kaq, por Ervini nuk arrin te kuptojë se për ç'arsye u duhen të rriturve 22 tubeta me ngjyra të ndryshme, kur atij i mjaftojnë vetëm dy, dhe, duke përdorur vetëm kafenë dhe të gjel-brën e gjallë, arrin të ndërtojë një grup-portret që s'kemi ç'i themi.

që s'kemi q'i themi.
Po Fedra? Ajo ishte vetëm katër vjeçë kur i qëlloi të shihte edhe ngjarje me të vërtetë dramatike: pa në dasmë nusen që qante! Dhe kjo gjë e tronditi kaq thellë, sa të nesërmen, në orën e vizatimit në kopsht, Fedra mori dhe pikturoi këtë nuse të bukur që kemi këtu, nga sytë e thellë të së cilës burojnë këta lot të ndritur argjendi, që pikojnë dhe kthehen pastaj në lule të arta, të përhapura si gurë të çmuar fustanit të bardhë.

Ndërsa pema e Anës gjashtëvjeçare është që çuditshme vërtet. Nuk merret vesh mirë në është lule apo pemë, në është fikus apo palmë. Megjithatë është e sigurt që në degët e saj rriten karamolle «Zana», të kuqe, të verdha, vjollcë, të kaltra, të tillë, që u ngjajnë vërtet bananeve.

Dhe tē gjitha këto gjëra te habitshme, këtë quditira te quditshme tē fantazisë fëmijërore janë tē vërteta, ato kanë vërtetësinë e dashurisë dhe tē entuziazmit tē sinqertë fëmijëror pér jetën, pér realitetin, pér botën.

Cfarë është interesante për spektatorin e rritur dhe për piktorët te pikturat e fëmijëve? Gjallëria e jashtëzakonshme e shprehjes, fantazia e cuditishme, naiviteti dhe dëlirësia e fjalorit poetik. Nga arti i fëmijëve mund të mësohet shumë.

Mos do tē thotë kjo se një i rritur mund tē bëjë pikture si fëmijë? Jo, nuk është nevoja. Fëmijët, tē parët, nuk do ta pëlqenin këtë gjë.

Fëmijët, piktorët e vegjël 6, 7, 10, 13-vjeçarë, nuk kanë frikë nga tema. Për ta çdo temë është një festë, kthehet në mrekulli të vogël, mjafton t'u pëlqejë. Piktori i vogël pikturon përherë me dëshirë, prandaj nuk bëhet kurrë zanatçi. Ai nuk di ç'do të thotë të mbushësh me mërsi një sipërfaqe sado të madhe. Për të sipërfaqja nuk është problem, numri i figurave nuk është problem, vërtetësia artistike nuk është problem. Ai piktron me bindje dhe përpikmëri artistike si një gjë që e ka parë ashtu, dhe një gjë që vetëm e ka dëgjuar, ose e merr me mend.

Çdo piktor me përvojë e di seç bela është perspektiva ajo rreth së cilës është njëfarrë mënyre për hir të idesë së një tabloje në këtë ose atë rast. Për Irisin 11-vjeçare kjo nuk përbën problem. Me thjeshtësi arrin ajo të vizatojë një plazh të tërë, ku arrijmë të shikojmë qartë deri figurën e fundit fare, me çadrën ngulur në rërë në skajin tjetër të plazhit.

Ja si i kompozon figurat e ekskursionistëve të saj Evis Idrizi 12-vjeçare. Në plan të parë, në këndin e djathë, poshtë tablosë, dy vajza të shkëputura nga grupi, që flasin më njëra-tjetër, duke ecur me krahun te njëra-tjetra të buzëqeshura; pas tyre, më lart, grupi kryesor. I pari gërshteton duart në gjoks, e dyta me krahët e lira në ecje të natyrshme, e treta mban në dorë një triko, duket ka vapë, e katërtë me duart e kapura prapa lirshëm, i pesti i bie fizarmonikës dhe e gjashta futur duart në xhepat e përparëses. Grupi, lividhi, drurët, malet dhe qielli, të gjitha janë në festë. Ritmi i përsosur, liria e shprehjes dhe përzemërsia e gjuhës të shkëlqyera.

Leonard Beshiri 13-vjeçar tregon për një bëtejë me shpata dhe kuaj. Kuajt, si afër dhe larg, duken qartë gjer në hollësi. Janë njësoj të mëdhenj. Njëri kalë, siç duket, është goditur, ndaj rrëzohet me gjithë luftëtar. Bukur fort! Atëherë Leonardi merr dhe e kthen letrën e vizatimit me kokë poshtë dhe me të njëjtin kujdes dhe dashuri e vizaton me hollësi kalin në këmbë dhe luftëtarin mbi të. Dhe kur letra kthet përsëri në vend, ja tek e kemi dhe luftëtarin me gjithë kalë, me këmbë përpjetë! Arabeskat që formojnë figurat e kuajve dhe të luftëtarëve janë të mrekullueshme dhe nuk e përsëritin aspak njëra-tjetër, se kjo gjë do ta mërziste vetë autorin e vogël.

Guxon një piktor i rritur ta bëjë një koder portokalli në dritë dhe të kuqe kafe në hije, mës kodrash të tjera të gjelbra? Qiellin të verdhë të fortë dhe diellin të kuq dhe portokalli? Mirëpo Altin Abazi 13-vjeçar e bën, sepse ka vënë re që, kur dielli perëndon, kodra merr flakë. Altini nuk e di, sigurisht, se kështu, padashur, zbaton me pjekuri artistike ligjin e madh të interpretimit të ngjyrës, i cili e sheh vërtetësinë realiste të ngjyrës jo në përpikmërinë e riprodhimit të pjesëve të vëçanta, por në harmoninë e përgjithshme të tablosë.

Ja një pamje e bukur dhe e këndshme: sipërfaqja është e téra e kaltër. Në mes të likenit qëndrojnë tre lejlekë, në një këmbë sigurisht. Ca kallama anës likenit dhe pak tokë rozë zbret në njérën anë. I ka vizatuar dora e Entela Bodinakut, që është vetëm 10 vjeçë.

Eled Fagu, duke qenë vetëm 8 vjeç, e mbush me qetësi, dhe kënaqësi gjithë letrën tejembanë me pastel blu ultramarinë, të fortë e të thelli. Mund ta merrni për qiel, por është det, ose të dy bashkë. Sidoqoftë, një anije e lashtë e Ilirisë lun-

dron n  mes t  tij. Anija ka edhe nj  vel , e cila, po t  mbetej e bardh , si   sht , do t  prishte pun  n  nj  nat  kaq t  thell  blu. At her   ajo b het e verdh , ngjyr  limoni dhe, ashtu si   sht , gjysm hark, i ngjan shum  h n s vet . K shtu, duket sikur  sht  b r  vet  h na vel  lundrimi. Po kjo nuk ka r ndesi, mendon Eledi i vog l se  sht  poezi, themi ne.

Piktorët e vegjël dinë të gjejnë poezi edhe në gjérat më të thjeshta, edhe në pamjet më të rëndomta. Ç'është ai laborator i fshehtë që punon brenda shpirtit të tyre të njomë prej artisti dhe e kthen si me magji një fakt të rëndomtë në poezi?

Piktura e të rriturve mund të fitonte shumë nga vizioni i ndritur fëmijëror. Çfarë? Nuk guxoj- më të themi mjeshterinë. Por mund të mësonte aty që të jetë më e thjeshtë, më e drejt-përdrejtë, më e përzemërt. Është e thjeshtë të mendohet se kjo s'ka të bëjë me mjeshterinë. Por a është e mundur vallë që konceptimi i veprës të mos ketë lidhje me mjeshterinë? Nuk e besojmë. Ndërlikimi tepër i madh i teknikës te piktorët e rritur ka të ngjarë të ketë lidhje, dhe jo pak, me mungesën e thjeshtësisë në perceptimin e realitetit. Me sa duket, në mënyrë tradicionale, është dhunuar ajo shkallë e admirueshme thjeshtësie, që e bën komunikimin të ngrrojtë, të përzemërt, njerëzor, të tillë që të rrëmben, ajo shkallë thjeshtësie dhe përzemërsie, që e bën bashkë bisedimin me shikuesin emocionant. Të marrim, p.sh., pikturen tonë monumentale. Sa shumë mundim, sa shumë sforsim dhe sa shumë rregulla dhe nënrrregulla teknike, mjeshtërore, por, qoftë dhe artistike, që ndiën kur e sheh atë! E pse? A nuk e ndërlikon vetë ky fakt mendimin dhe a nuk e çon më në fund në zbehjen dhe nxjerrjen e ndjenjës? Kjo shkon deri te ngjyra, deri te vizatimi, por nis që nga kompozimi.

Piktori i vogël nuk respekton rrugët e shëguara të formës, të konceptimit artistik, të interpretimit të mësuar. Kështu atij i duhet t'i hapë rrugë vetë fryshtimit mbi letër, mbi pëlhurë, mbi karton. Kështu ai detyrohet të krijojë në çdo hap, në çdo vijë, në çdo centimetër katror. Por, c'është e vërteta, meqenëse nuk është i mbushur me përvjohje, vizatimi i tij është i mbushur me naivitet. Për këtë arsyet i artit i tij ka përherë një dozë humor. Megjithatë, për të arti është jo thjesht një zbatim, siç pandehim nganjëherë, por një çështje serioze. Shumë herë më ka rënë rasti të takoj në sallat e heshtura të ekspozitive të fëmijëve autorë të heshtur dhe shumë seriozë të këtyre veprave të çuditshme. Zakonisht ata vijnë vetëm, se, siç duket, u vjen zor të thërrresin dhe të tjerë për t'u gëzuar ekspozitimit. Kur hyn në bisedë me ta, të bën përshtypje pikërisht serioziteti.

Po, arti i fëmijëve është çështje serioze!

Të gjitha ato që dinë të rriturit, vizatimi me vërtetësi objektive, me njohuri anatomike i trupit të njeriut, vizatimi me njohuri shkencore i botës që na rrethon, dhe pjekuria e mendimit filozofik të të rriturve, do të fitonin shumë po të ruanin freskinë e ndjeshmërisë fëmijërore. Pa rënë kurresi në infantilizëm, duke ruajtur të paprekur konceptin realist të të piktuarit, të rriturit mund të nxirrin mësimë me rëndësi nga arti i fëmijëve.

Dhe tani dy fjalë përmbytjet si punohet me fëmijët. Kemi një rast interesant, që bie në sy në ekspozitë. Punët e piktoreve të vegjël të rrethit të shtëpisë së pionierit nr. 4 të kryeqytetit. Ato bien në sy për dekoracionin e theksuar, për sigurinë teknike, për qartësinë e realizimit. Bien në sy edhe për një tipar jopozitiv: për njëfarë një-

trajtshmërie. Si është kjo punë? Që punët e kësaj shtëpie pionieri zënë pjesën më të madhe të ekspozitës nuk është pozitive, sepse tregon punën e paktë të shtëpive të tjera të pionierit në kryeqytet, si dhe të shkollave të shumta. Por, nga ana tjetër, tregon dhe punën e madhe që bëhet në këtë shtëpi pionieri. Këtë rreth duket që e drejtton një piktori i apasionuar pas fëmijëve. Në këtë vështrim, puna që bëhet aty është, siç tregon ekspozita, punë shembulllore dhe të tjerët kanë ç'mësojnë. Por mund të bëhet megjithatë një vërejtje me rëndësi: është ndërhyrë shumë në botën fëmijërore. Është e drejtë, e dobishme dhe e nevojshme t'u mësojmë fëmijëve c'është ngjyra, si organizohet, c'është blloku, linja, konturet, drita, e ftohta, e ngrohta etj. por nuk është e drejtë që të gjitha këto t'ia nënshtrojmë, t'i kufizojmë brenda një shijeje të caktuar, brenda një ndërtimi stilistik të caktuar. Jo vetëm që nuk është e drejtë, por është pedagogjikisht dhe artistikisht e gabuar. Kjo ka ndodhur sigurisht padashur, madje duke u nisur nga dëshira më e mirë. Shumë nga punët e këtij rrethi të shtëpisë së pionierit nr. 4 janë me të vërtetë shumë të bukura, por të vjen keq që limitet e përcaktuara të shijes nuk kanë lejuar të gjejnë shprehjen e tyre tiparet, qoftë dhe elementare, të individualitetit fëmijëror.

SHËNIME NGA NJË EKSPOZITË

«Nuk mjafton të kapësh temën e ditës, të shkruash për heroin pozitiv, për realitetin socialist etj. Vetëm kjo, pa mjeshterinë artistike, nuk mund të të emocionojë, të të edukojë dhe të të frymëzojë për të sotmen e pér të ardhmen. Rritja e cilësisë në artet është një kërkesë që vjen nga rritja e nivelit kulturor dhe e shijeve estetike të mësime të gjëra punonjëse, nga kushtet e sotme të zhvillimit të shoqërisë sonë»

ENVER HOXHA

1. Të rritim kërkesat ndaj vetvetes në radhë të parë dhe pastaj edhe ndaj të tjerëve

Mënyra si ekspozohën veprat nuk është një punë krejt e thjeshtë dhe pa rëndësi. Është e drejtë që në ndërtimin e një ekspozite të artit realist do të nisemi nga kriteri tematik, nga idetë dhe përmbytja e veprave dhe jo vetëm nga vlera artistike e tyre, por kjo nuk do të thotë se niveli artistik

i veprave dhe kriteri artistik i renditjes dhe grupimit të tyre mund të merret fare lehtë nëpër këmbë, ashtu siç kanë bërë organizuesit e ekspozitës jubilare të nëntorit 1986, celur në Galerinë e Arteve. Edhe spektatori më zemërgjerë e ka vështirë t'i sjellë në harmoni përshtypjet e tij. Pranë një pune me mjeshteri të vërtetë qëndron një punë diletanti, pranë një vepre të fryshtuar qëndron një hallturë zanatciu. Një përzierje e tillë ua ul vlerën dhe atyre arritjeve reale që ka ekspozita.

Është e drejtë që spektatori të kërkojë nga autorët e shquar, si dhe nga vetë ata që bëjnë pjesë në komisionet e pranimeve, që kërkesa e tyre pér cilësi të fillojë nga vetvetja.

P.sh. në sallën kryesore, në një vend qëndror, janë ekspozuar tre punime mediokre dhe një mesatar i Zahir Matit, (megjithë tablonë e përmesave të mëdha, të vendosurë në vendin më të dukshëm të katit të dytë, i bëhen pesë). Mediokriteti i këtyre punëve të këtij autori qëndron në ftohtësinë e qëndrimit të piktorit ndaj natyrës, modelit, motivit të zgjedhur, nga lehtësia dhe cektësia artizanale, me të cilën ky autor i trajton një pjesë të temave të tij.

Kjo zemërgjërsë e paspjegueshme me vetveten, ndërkokë që mbeten jashtë ekspozitës autorë të ndryshëm ndofta dhe pér mungesë vendi, nuk bën përshtypje të mirë. Duke bërë lëshime të tillë në kurriz të të tjerëve, kërkesat pér cilësi zhvlefësohen mjaft në sytë e masës së gjërë të artisteve dhe mund të mos sjellin frutet e dëshiruara.

2. Kompozimi i Agim Shemit dhe piktura e thjeshtë tregimtare

Kur një vepër arti e pëlqejnë vetëm një pjesë e spektatorëve, specialistët mund të kenë arsyet tē mos e pëlqejnë. Po kur një vepër arti e pëlqejnë gjithë spektatorët pa përjashtim, si ata që nuk kanë ndonjë shkollë tē madhe dhe ata që kanë, atëherë nuk ka asnjë arsyet që specialistët tē mos e pëlqejnë.

Më duket se kritikat në shtyp ndaj tablosë së vogël të Agim Shemit «U lage, o gjyshi?», kanë tē bëjnë me një keqkuptim. Qëllimi i artistit, kur bën një vepër arti, është t'u bëjë tē ditur tē tjerëve në mënyrë emocionale dhe estetike një idë tij. A niset pér këtë ide nga një subjekt anekdotik, nga një subjekt lirik, nga një subjekt dramatik, apo nga një subjekt heroik, kjo është punë pér tē. Ajo që ka rëndësi është nëse subjekti i zgjedhur është vërtet i përshtatshëm apo nuk është pér ta shprehur me ndjenjë tē vërtetë dhe me qartësi atë ide. Nga kjo pikpamje Agim Shami, te kjo pikturë e vogël dyfigurëshe, ia ka arritur qëllimit. Subjekti i veprës është vërtetë më i ri, se mund tē jesh i ri në moshë dhe i vjetër në atë që bën. P.sh.. Besim Golemi bën një pikturë më tē vjetër nga Petro Kokushta, ndonëse është më i ri në moshë. Vildan Jahia bën në këtë ekspozitë një skulpturë më tē vjetër nga Thoma Dhamo, ndonëse është më i ri etj. Fjalët «e vjetër» dhe «e re» në art nuk janë fare pa kuptim, se cdo kohë ka gjuhën e saj, kështu që me mjetet shprehëse tē nië kohe tē shkuar nuk mund tē jepen si duhet shndërrimet e reja në jetë dhe në psikologjinë e nierëzve tē kohës së socializmit. Spektatori pret nga tē rinjtë t'i zhulojnë me gjuhë tē përshtatshme dhe tē kuptueshme pér tē aspektet tē reja tē realitetit tē panjohura në art.

3. «Studentët» e Danish Jukniut

Siq duket nga diskutimet në shtyp dhe në mjediset krijuese pér tablonë e Danish Jukniut, mendimet janë tē ndryshme, madje dhe tepër tē ndryshme. Nuk dua ta marr në mbrojtje këtë tablonë si vepër tē përsosur, Të meta mund t'i gjesh blo si vepër tē përsosur, Të meta mund t'i gjesh cdo vepre në ekspozitë, dhe kjo është e kuptueshme.

me, por piktura «Studentët» është, pa dyshim, një nga më të arriturat dhe më interesantet. Dhe më duket logjike. Autori i saj është nga ata tē paktët që pér një kohë mjaft tē gjatë i ka ruajtur kërkesat e larta ndaj vetes.

Natyrisht, vlerësimin e drejtë ndaj pikturës së Danish Jukniut, konkretisht pér këtë vepër, si dhe në përgjithësi, mund ta bëjmë duke u nisur nga tipare tē tilla tē shquara tē realizmit socialist në art, si zhvillimi i pandalur dialektik, uniteti i vërbmbajtjes me formën dhe novatorizmi. Ndërsa kërkesat pér thellim psikologjik dhe pér skalitjen e karaktereve tē personazheve, duke mbetur në thelb tē dreita, zhvleftësohen mjaft kur shikohen jashtë natyrës së autorit, tē cilit i drejtohen.

4. A janë gjithë tē rinjtë tē rinj?

Kur vlerësojmë tē rinitë në një ekspozitë, nuk miafton vetëm datëlindja e tyre. Përveç moshës së re, duhet tē përpinqesh tē jesh i ri edhe në venër, se mund tē jesh i ri në moshë dhe i vjetër në atë që bën. P.sh.. Besim Golemi bën një pikturë më tē vjetër nga Petro Kokushta, ndonëse është më i ri në moshë. Vildan Jahia bën në këtë ekspozitë një skulpturë më tē vjetër nga Thoma Dhamo, ndonëse është më i ri etj. Fjalët «e vjetër» dhe «e re» në art nuk janë fare pa kuptim, se cdo kohë ka gjuhën e saj, kështu që me mjetet shprehëse tē nië kohe tē shkuar nuk mund tē jepen si duhet shndërrimet e reja në jetë dhe në psikologjinë e nierëzve tē kohës së socializmit. Spektatori pret nga tē rinjtë t'i zhulojnë me gjuhë tē përshtatshme dhe tē kuptueshme pér tē aspektet tē reja tē realitetit tē panjohura në art.

Spektatori pret nga tē rinjtë edhe këtë: që tē

gjiejë në punët e tyre të paktën shenjat e personaliteteve të ardhshme të artit tonë. Mirëpo kjo si do të ndodhë në qoftë se të rinjtë tanë nuk çlrohen nga psikologjia prej studenti edhe atëherë kur u afrohen të dyzëtave? Kush e ka fajin për këtë? Ndoshta, jo vetëm të rinjtë!

5. Me gjuhën e artit, apo me gjuhën e rutinës?

Si dhe në ekspozita të tjera, edhe në këtë të viti 1986, në raste të ndrvshme gjuha e rutinës zevendëson gjuhën e artit. Punë të tillë si «Shkriresi» i Zef Shoshit, cikli grafik i Mina Zakës, «Qyteti më i dashur» i Jani Guxos, «Krenari» e Lumturi Blloshmit, «Shkrirja e celikut» e Andon Lakuricit overojnë me gjëra të thëna e të stërtthëna. Le të marrim një shembull, që nuk është më i dobëti, por tipik dhe i realizuar nga një autor me përvoië të gjatë dhe me emër: tablonë «Në kovachanë» të Clirim Cekës.

Kjo tablo, në këtë ekspozitë kombëtare, është pikërisht nga ato vepra që nuk shkëlqejnë, por që as dhe nuk bëhen objekt vëreitiesh kritike. Para veprave si kjo spektatori qëndron dhe çuditet. Eksnozitën e sheh për herë të parë, ndërsa punën i duket sikur e ka parë! Jo, nuk 'e ka parë, por këtë lloj «frymëzimi» e ka hasur kushedi se sa herë në pikturë, në skulpturë, në grafikë. Kur rri dhe e shikon si zanat, s'ke ç'i thua, gjithçka në rregull: tema-kardinale, kompozimi — në rregull, dritë ka, ngjyrat — dekorative, të mbajtura, të pjekura. Megjithatë, asgjë nuk të tërheq, po të mos llogaritim një copë të madhe të kuqe në por-

tokalli që ndodhet në gjysmën e majtë të sipërfaqes dhe që s'është veçse një copë hekur i madh, i skuqur, që tre kovaçët e kanë mbërthyer në një darë mjaft të gjatë. Dhe kompozimi që këtej nis, të tre personazhet vendosen njëri-pas tjetrit, të kapur pas bishtave të darës. Këtu nis dhe e keqja, jo vetëm që vendosja në një plan, në radhë, e tri personazheve e bën kompozimin të mërzitshëm, por ajo e detyron autorin ta zgjatë telajon në një format aspak të bukur. I gjithë ky katërkëndësh i stërgjatë rrëth 2.5 m mbahet vetëm me atë copë hekur të skuqur, sikur të ishte një çudi e madhe. Personazhet, siç thamë, janë tre dhe, për të na dhënë përshtypjen e një tensioni sa më të madh, piktori i vizaton të anuar andej-këtej, në tri drejtime, që formojnë një trëkëndësh, por me këmbët që mbarojnë thuajse në një pikë, duke, e kthyer trekëndëshin, më në fund, në një piramidë, por me kulmin në dysheme dhe me bazën përpjetë. Përse? Çfarë kërkon të japë me këtë? Kështu, padashur, autor i ka zhvlejtësuar plotësisht atë linjë dinamike, qoftë edhe jo fort të zgjedhur e të hollë, që ka dashur t'i japë që nënisje kompozimit të tij. Në këtë mënyrë, forca tërheqëse që niset nga pesha e rendë e hékurit të skuqur të vendosur mbi kudhër, shpérndahet në tri rezultante që asgjësojnë njëra-tjetrën, dhe e kthejnë tërë këtë vrull fillestar në një pikë të vdekur. Pra, më kompozimin autor i tablosë «Në kovachanë» nuk është në gjendje të arrijë asgjë. Por me çfarë tjetër, mos ndoshta me karakteret e personazheve? Asgjë të tillë s'kemi këtu, as përpjekjen më të vogël për individualizim të personazheve, jo vetëm në fytyrat, por as të paktën me disa karakteristika trupore, ose me gjestet e tyre. Ata që të tre janë identikë, ose, më saktë, janë e njëjtë figurë, por e vendosur në tri lëvizje të ndryshme.

Ekzistojnë dhe dy mundësi të tjera për ta zërthyer përbajtjen dhe për të komunikuar me spektatorin në një mjedis kovaçhanë të një uzine të madhe: gjuha e toneve, e dritë-hijes, si dhe ajo e ngjyrës. Por që të dy këto mundësi në realizimin e tablosë «Në kovaçhanë» kanë vajtur dëm, se nuk janë përdorur. Ngjyra është ndërtuar në një dozë të caktuar realizmi, në qoftë se me realizëm kuptojmë regjistrimin e thatë të një pamjeje reale ose me një dozë të caktuar indiferentizmi, në qoftë se realizmi është, ashtu siç mendojmë, një konvertim ideoemocional subjektiv i realitetit objektiv.

Tonet e tablosë në fjalë janë ndërtuar në mënyrë logjike, por të rëndomtë, kështu që nuk luajnë asnje roli, nuk të bëjnë asnje përshtypje.

Shuma e përgjithshme e një konceptimi dhe e një realizimi të tillë artistik, si ajo te tabloja «Në kovaçhanë», është pashmangshmërisht ftohtësia dhe mungesa e shprehjes artistike. Pikërisht e piktorit Clirim Ceka është tabloja e realizuar vite më parë, në përmasa gjithashtu jo të vogla, që tregon një çast nga derdhja e metalit të shkrirë në fonderi. E piktuuar me ngjyra të lehta, gjysmë të lëngshme, me kontraste të freskëta të shumë të ngrohtës dhe shumë të ftohtës, ajo tablo është një shembull i mirë, që tregon mundësinë e autorit për të folur me gjuhën e artit, duke iu shmanqur në çdo rast gjuhës së rutinës. Piktori dhe grafisti me përvojë, autori i tablosë «Në kovaçhanë» ka nё krijimtarinë e tij arritje të mira për të qëndruar përherë në lartësinë e duhur.

6. Frymëzimi i vërtetë dhe llogaritë skematike

Dashuria e vërtetë nuk është çështje moshe, por kur bashkohen rinia me dashurinë, edhe vetë

natyra ngazëllohet. A ka temë më të lumtur, dhe më të këndshme nga dashuria ndërmjet dy të rinjve? Me siguri edhe skulptori Stefan Papamihali, autori i gdhendjes në dru «Të rintjtë», ka të njëtin mendim. Dhe është një gdhendës i talentuar, autor veprash të njoitura, që kanë zënë vend të merituar në Galerinë Kombëtare. Ai ka zgjedhur për temë të veprës së tij të re pikërisht dashurinë, ndonëse titulli që i vë skulpturës mbetet fare i përgjithshëm.

Një spektator i ri në moshë, që ende nuk e ka parë këtë vepër, mund të bëhet kureshtar. Nga vetë tema që skulptori ka zgjedhur, dashuria ndërmjet dy të rinjve spektatori ka të drejtë të krijojë në imaginatë një përfytyrim të tjin, të bazuar, logjik. Do të marrë me mend se për një temë të tillë skulptori do të ketë zgjedhur, natyrisht, më të bardhin dru që mund të bëhet, p.sh. panjën, tipat, më të këndshëm dhe format më të buta të modelimit. Mirëpo, jo! Skulptori ka zgjedhur një dru kafë të errët, cifti ka dalë mjaft i mërzitur dhe i mërzitshëm; madje gjendja ndërmjet tyre nuk mund të quhet aspak e lumtur. Çështë e vërteta, djali sikur bën një përpjekje për të buzëqeshur, por ngaqë buzëqeshjen nuk e shoqërojnë as sytë dheasnje muskul i fytyrës, kjo e shëmton mjaft. Ndoshta kjo ndodh sepse vajza as që ka ndër mend të buzëqeshë.

Po tipat? Fytyra e djalit është fytyra klishe e punëtorit, që i serviret prej kohësh spektatorit nga disa vepra të skulpturës dhe të pikturës sonë, dhe, çështë e vërteta, edhe nga ca filma të kinostudios: nofullat 90 gradë, hunda e shtypur, balli i kërcyer. Gjendja e tij shpirtërore? Ajo e një punëtori klishe: e vrenjtur, e rëndë, jo sikur ka përparrë vajzën që dashuron, po të themi, inxhinerin injorante, që e pengon të realizojë shpikjen e tij tekniko-shkencore.

Kur modeloi dashurinë Rodeni i madh, zgjodhi jo vetëm mermerin më të pastër, por edhe format më të buta. Ai e rrithoi puthjen e të dashuruarve me një butësi të tillë të daltës dhe të dorës, saqë, pa pasur asnjë mundësi velaturash nga ato të pikturës, arriti, për çudi, t'i hedhë përsipër imazhit të kësaj shfaqjeje sublime të zemrave njerëzore edhe një vello të bardhë, të tejdukshme, që e ndien, po nuk e gjen dot ku është.

Kur modelon dashurinë me penelatat e tij vibruuese, mjeshtri ynë Abdurrahim Buza zgjedh ngjyrat më të qarta, më të embla dhe më të gjalla. Aty pranë deti kaltëron, qielli kthehet në rozë, gjithçka këndon dhe lulëzon, konturet zbuten dhe humbasin pushtetin e tyre, duke iu bindur kalimëve të buta të formës dhe gërshtimit të volumeve. Gjithçka kthehet në drithë dhe ngjyrë. Gëzimi dhe lumturia pëershkon çdo ind të kuadrit të tij, ndonëse veprat janë të realizuara kur mjeshtëri ishte 80 vjeç.

Kur i jepemi një subjekti, duhet t'i jepemi plotësisht, përndryshe pushteti që duam të ushtrojmë mbi spektatorin, na shpëton nga duart, ashtu siç na shpëton subjekti vetë. Llogaritë skematike nuk vlejnë fare kur krijojmë një vepër arti, ashtu siç nuk vlejnë llogaritë praktike kur dashurojmë. Në qoftë se nisim të bëjmë llogari, do të thotë se nuk e duam më me zjarrin e parë, ashtu siç ndodh kur nisim t'u bëjmë lëshime skemave, klishevë, paragjykimeve skematike, i japim lantumirën frymëzimit tonë.

7. Kompozimi i veprës dhe tabloja kompozicionale

Cilat janë gjinitë dhe format që e bëjnë një ekspozitë të jetë tërheqëse? Janë, në radhë të

parë, tabloja kompozicionale, statujat, portretet në pikture. Të gjitha këto lidhen edhe me përmasat e telajove e të skulpturave. Punët e përmasseve të mëdha, që të imponohen me cilësitë e tyre, janë kaq pak në këtë ekspozitë, saqë përbëjnë përjashtim. Tablotë kompozicionale më të arritura janë të përmasave jo të mëdha. Kjo dukuri e zvogëlimit të përmasave është, sigurisht, pozitive. Piktura në radhë të parë bëhet për mjedise normale, ku jetojnë njerëzit përditë. Piktura e kavalletit, në veçanti, nuk i duron përmasat e mëdha. Është arti monumental ai që merr përsipër të dekorojë sipërfaqet dhe hapësirat e gjëra të sallave dhe mjediseve publike. Kështu, ky kthim te formatet e vogla, që është vënë re vitet e fundit, përbën një afrim më të dukshëm të pikturës dhe të skulpturës te spektatori i thjeshtë, një demokratizim të mëtejshëm të artit vetë. Është një kthim drejt formave që përdornin edhe piktorët tanë më të mirë të traditës, Idromenoja, Kolombi, Mioja, Buza etj. Një kthim i tillë do të ndikojë me siquri mbi cilësinë. Në qoftë se Kilica do ta kishte piktuar tablonë «Në studio» në formatin, p.sh., të «Shpalljes së Republikës», ajo nuk do të kishte ato vlera që ka. E njëjtë gjë mund të thuhet edhe për pionierin e Kristaq Ramës etj. Nga ekspozitat e kaluara mund të rikujtojmë «Portretin e shokut Enver Hoxha» të Myrteza Fushekait, që është në format fare të vogël dhe megjithatë mbetet një nga portretet më të mira që i janë bërë shokut Enver në pikturë deri më sot.

Sic thamë, efekt të veçantë bëjnë në një ekspozitë tablotë kompozicionale, me subjektin, me ngjarjen që tregojnë, gjë që nuk ka mundësi ta bëjë një portret a një peisazh. Së dyti, me grupimin e figurave, me lëvizjet e tyre dhe kundërvëniej e elementeve, me tipat etj. Historia e artit të

realizmit socialist tregon pér rolin që ka luajtur tabloja kompozicionale në afirmimin e tij si metodë krijuese dhe në zhvillimin e mëtejshëm. Por duhet thënë se tabloja kompozicionale te ne po kalon një periudhë shterpësie. Pse?

Mua më duket se janë të paktën dy shkaqe që shpjegojnë prapambetjen e dukshme të saj. Së pari, varfëria e shikimit të artistëve. Vitet e fundit është vënë re paaftësia e autorëve pér të gjetur subjekte interesante, të reja, me ngarkesën e duhur ideoemocionale. Vështrimi i artistit nuk është në gjendje të zbulojë motive të reja jetësore në jetën e ditëve tona, ndaj i drejtuhet ose së kaluarës (shumë të largët), ose skemave. Këtë dukuri negative e rëndon mjaft edhe përdorimi në praktikën e disa piktorëve i fotografisë, qoftë pér figurat, qoftë pér mjediset ku veprojnë personazhet. Përdorimi i fotografisë është vërtet i palejueshëm dhe dëshmon vetëm pér një gjë: pér pasigurinë ose paaftësinë në vizatim.

Shkaku i dytë, i rëndësishëm, i vështirësive që po kalon tabloja kompozicionale, është prapambetja e gjuhës me të cilën vazhdon të flasë ajo. Tabloja kompozicionale, në konceptimin e saj, ka mbetur skllave e disa ligjeve kompozicionale, që me kohë u kthyen në skema të ngurta dhe që po praktikohen nga mjaft autorë me një disiplinë gati shkollore. Përpjekjet që bënin disa piktorë me përvojë, si Kilica, Jukniu, Shijaku, Haxhiu etj. patën disa rezultate të bujshme në vitet 70, por sot ato nuk e kanë më atë sukses që kishin atëherë. Dhe është dialektike, në njëzet vjet ne kemi lëvizur nga vendi malet, ndërsa konceptin mbi mënyrën e kompozimit të një tabloje nuk e lëvizim dot. Është një gjë që Abdurrahim Buza e bënte fare thjesht: «Syrin gjithmonë në shenjëstër», si dhe shumë «bocete» në miniaturë, të punuara me akuarel, pastel etj. Mos do të thotë kjo se pér ta

gjallëuar dhe pér ta shpënë më përparrë tablonë kompozicionale mund të mbështetemi thjesht mbi krijimtarinë e Buzës dhe problemi është i zgjidhur? Aspak. Buza ishte piktor i një strukture tjeter dhe tabloja, si gjini, nuk ishte veçse një nga mundësítë e shumta shprehëse që ekspozonte ky artist origjinal.

Buza lindi dhe u formua në një kohë tjeter dhe krijimtaria e tij përfaqëson një epokë të caktuar. Mbi krijimtarinë e tij janë mbështetur shumë herë pikërisht më të talentuarit e brezave të mëvonshëm dhe brezat e rinj do të kenë përherë se q'të marrin nga Abdurrahim Buza, por shembulli i mësipërm është interesant në një kuptim tjeter. Mësimi që na jep Buza është se nuk ia vlen të ndjekim rregullat e kompozimit që ne vetë i kemi formuluar në praktikën tonë të përditshme, ose që i kemi marrë të gatshme nga të tjerët, kur ideja që dëshirojmë të shprehim dhe frymëzimi i vërtetë i sheh këto rregulla si pengesë. Çfarë bën Buza te kjo tablo e vogël dyfigurëshe? Një gjë fare të vogël: gruaja malësore shtie pushkë në profil, 3/4 e kthyer nga ne, ndërsa pashai që këputet nga kali, qëndron në një drejtim tjeter, me një shmangje rrëth 90 gradësh. Kjo shmangje ka thjeshtësinë e vezës së Kolombit, por askush nuk e gjeti të nevojshme ta pyeste mjeshtrin plak se përsë i dhunoi ligjet e perspektivës ajrore. Dhe nuk kishte pse ta pyeste pa u bërë kritizer. Si spektatori, ashtu dhe specialistët e kuptuan fare mirë idenë e Buzës, sido që ajo qe shprehur në mënyrë të pazakontë pér rregullat e kompozimit të praktikuara nga piktorët tanë dhe të mësuara në shkollë. Artistët që udhëhiqen në të tilla «sakrilegje» të formës artistike nga domosdoshmëria dhe jo nga pozat boshe, spektatori inteligjent i kupton fare mirë dhe drejt. Auto-

rët e tablove kompozicionale, si dhe të disa gjinive të tjera të artit figurativ, mund të mbështeteshin më tepër mbi inteligjencën e zhvilluar dhe shkallën e lartë të edukatës estetike që karakterizon sot spektatorin shqiptar të një eksponente arti. Vetëm me një punë të vazhdueshme këmbëngulëse duke përdorur forma e mjete shprehjeje origjinale do të mund të zgjidhim ato probleme që kanë dalë aktualisht në pikturen tonë, zgjedhja e të cilave do ta nxirrte tablonë kompozicionale në rrugën e zhvillimit të gjerë e të pandalur, duke e nxjerrë përfundimisht atë (dhe jo vetëm atë) edhe nga praktikat e ilustrimit të thjeshtë, ose nga fryma pllakatike, në të cilën ndodhet një pjesë e mirë e krijimtarisë sonë.

R A F A E L I

Piktura e bukurisë plastike ka gjetur shprehjen e saj më të plotë në atë që njihet sot si klasizmi në art. Përfaqësuesi më i denjë i klasizmit në pikture është pa dyshim Rafaeli.

Çështë pikturna e bukurisë plastike?

Është ajo pikture që ndërtohet kryesisht mbi bukurinë e përkryer plastike të trupave njerëzore, të gjymtyrëve të përsosura, të tipareve të përsosura femërore dhe mashkullore, të raporteve të përsosura ndërmjet figurave dhe mjedisit gjithashtu përsosmërisht të përshtatur. Kështu, në pikturen e klasizmit vendi i parë i lihet vizatimit dhe kompozimit, d.m.th. anës fizike dhe plastike, ndërsa ngjyra dhe psikologjia e personazheve kalojnë në shkallë të dytë. Kaq është e vërtetë kjo, saqë, edhe kur një piktor klasicist ka qëlluar të jetë koloristi madh, si Ticiani, nuk ka mundur ta përblysë këtë raport. Është e kuptueshme që klasizmi del në këtë mënyrë si antipod i pikturnës bizantine, e cila, e frymëzuar nga feja kristiane, e përqendronte gjithë vëmendjen dhe forcën e saj shprehëse te psikologjia dhe bota shpirtërore e personazheve, duke përbuzur trupin dhe sendet materiale.

Materializmi dhe humanizmi rilindës i Rafaelit, sikurse edhe ai i bashkëkohësve të tij gjenialë, e zbriti qielin në tokë, i mbushi palat dhe vezullimet dekorative të ikonave e afreskeve të mesjetës me trupa njerëzorë, e mbushi shpirtin e thatë asketik të apostujve me gjëzimin e jetës dhe rrähjet e zemrës njerëzore, u dha jetë dhe ngrohtësi njerëzore vështrimëve enigmatike përtejnjjerëzore të heronjve të pikturës mesjetare. Afresket e «Stancave» të Rafaelit, si dhe të brendia e sallës në Vatikan, e përpunuar dhe e shndërruar nga dora e tij gjeniale në një tërësi të mahnitshme arkitekturore-piktore monumendale, janë një apoteozë mahnitëse, një himn entuziast ndaj jetës dhe qenësisë njerëzore, ndaj mundësive të pashtershme njerëzore, ndaj bukurisë së jashtëzakonshme dhe të gjithashme të trupit e të shpirtit njerëzor.

Heronjtë e Rafaelit, personazhet e afreskeve, të tablove e të vizatimeve të tij janë që të gjithë njerëz të mirë, siç ishte ai vëtë, një djalë i thjeshtë i ardhur nga Urbinoja provinciale, i qeshur, i dashur e që mbeti i tillë edhe pasi u kthye në një hero të vërtetë të jetës artistike të Firences, e të Romës së fillimit të shekullit të 16-të. Heronjtë e Rafaelit janë që të gjithë njerëz të mirë, edhe modeli më i lig e më i poshtër shndërrrohej nën pushtetin e magjisë së vizatimit e të piktureve së tij në njeri të mirë, sepse shndërrrohej vetiu prej dorës fisnike të tij. Kur mundohet të paraqesë në pikture njerëz e karaktere të ashpër e të ligj, Rafaeli e ka vështirë, Ata i dalin të sforcuar dhe jo bindës. Inati i tij i ngjan inatit të fëmijëve, të cilët s'mbajnë dot inat. Grotesku mund të qe e vetmja mënyrë për ta kaluar këtë pengesë të natyrës së tij, por Rafaeli nuk e zotëronte vështrimin e pakomprometueshmët të Leonardos dhe nuk e ndi-

ente forcën shpërthyese të shpirtit kryengritës të Mikelanxhelos. Për të njeriu ishte vetëm i bukur dhe jetë njerëzore një mrekulli. Rafaeli mund ta shihte botën vetëm me dashuri dhe ndërmjet punëve të tij quditërisht të shumta, të realizuara më tepër nga nxënësit sesa nga ai vetë, thesaret e vërteta rafaeliane janë vetëm ato që kanë dalë nga kjo dashuri e tij e mrekullueshme pér botën dhe njerëzit dhe jo nga Rafaeli i lodhur e i zhgënjenyer i viteve të fundit.

Rafael Santi jetoi vetëm 37 vjet. Mund të genë edhe shumë për një poet, por fare pak për një piktor si ai. Piktura ka shumë zanat dhe zotërimi i saj kërkon kohë. Kur mbushte 98 vjec, Ticiani pshëherëtinte për jetën që po e linte tamam në castin kur apo niste ta kuptonte pikturën e vërtetë. Veprat më të mrekullueshme e më novatore Rembrandti i krijoj në pleqëri.

Si veproi konkretisht Rafaeli për ato ndërri-
me që realizoi vizatimi dhe piktura në Rilindjen e
Lartë dhe që i hapën rrugën klasicizmit në artin e
pikturës e të vizatimit?

Rafaeli dhe artistët e tjera të rilindjes umbështetën te lashtësia klasike e artit, ashtu siç umbështet mendimi filozofik i rilindjes tek Aristoteli dhe Platon. Por nuk mund të thuhet se pikatura e rilindjes mësoi nga pikatura e Greqisë së lashtë që e Romës. Kishin kaluar kaq shekuj dhe kishin rrjedhur kaq ngjyra. Ndjenja piktorike e autorëve të rilindjes ishte zhvilluar shumë. Ativ kishin ndikuar deri dhe autorët flamandë. Ndaj pikatura e Greqisë së lashtë dhe e pasuesve të tyre ishte thjesht e thatë, e ashpër dhe e rëndë, e ngathët për fantazinë e artistëve të rilindjes. Ata zgjodhën skulpturën e lashtësisë klasike, pikërisht atë art madhështor që përputhej me ndjenjën e tyre të mrekullisë plastike. Bukurinë plastike e

gjejmë edhe në konturet dhe linjat e vizatimeve dëkoracioneve greke, delikatesën dhe ndjenjën e butë të hapësirës e gjejmë edhe te piktura e vjetër japoneze, rrumbullakësinë e formave vëllimore e gjejmë edhe te skulpturat e tempujve indianë, por atë përpjekje të përgjithshme të artistit për ta zotëruar në mënyrë të plotë plastikën e figurës së njeriut siç e dëshironin artistët e rilindjes, e gjejmë vetëm te Fidia dhe Praksiteli.

Ku do të vepronë ky personazh me trup të përsosur, ku do të hidhte ai hapin dhe në ç'drejtëm do të fluturonte ndjenja e tij e lirisë? Mos do të ndrydhej në planet vertikale paralele si tek autorët bizantinë? Apo do të thahej e mpihej në një rrafsh të vetëm, duke ndërruar vetëm 'madhësinë trupore' duke mbetur qesharak si te piktura e Egjiptit të lashtë? Ajo që nuk ishte aspak qesharake, por hyjnore, e repte dhe e madhërishme për skllevërit e kohës së faraonëve, kthehei në qesharake, në të pabetesueshme dhe të mjerë në kohën e Leonardo da Vinçit. Foshnjëria e njerëzimit kishte marrë fund me kohë. Njeriu kërkonte diie të sakta. Xhordano Brunon e dogji kisha, por drithën që ndricoi mendjen njerëzore nuk e ndaloj dot të përhanei. Leonardoja dhe Mikelanxhelia fshehurazi kishës, hapnin trupat e njerëzve të vdekur për të njojur anatominë dhe për të mos e ndërtuar figurën e njeriut me hamendje. Një shkencë e re lindi, perspektiva. Ajo lidhej ngushtë me hovin që morën ndërtimet në kohën e rilindjes, me lulëzimin e qyteteve. Kërkesa për ndërtimë të reja e të bukuria i dha hov arkitekturës. Këtii arti të mrekullueshëm, ku bashkohet organikisht ndjenja utilitarë me ndjenjën estetike, ku çdo gjë që është e bukur duhet të shërbejë përdicë, dhe çdo gjë që shërben, duhet të jetë patjetër e bukur. Arkitektura zuri me të drejtë ven-

din pararojë në atë zhvillim madhështor që paten artet në rilindje. Në qoftë se mund ta përcaktojmë ndjenjën estetike të krijuesve të rilindjes, atë ndjenjë të epërme që udhëhoqi gjithë atë forcë gjigante krijuese të artit të kësaj epoke, kjo ishte ndjenja e arkitekturës. Piktoret dhe skulptoret e rilindjes e kishin për nder dhe e quanin përdetyrë të merreshin edhe me arkitekturë.

Kjo ndjenjë e arkitekturës hyri thellë në ndërgjegjen e piktorëve të rilindjes dhe e organizoi rrënjosht përfytyrimin artistik. Piktori i rilindjes e fillonte tablonë e tij me një ndjenjë të fortë arkitekturore. Gjithçka i bindej ndërtimit dhe modelimit arkitekturor, edhe kur ishte fjala për një portret të thjeshtë.

Dihet që arti nuk flet me gjuhën e rregullave shkencore, teknike, me gjuhën e perspektivës e të anatomisë artistike. Arti flet me gjuhën e së bukurës dhe, në qoftë se nga gjithë piktorët e rilindjes mund të zgjedhim një për atë bukuri të lartë plastike që mund të japë vetëm piktura, ky është Rafaeli. Ai mbetet ndoshta deri sot gjeni emblematik i ndjenjës italiane të bukurisë plastike në pikturë, i asaj bukurie të qartë dhe elegante që shprehin vargjet e Dantes ose muzika e Verdit.

Gjer dhe një gjeni verior kaq i kundërt me Rafaelin si Rembrandti, i cili njihet si kundërshtar i deklaruar i mënyrës rafaeliane, ka bërë një autoportret nën ndikimin e «Kontit Kastilione» të Rafaelit. Që nga largësia e shekullit të 19-të Engri, i cili ishte edhe vetë vizuates gjenial, e shpalte Rafaelin mësuesin e tij dhe shprehte keqardhjen e singertë që nuk kishte lindur më parë, që mësimet t'i merrte drejtpërdrejt nga Rafaeli dhe jo nëpërmjet veprës së tij. Pas Engrit i erdhë radha Rënuarit, këtij liriku gjenial, që të habitej e të tronditej nga thjeshtësia me të cilën kryemjeshtri

nga Urbinoja arrinte të bënte atë që atij i qe dukur e paarritshme. Ishte pikërisht përshtypja e veprës së Rafaelit që u dha goditjet e fundit idealeve impresioniste të Rënuarit dhe që e shkëputi plotësisht nga eksperimentet e rinisë.

Rafaeli nuk hapi rrugë të reja në art, siç bënë Leonardi dhe Mikelanxheloa, ai hapi rrugë të reja në ndjeshmërinë artistike, në shijen për të bukurën. Bukuria e figurave të Rafaelit nuk është bukuri e trilluar «hyjnore». Ajo është zbuluar dhe rrëmbyer nga tiparet e gjalla të fëmijëve, të vajzave, të grave dhe djemve të rinj fiorentinë dhe romanë. Atë që shumë piktorë të mesjetës e kërkonin në qzell, Rafaeli e gjente në tokë, në tokën e Italisë së tij.

Dëlirësia dhe harmonia e përsosur e trupit, e mendjes dhe e shpirtit janë zbulimet e mëdha të Rafaelit.

Rafaeli u formua dhe e krijoj veprën e tij i ndodhur në mes të dy titanëve të tjerë të rilindjes, të Leonardo da Vinçit dhe Mikelanxhelo Buonarrotit. Leonardi qe i butë, por i mbyllur në botën e tij prej shkencëtarë. Mikelanxheloa ishte i rrëmbyer, inatqi dhe dyshues. Rafaeli ishte krejt ndryshe. I qeshur, komunikues, atë e gjeje për herë të rrethuar nga shokët, miqtë dhe adhuruesit e tij. E donin të gjithë. Profili i tij njerëzor përputhet plotësisht me humanizmin e jashtëzakonshëm dhe butësinë e artit të tij. Me talentin e tij gjenial Rafaeli i ri arriti të afirmojë personalitetin e tij ndërmjet dy poleve që dukeshin si të përjashtueshme: butësisë hermetike të Leonardos dhe patosit heroik të Mikelanxhelos. Përkrahja e bashkëfshatarit të tij të gjithëpushtetshëm, kryearkitektit të papës Bramante, mund t'i ketë siguruar njohje të shpejtë dhe porosi të rëndësishme, po, kur merr penelin dhe vihesh përballë

sipërfqajes së bardhë, nuk të ndihmon dot asnjë Bramante. Rafaeli nuk u step për asnjë çast. Natura e tij e mbarë dhe gjerësia e vështrimit i dhanë mundësi për ta zgjidhur thjesht problemin. Ai ndoqi pa ngurruar rrugën e Leonardos, duke futur në të njëjtën kohë frymën madhështore të Mikelanxhelos. Pa u trembur nga imitimi, ai bëri një simbiozë, e cila fitoi në duart e tij një jetë të re, fitoi atë butësi dhe harmoni që mund ta zbulonte te realiteti vetëm syri i Rafaelit.

As Leonardoja, as Mikelanxheloa dhe as Rafaeli nuk ishin koloristë të lindur, siç qenë Ticiani dhe Veroneze. Këtu s'ka asgjë për t'u çuditur.

Sa shpesh rrinë pranë e pranë madhështia e vizatimit me mediokritetin e ngjyrës! Dhe kjo as që vihet re. Njerëz guximtarë të mëdhenj në vizatim, mezi bëlbëzojnë nga frika në ngjyrë.

Te Rafaeli, sikurse te Leonardoja, nuk është ngjyra ajo që thotë gjithçka. Megjithatë duhet pasur parasysh se në tablotë dhe në afresket e tyre thjeshtësia e madhe e ngjyrimit i nënshtrohet një disipline të lartë poetike, dhe është zbatuar pérherë me gjenialitet.

Piktura e Rafaelit flet me gjuhën e vizatimit, të shkallëzimeve tonale, të butësisë së ndriçimit, të muzikalitetit plastik.

Arti i rilindjes ishte një reaksion i fortë kundër palëvizshmërisë së pikturës së mesjetës. Piktoret e mesjetës kufizonin lëvizjen në dobi të një thellimi psikologjik dhe shpirtëror në zberthimin e subjektit fetar. Leonardi qe ai që i dha goditjen e fundit kësaj palëvizshmërie. Te vepra e Rafaelit gjejmë një nga zhvillimet më të plota e të përsosura të lëvizjes në tablo.

Përsosmëria e ndërtimit dinamik të tablosë krijon atë përshtypje të përgjithshme të një diçkaje kalimtare, që shikuesi provon sa herë ndodhet

para kryeveprave të Rafaelit. Personazhet e tij jetojnë lëvizjen e përjetshme dhe kjo është arritur quditërish në një modelim të rreptë dhe të hollësishëm të krejt figurës. Mund të thuhet madje se Rafaeli është mjeshtër i modelimit të rreptë të lëvizjes.

Gjysmëkthesat janë vendosjet më të bukura të Rafaelit. Te picturat e tij thuajse nuk gjen figura ballore. Kështu ndodh me shumë nga mjeshtrat e mëdhenj të kompozimit. Vendosja ballore e figurave mund të jetë tek ata vetëm një rastësi. Rafaeli ishte nga ata kryemjeshtra, që zoterojnë ndjenjën e masës në ndërtimin e kompozimit dhe të lëvizjes në shkallën më të lartë.

Te pictura e Rafaelit, si te çdo mjeshtër, asgjë nuk bëhet kot e rastësish, gjithçka ngrihet gjer në shkallën e domosdoshmërisë. Në tablotë e tij çdo gjë që është e bukur dhe e mrekullueshme, është dhe e domosdoshme, sikurse ajo që është funksionale, është patjetër e bukur dhe e mrekullueshme.

Nuk janë të shumta epokat e artit ku përsosmëria e së përgjithshmes gjen zhvillime kaq organike në përsosmërinë e pjesëve dhe të hollësive. Nga «Madona Sikstina» mund të heqësh një figurë dhe ta soditësh më vete, ajo është e përsosur, mund të heqësh dy fëmijët e vegjël, ata janë të mahnitshëm, mund të shkëputësh vetë figurën e Madonës, ajo është e mrekullueshme.

Linjat e vizatimit rafaeliane karakterizohen nga melodizmi i jashtëzakonshëm dhe butësia e papërsëritshme, dhe në të njëjtën kohë burojnë shëndet dhe rini. Muzikaliteti i linjave të mjeshtrit jo vetëm nuk qëndron i shkëputur nga vëllimet, si te manieristët, por buron nga muzika 'e përgjithshme plastike e trupave dhe e veshjeve të tyre, nga melodia kompozicionale. Në këtë pikë

mund të themi se Rafaeli, duke mësuar nga mjeshtrit e lashtë klasikë, u shtoi formave të njohura vëllimore një ngrohtësi dhe ëmbëlsi që e kishte vetëm ai.

Në është artist ai që arrin të shprehë estetikisht ndjenjat e tij, atëherë gjeni është ai që i imponon epokës përfytyrimin dhe shijen e vet artistike. Rafaeli ishte i tillë. Ndikimi i tij shërbeu si ushqim dhe burim frymëzimi për breza të tërë piktorësh.

Me gjuhën e poezisë vizive Rafaeli i këndoi njeriut të lirë, përsosmërisë së tij fizike dhe shpirtërore, vendit të jashtëzakonshëm që zë njeriu në botë. Vepra e tij mbetet një nga mishërimet artistike më gjeniale të ideve të larta të humanizmit të Rilindjes së Lartë.

REMBRANDTI KLASIK DHE REMBRANDTI ANTIKLASIK

«Atë e rrëzuan, Fundi, ai nuk kishte asgjë tjetër përvç talentit».

HYGOI (për Volterin)

Rembrandti ishte nxënës i klasikëve.

Më 1631 Rembrandti 25-vjeçar largohet nga Lejdeni, vendlindja e tij, dhe shkon në Amsterdam, qytet i lulëzuar në atë periudhë mbarësie që kaloi Holanda pas fitores së revolucionit borgjez dhe luftës së popullit holandez për pavarsësi. Aty u vendos në shtëpinë e Hendrik van Ulenbrokut, tregtar veprash arti. Amsterdami qe bërë qendër botërore e tregtimit të piktureve, të stampave dhe skulpturave të mjeshtërve të artit, të ardhura aty nga të gjitha anët e Holandës dhe Evropës. Edhe Rembrandti bleu ca stampa, të cilat u bënë edhe eksponatet e para të atij koleksioni shumë të madh veprash arti që ai mblodhi gjatë jetës së tij. Ndërmjet tyre qe edhe një gravurë mjaft e mirë e «Darkës së fshehtë» të Leonardo da Vinçit. Ajo i pati bërë përshtypje të thellë; mund të shihen edhe gjurmët e shkumësit të kuq që Rembrandti ka hequr mbi të.

Shumë vonë, në pleqëri të tij, mjeshtri realizoi kryeveprën e grupportretit evropian, tablonë «Zyrtarët qeveritarë». Për ndërtimin e saj teknik dhe ritmin kompozicional të përsosur ajo është një vepër klasike. Duke u mbështetur te përshtkimi që i bën kompozimit të saj studuesi anglez i Rembrandtit Kenneth Kllarku, autori i filmit televiziv të shfaqur te ne mbi Rembrandtin, mund të admirojmë së bashku me të ndjenjën e përkver të lëvizjes te kjo tablo, ritmin e shkëlqyer dhe zhvillimin e komanduar në një mënyrë të tillë që e udhëheq me siguri shikimin tonë drejt obiectit krvesor. Një figurë e qetë në të djathë, një interval, një grup i ngjeshur në formë piramide, në të cilën dhe vetëm orientimi që formojnë strehët e kapelave, të con drejt figurës qendrore, që bën një përkulje të lehtë, por të përligjur. «Sikur shikimi i njeriut në të majtë të piramidës të drejtohei thiesht nga ne, ai do të kishte mbyllur grupin dhe do ta pengonte vështrimin tonë për të arritur te figura qendrore. Zyrtari i figurës qendrore është io vetëm më i rëndësishëm, por me qëndrimin e tij ai dëshmon për taktin e lartë «regjisorial» të Rembrandtit. Në fillim ai qe në këmbë, por mjeshtri e kuptoi shpejt se në atë qëndrim e shkënuoste prej grupit. Kompozimi i kësaj tabloje është fryt i një pune të giatë e të disiplinuar të Rembrandtit, punë që filloi e frymëzuar nga castikur ai na për herë të parë «Darkën e fshehtë» të Leonardos. Njeriu që ngrihet në anën e majtë të kompozimit, të kujton Shën Bartolomeun e asaj kryevepre.

Dihet që i ashtuquaituri «Portret i Ariostos» i Ticianit, që mund të jetë autoportret, ndodhet në Amsterdam në vitin 1630. Në të njëjtën kohë aty u shit edhe «Baltasar Kastilione» i Rafaelit. Rembrandti e ka parë atë dhe më 1639 bën ofortin

«Autoportret në dritare», ku përsërit qëndrimin e Kastiliones. Një vit më vonë, 1640, ai e kthen këtë autoportret në pikturë, duke imituar veshjen e Ariostos. Ndërsa më 1643 bën një portret, «Burrri me skifter», që të kujton pikërisht Arioston.

Tabloja «Vetëvrasja e Lukrecias», e realizuar nga Rembrandti më 1664, është nisur në mënyrë të qartë nga figura e éngjellit të skulpturës së Berninit «Dalldia e Shën Terezës». Te vendosja dhe vizatimi i kufomës në tablonë e Rembrandtit «Leksioni i anatomisë së doktor Johan Dejmenit» nuk është vështirë ta zbulosh personazhin e famshëm të Mantenjës, të parë në perspektivë. Në inventarin e Rembrandtit gjenden të regjistruara gjashtë dosje me riprodhime të vizatimeve të Rafaelit, të cilat i ka studiuar me vëmendje, gjë që e vërteton ndërtimi i tablosë «Roja e natës». Rembrandti kopjoi tërësisht, me qëllim studimi, «Shpifjen e Apelesit» të Mantenjës dhe shfrytëzoi ofortin e tij, «Virgjëresha dhe fëmija», për një vepër ku virgjëreshën e gjejmë të veshur me rroba të kohës së Rembrandtit.

Skulpturat antike mjeshtri i studionte me kujdes, sic e tregon edhe një bust që e kishte blerë mjaft shtrenjtë dhe që e ka vendosur më vonë në një pikturë, ku një nxënës shkolle është duke sditur bustin e Homerit.

Kështu, Rembrandti jo vetëm që mësonte nga klasikët, por as që përpiquej ta fshihte këtë.

* * *

Rembrandti ishte antiklasik.

Vitet e para të jetës në Amsterdam Rembrandti u përpoq t'ua përshtaste pikturen shijeve

të borgjezisë tregtare dhe patricëve të qytetit. Arriti të bënte emër shumë shpejt si portretist. Megjithatë, portretet e tij janë më realiste nga ato të kolegëve të tij. Rembrandti i ri i përkiste shkollës së Utrehtit, e cila ndiqte mësimet e piktures së Karavaxhios.

Karavaxhioja ishte mjeshtër i madh i pikturnës italiane të fillimit të shekullit të 17-të. Ishte njeri i çuditshëm, me shpirt të egër. Në galerinë Ufici të Firences ndodhet një pikture e tij që paraqet kokën e Meduzës. Ajo tregon një pamje të tmerrshme, të neveritshme. Cinizmi i modelimit të kësaj ftyre në agoni, i gjarpërinjve në flokët e saj, i qafës së prerë, nga ku shpërthen gjaku si shatërvan, pamja e lemerishme e syve të devijuar të kësaj koke që nuk ka trup, s'ka kufi. Dhe megjithëkëtë, ne e pranojmë këtë pikture ngjethëse si krvevenë arti për vërtetësinë tronditëse dhe për forcën gjeniale të realizmit të saj.

Pas manierizmit të pambarim dhe mërzisë së imitimeve të rilindjes, si për ironi duhej të dilte pikërisht nië artist i llojit të Karavaxhios, noksan, sherrxhi dhe që nuk e pati për gjë të vrasë me thikë partnerin e tij në tenis, për t'i dhënë pikturnës italiane dhe evropiane një goditje shtytëse të rapritura, që ishte një shock i vërtetë. Praktika e tij e re e të piktuuarit nga modele natyrore bëri një revolucion të vërtetë, që u përhap shpejt dhe pushtoi tërë Evropën. Qe kjo lloj pikture që e bëri për vete Rembrandtin e ri, i cili nuk ngjante aspak me Karavaxhion si njeri, por që në temperamentin e tij artistik i kishte disa prirje që afroheshin me pikturen e mjeshtrit të madh. Dëshira për të bërë përshtypje, për të tronditur, për të kundërshtuar stilizimin ideal, që kamuflonte të vërtetën jetësore, qenë tipare që e dallonin. Dhe prirjet e tij janë shfaqur edhe para se ai të njihej me ve-

prën e Karavaxhios. Ai vizatonte trupin e lëshuar të një gruaje që lahet, dhe e quan me emrin e perëndeshës antike të bukurisë, «Venera». Në Dresden ndodhet një pikturë e Rembrandtit e titulluar «Rrëmbimi i Ganimedit». Është 1,715x x1,30m. Një fëmijë, që ka qenë duke ngrënë qershë, e rrëmbejn shqiponja e dërguar nga Jupiteri. Realizimi i nudos së fëmijës topolak, lemeria e fytvrës së tij të ngërdheshur prej tmerrit, këmisha që i është mbledhur e që zbulon trupin e brishtë fëmijëror me harqet e barkut, të të ndejnurave, të këmbëve në përpëlitje, urinimi nga frika, që Rembrandti e ka piktuuar me qartësi të panevojshme, të gjitha këto janë nënvizuar me ëdhej. Në po atë vizatim të Mikelanxhelos, nga i cili Rembrandti është frymëzuar për figurën e Ganimedit, ndodhet dhe një qen me qafore, i cili është vizatuar në çastin e një akti të natyrshëm fiziolgjik, që mund edhe të lihej të nënkuptohej. Rembrandti merr dhe e fut këtë motiv në një tablo të tij, duke ndier kënaqësi cinike të dyfishtë, ngaqë e ka zbuluar këtë motiv pikërisht te Mikelanxhelloja. Piktura e vitiit 1636 e Rembrandtit, «Verbimi i Samsonit», është shprehja e asaj dëshire për të tronditur dhe e ndikimit të egërsisë së Karavaxhios. Nga ana tjetër aio, sikurse gjithë shembujt e tierë të krijuimtarisë së tii, janë protestë kundër artit klasik, kundër idealizimit dhe manipulimit klasik të së vërtetës nierëzore. Dhe në këtë pikë ai e teikalonte shumë Karavaxhion, i cili, me gjithë prirjet e tij të forta realiste, mbetet një nip i Rilindjes Italiane, d.m.th. një artist i modelimit plastik. Rembrandti nuk preokupohej shumë për korrekësinë dhe saktësinë e vizatimit, ose për ekuilibrin plastik. Nga ana tjetër, ai ishte njeri i butë, shumë human, dhe nuk kishte se si të mos ndryshonte rrënjoshtë nga Karavaxhioja.

* * *

Po riprohjojmë dy dëshmi të kundërshtarëve të tij. I pari është Joakim van Sondrart, piktor që endej nga një oborr mbretëror në tjetrin. Ai thotë se Rembrandti ishte njeri pa kulturë, që nuk e kishte parë kurrë Italinë dhe as vendet e tjera ku mund të studiohen antikiteti dhe teoria e artit. «Rembrandti, — vazhdon ai, — nuk ngurronte t'i kundërshtonte rregullat tonë të artit, si p.sh. anatominë dhe përpjesëtimet e trupit të njeriut, si dhe dobinë e statujave klasike».

Baldinuçi ishte italian, historian arti. Ai shkruan: «Fytyra e shëmtuar prej plebeu, e Rembrandtit shoqërohej nga rroba të mbajtura keq e të papastras, sepse e kishte zakon që, kur punonte, fshinte penelat në trup. Dhe kur punonte, ai nuk do të pranonte të priste as monarkun më të fuqishëm të botës». «Arsyeja është, — vazhdon Sondrarti, — se ai nuk dinte ta mbante pozitën e tij në shoqëri, ai shoqërohej me rangjet e ulëta, gjë që e pengonte në punë.» Ndoshta ligësia është më e mprehtë nga dashuria. Është krejt e vërtetë që Rembrandti, ky gjeni i pikturës holandeze dhe botërore, qe i thjeshtë. Ai i donte njerëzit e thjeshtë dhe të varfër të popullit, shoqërohej dhe rrinte me ta. Një nga autoportretet e tij të para na e tregon Rembrandtin si endacak dhe lyspar, si një nga ata që ai i konsideronte shokë. Dhe këtë simpati për njerëzit e rangjeve të ulëta ai e kishte para se të njihej me pikturen e Karavaxhios, ashtu siç e kishte në gjak përbuzjen për shoqërinë konvencionale, për normat e ngrira të pikturës zyrtare, si dhe për modën asketike të veshjeve të kohës. Ishte protestë dhe sfidë origjinale që i bënte ai shoqërisë së patricëve tregtarë, kur vi-shej dhe e pikturonte veten dhe Saskian e tij me

lloj-lloj kostumesh gjoja historike, por në të vërtetë fantastike dhe dekorative. Kjo përbuzje përkufizimet estetike është po aq e fortë, sa dhe passioni i tij i papërmabjatur përliri qytetare, përliri të mendimit e të ekzistencës. Rembrandti ishte i lidhur ngushtë me fatet e popullit dhe të atdheut të tij, me fatet e njeriut të thjeshtë. Ky është edhe burimi i vërtetë i forcës tronditëse të artit të tij. Rembrandti jetoi, u formua dhe u zhvillua në një periudhë kur Holanda kishte arritur të bëhej një shtet mjaft i fuqishëm kolonial. Por ai e jetoi edhe kohën e rritjes së pandërprerë të pakënaqësisë së masave popullore të tradhtuara nga borgjezia e pasur tregtare, nga byrgerët patricë, të cilët e shtonin nga dita në ditë shfrytëzimin dhe pushtetin e tyre. Rembrandti jetoi dhe punoi edhe në kohën kur shpërthyen trazira të mëdha dhe ndeshje të drejtovërdrejta me pushtetin e borgjezisë në Lejden. Amsterdam etj. Nuk është rastësi që pikërisht në kohën kur ai ishte në kulmin e lavdisë së tij, kur shoqëria «e lartë» e Amsterdamit ia pëlgente dhe ia vlerësonte sa s'kishte ku të vinte më pikurat e tij, në periudhën e fundit të viteve 30. Rembrandti afrohet me sektin e menonitëve, të cilët shpallnin të drejtën e interpretimit të lirë të dogmave fetare. Dhe pikërisht në këtë kohë ai pikuron, krahas porosive zyrtare, edhe dy tablo, «Predikimi i Joan Pagëzorit» dhe «Cudia e vreshtarit», të cilat përshkohen nga simpatia e thellë ndaj popullit të thjeshtë.

Kështu e kuptojmë dhe e shpjegojmë ne edhe antipatinë e Rembrandtit për normat klasike të ndërtimit në art. Jo vetëm është qesharake të thuhet që Rembrandtit i mungonte kultura, por ai ishte artist me kulturë vecanërisht të thellë. Pa qenë nevoja të përmendim faktin që i ati, sidomë që mullixhi, e dërgoi të birin në universitet që

pësëmbëdhjetë vjeç, ai studioi me vëmendje gjatë tërë jetës së tij krijuese si mjeshtrat e mëdhenj të së kaluarës, ashtu edhe idëtë filozofike të kohës së tij. Ai kishte miqësi me njerëzit e shquar dhe të ditur të Amsterdamit, me Jan Siksin, me Jan Vosin, Nikollas Brejningun etj. Duke ndjekur me vëmendje krijimtarinë e Rembrandtit, mundohem i të dallojmë kur mësoi ai nga arti klasik dhe kur u kthye kundër tij. Mirëpo një renditje të tillë s'e gjeljmë dot. Rembrandti mësonte nga klasikët më tepër se çdo piktor tjetër i Holandës, pikërisht atëherë kur që i mprehur kundër artit klasik si asnjë tjetër. Duke u tallur me interpretimin klasik të së vërtetës jetësore, ai tallej me epigonët e artit klasik, të cilët nuk dinin ta vlerësonin në mënyrë dialektike artin klasik; me ata që gjëzonin një përkrahje përherë më të madhe e të pamerrituar, ndërkohë që arti i tij pëlqehet përherë e më pak dhe tablotë i kthetheshin përherë e më shvesh përfrymën e tyre të papranueshme. Dhe, pikërisht në këtë kohë, askush nuk që në gjendje në Holandë ta vlerësonte dhe të nxirrte nga arti klasik i Rilindjes së Lartë përfitime dhe mësimë të mëdha sa Rembrandti.

Rembrandti ishte realist i lindur, një gjeni i bokrahasueshëm, forca e pashembullt e të cilin nëndronte pikërisht në konvertimin e drejtpërdrejtë artistik të realitetit. Pikërisht këtë vlerësoi ai te Karavaxhioja, sensin realist që gjeti te paraardhësi i tij i madh, sens oë përputhei me orrjen e atii vetë. Figurat e Rembrandtit nuk janë të rëndësia me përsosmërinë e tyre fizike, siç mund të na tërheqin figurat e Rafaelit, të Leonardos, të Pusenit, të Engrit, ose statujat e Fidias. Rembrandtit nuk i bëjnë përshtypje të metat e jashtme, kur zbulon te modeli i tij një shpirt aktiv, të pasur, që u përgjigjet dallgëve të shpirtit të tij.

Për Rembrandtin, që ishte njeri ëndërrimtar dhe me shpirt të revoltuar, ndjenja klasike e harmonisë dhe e ekuilibrit viente pér aq sa i shërbente madhështisë së vizatimit të tij. Ajo qe pér tē si një urtësi e madhe e trashëguar, që i nevojitej gjenisë së tij pér të vënë rregull në pasurinë e jashtëzakonshme të zbulimeve të tij dhe pér tē nxjerrë efekte të skajshme vizive pa shpenzime të tepërtë. Urtësinë klasike të artit ai e respekton vetëm me kusht që të mos frenohej në asnjë rast forca e perceptimit të tij gjenial. Siç thamë, Rembrandti ishte gjeni i konvertimit të drejtpërdrejtë. Për tu bindur pér këtë, mjafton tu hedhim një sy vizatimeve të tij të shpejta nga realiteti. Ato nuk marrin parasysh asnjë rregull e asnjë traditë, nuk janë të kushtëzuara nga asnjë lloj pedantizmi anatomic ose estetik. Skicat nga natyra janë regjistrime të pakrahueshme të së vërtetës së jetës në art nga dorë mjeshtri. Veçanërisht impreisionuese janë krijimet e periudhës së fundit të Rembrandtit.

Në përgjithësi është një nga detyrat më të vështira në pikturën realiste t'i integrosh në një tërësi homogjene elementet e interpretuara të ngjyrës, të tonit, të dritës, të vizatimit dhe të gjetit piktorik. Për shumicën dërrmuese të piktorëve në botë mbetet përfjetësisht vetëm një ëndërr, drejt së cilës ecin, por nuk arrijnë kurrë. Sepse, edhe duke vepruar më vete ose në grupe të shkëputura, këto elemente shprehëse japid efekte të fuqishme të pasqyrimit realist. Në veprat e kësaj periudhe të fundit, te Rembrandti, gjemjë pikërisht një integrim të tillë, një bashkëveprim të njëkohshëm, të organizuar në mënyrë të përkryer të dritës, të ngjyrës, të teksturës dhe arkitekturës së tablosë. Si edhe më parë, ai vazhdon t'i rezervojë një vend të madh gjysmëhiges dhe

higes në kuadrin e tij, vazhdon të modelojë me penelata goldlight mbi të errtën e ngjyrashme. Por tashmë e përgjithshmjë ka fituar më tepër pushtet në vizionin e tij. Është ajo shkallë thjeshtësie e shprehjes që e kanë vetëm gjeniu dhe fëmija; fëmija nga naiviteti, ndërsa gjeniu ngaqë i ka njojur së vërtetës jo vetëm lulet dhe gjethet, por edhe rrënjet. E përgjithshmjë piktorike e tablove të periudhës së fundit të piktorit është zhvillimi me thjeshtësi gjeniale i një strukture jashtëzakonisht të pasur. Shpërthimet e dritës janë në të njëjtën kohë shpërthime të ngjyrës dhe të tekstrurës. Dhe nga një përqendrim i tillë i forcës goditëse të të gjitha elementeve të shprehjes arrihet një fuqi emocionale e jashtëzakonshme.

Nga ana tjetër, agresiviteti i mëparshëm i pikturës së tij zbutet, thellohet përqendrimi filozofik dhe jehona shoqërore e mendimit të tij artistik. Rembrandti është një nga piktorët e rrallë që e kanë vlerësuar njësoj si anën vizive, ashtu edhe atë psikologjike të veprës në tërë krijimtarinë e tij. Por veçanërisht të dukhëm dhe në një kuptim të ri e hasim këtë në veprat e periudhës së fundit. Tablotë e tij të viteve 60 kthehen në ansamble të vërteta emocionale-psikologjike. Qetësia filozofike që fitoi Rembrandti në jetën dhe në artin e tij të periudhës së fundit, nuk është shenjë e lumturisë, por e dramës së thellë vetjake dhe shoqërore.

Katastrofa financiare që kishte pësuar më 1656, e kishte lënë jo vetëm pa koleksionin e tij të madh e të shtrenjtë, që përfundoi në duart e kreditoreve të shumtë, por edhe krejt të varfër. Nga gruaja e tij e parë Saskia, e cila pati vdekur fare e re, si dhe nga Hendrika Stoffels, që vdiq më 1663, kishin mbetur vetëm kujtimet. Edhe shtëpinë në Rozengraht detyrohet ta lërë pér të kaluar

në një shtëpi të vogël e të ngushtë në Llaurir-graft. Më 10 shkurt 1668, djali i tij i shtrenjtë, që i qe bërë krahë në mjerim, martohet dhe po atë vit vdes. Rembrandti mbetet vetëm me Kornelian, vajzën e tij dhe të Hendrikës, që ishte në këtë kohë 15 vjeç, si dhe me nusen e re të ve të Titusit, Magdalënën, e cila nuk kishte simpati përmjeshtrin plak. Një vit më pas Titusit, më 4 tetor 1669, gjeniu më i madh i artit holandez të të gjitha kohërave dhe më i madhi piktor që ka njo-hur bota, «heretiku i parë i pikturës», vdes. Katër ditë më vonë e varrosën pa asnjë ceremoni. Në inventarin që iu bë pas vdekjes pasurisë së tij, doli se kishte vetëm një kostum, veglat e piktorit dhe asgjë tjetër.

MIKELANXHELO BUONARROTI

«Dashuria është gjëja më e parëndësishme në botë, që nga çasti kur pushon së qeni më e larta»

VIKTOR HYGO

Mikelanxhelojë lindi më 6 mars 1475 në Kapreze, pranë Firences. Ai u rrit dhe u formua nën ndikimin e ideve humaniste të Dantes, të Pétrarkës, të Bokacios, me mësimet e Anxhelo Policianos, Marsisio Fiçinos, Piko dela Mirandolës. Ky botëkuptim humanist përputhej plotësisht me prirjet e natyrës së Buonarrotit të ri ndaj mendimeve të thella dhe pastërtisë morale ideale. Duke qenë skulptor i lindur, talenti i tij u formua në shkollën fiorentine, në shqipëri me veprat klasike të artit të Greqisë së lashtë dhe të Romës. Në përputhje me natyrën e tij prej artisti të bukurisë plastike, sikurse edhe Leonardo da Vinci me Rafaelin, Mikelanxhelojë e shikonte botën nëpërmjet normave klasike të kësaj bukurie. Por, duke qenë një personalitet i jashtëzakonshëm, nëpërmjet shijes klasike dhe mendimit rilindës, ai zbuloi një skulpturë, që nuk është ajo e lashtësisë greke ose romane, por e një bote të re, e periudhës

moderne të historisë së artit, që fillon me rilindjen. Jeta e Mikelanxhelos njozu dy tablo të ndryshme, të lartësimit dhe të rënies së përgjithshme politike, morale dhe shoqërore. Dhe, meqenëse çdo krijimtari artistike është jo vetëm shfaqje e individualitetit dhe e gjenialitetit të artistit, por edhe prodhimi i një kohe të caktuar, i një epoke të caktuar dhe i një mqedisi të caktuar, në krijimtarinë e Mikelanxhelos gjajnë jehonë të thellë si entuziazmi heroik, universaliteti dhe madhështia fizike e morale e botëkuptimit rilindës, ashtu edhe drama njerëzore, tragjizmi dhe fataliteti, pasoja të rënies dhe degradimit shoqëror.

Ndërsa bukuria e lartë plastike e modelimit mikelanxhelesk është shprehëse e pastërtisë morale dhe e idealizmit të artistit. Papajtueshmëria fatale ndërmjet éndrrës së tij dhe realitetit të zhveshur gjen shprehjen e saj në një figuracion plastik, që është kundërt i gjallë, e tillë që nuk ia gjen shoqen në artin antik. Kjo është vepra e tij, që nuk është as antike e as klasike, por individuale dhe që shërbeu gjer në ditët tona si themeli më i plotë i çdo gjëje të mirë që ka arritur skulptura realiste. Ideja për ta futur veprën e Mikelanxhelos në skedat e manieristëve frymëzohet nga vlerësime formaliste dhe nuk ka asnje lidhje me ndërtimin mendor dhe natyrën thellësisht jetësore të krijimtarisë së tij. Asnjë artist i madh nuk ka qenë manierist. Pasi kishte parë kryeveprën e Mikelanxhelos, «Kapela Sikstina», Gëtja tha: «Nuk jam më në gjendje të ndiej ndonjë kënaqësi nga realiteti, sepse nuk jam i zoti ta shikoj me sy kaq të hapur sa të Mikelanxhelos.»⁴

Megjithatë, jeta për të nuk qe e lehtë... Atij iu desh të luftonte pa pushim, në fillim me të

1. Romen Rolan — «Jeta e Mikelanxhelos»

atin, pastaj me mësuesit e papërshtatshëm, me papen e gjithëpushtetshëm, me Bramanten dhe intrigat e tij të holla, me Antonio san Galon për projektin e Shën Pjetrit, me rreziqet e panumërtë te gjithfarshme dhe të gjithanshme. Por ai ishte jo vetem një artist i jashtëzakonshëm, por edhe njeri i pamposhtur, ndonëse e vëtmja armë e tij që talenti. Më 1520 Sebastiano del Piomboja i shkruante Mikelanxhelos: «Ju tmerroni cilindo, madje dhe papen vetë.» Dhe vërtet, Leoni X e po-honte se Mikelanxheloja «è terribile, non si può praticar con lui» (është i tmerrshëm, më mirë të mos kesh punë me të). Ai e detyroi papen të flasë me të si me të barabartin. Aspak servil, ai nuk dinte t'i fshihe ndjenjat dhe mendimet. Temperamenti i zjarrtë dhe i rrëmyer, që ishte burim forcë kolosale për artin e tij, e bënte shumë herë të vuante nga pasojat e papritura në shoqëri, sepse ai dallohej nga «per non mi esser saputo» (nga paaftësia për ta zotëruar veten), siç thoshte vetë. Bënte një jetë të kursyer, thuaj prej asketi, dhe të vëtmuar. Ishte punëtor në shkallë të pabesueshme, flinte pak dhe në moshën 37 vjeç dukej si plak, Megjithatë kishte një trup mjaft të fortë dhe brenda atij trupi jetonte një vullnet i hekurt. Qe i butë vetem me njerëzit e thjeshtë. Ndihmësít dhe nxënësit e tij habiteshin me bujarinë e tij. «Nuk ka lindur ende ai njeri që të jetë kaq i prirur për t'i dashur njerëzit sa unë», shkruan artisti. Më mirë se kudo kjo shprehët në krijimtarinë artistike, ku Mikelanxhoja është antropocentrik, në kuptimin më të skajshëm të fjalës. Gjithçka kërkon ta shprehë nëpërmjet figurës së njeriut. Kjo e vërtetë shtrihet gjer në pikturat e tij të mëdha monumentale, ku nuk tregon asnjë vëmendje të vërtetë për peizazhin dhe mqedisin ku veprojnë personazhet e tij.

Më 1496, kur qe vetëm njëzet e një vjeç, Mikelanxheloja krijoj skulpturën e Bakut, të perënkelanxheloja së verës dhe të vreshtarisë, e cila i doli kaq klasike, saqë Jakopo Gali mori dhe e vendosi në mes të koleksionit të tij të famshëm të skulpturave antike, ku ajo qëndronte fare mirë. Kjo ishte veprat e parë si dhe e fundit vërtet klasike e Mikelanxhelos.

Asnjë vepër tjetër nuk mund ta përfaqësojë më mirë Buonarrotin e ri sesa statuja e Davidit, të cilin ai e punoi nga 1501 deri në prill 1505. Davidi ishte një hero biblik, që pati mundur Goliatin, mbrojti popullin e tij dhe e udhëhoqi me urtësi dhe drejtësi. Përfytyrimi i këtij heroi të lashtë qe kthyer për njerëzit e rilindjes në një simbol të patosit dhe heroizmit qytetar, Mikelanxheloja e paraqiti Davidin të zhveshur, duke theksuar kështu kuptimin etik që kishte kjo në artin antik. Davidi i tij qëndron i qetë, i sigurt dhe fisnikërisht krenar. Fytyra e tij e bukur dhe burrëore, torsi i fuqishëm rino dhe gjymtyrët e modeluara përsosmërisht jo vetëm që janë madhështore, por transmetojnë forcën e tij të brendshme shpirtërore. Te Davidi gjejmë të gjitha karakteristikat kryesore të modelimit mikelanxhesk të kësaj periudhe, ndjeshmérinë e jashtëzakonshme dhe përqueshmérinë e lartë të konvertimit, zotërimin absolut të objektit, seleksionimin intransigjent, vitalitetin e rrallë, të arritur si në ndërtimin e përgjithshëm, ashtu edhe me hollësira, të rrëmbyera natyrës «sy në sy», dhe të vëna në shërbim të plotë të imazhit të artistit. Modëlimi i tij rivalizon me sukses natyrën, duke e tejkaluar atë. Dhe e gjithë figura pëershkohet nga një frymë e re, që nuk e gjen as te helenët e lash-të, as te romakët, nga fryma e humanizmit të thellë dhe ngrohtësia e rilindjes. Davidi nuk është

as Apoloni, as Hermesi, por një hero më i afërt për ne dhe më i kuptueshëm, një hero i kohës sonë.

Kur Mikelanxheloja filloi të piktoronte «Kapelat¹) Sikstinë» në Vatikan, ishte tridhjetë e tre vjeç. Puna e tij krijuese mbinjerëzore zgjati që prej majit 1508, deri në dhjetor 1512. Tavani ishte 40.23 m i gjatë dhe 13.41 i gjatë. Punonte në skela të larta, shtirë në kurriz, me bojën që i rridhte shpesh mbi fytyrë, dhe me papën që e bezdiste sa nuk kishte ku të vinte më me padurimin e tij.

Në figurat e tavanit të Sikstinës, si dhe në mënyrën origjinale si e koncepton Mikelanxheloja pikturen e vet, dallojmë menjëherë skulptorin. Mjeshtri kishte mendimin se «piktura del më e mirë kur anon më shumë nga reliivi skulpturor, ndërsa reliivi del më mirë kur priret nga piktura. Dhe me të vërtetë, te skulptura pikërisht e kanë burimin ai plasticitet i mrekullueshëm e prekës, ai kondensim që arrin brenda secilës figurë, grup ose ansambël piktorik. Në mënyrë të pakrashueshme nxirren nga trupi i njeriut mundësitet e skajshme të vizatimit e të plastikës. Zhvillimet e reja dhe zbulimet kanë dëshmuar për degëzime dhe fusha të tjera të mundësive të pakufishme që afron realiteti objektiv dhe materia, por nuk kanë mundur të afrojnë ndonjë platformë të re në këtë fushë të arritur nga Buonarroti.

Kështu, përparrë ansamblit gjigant piktorik të tavanit të «Sikstinës» bindemi se ndodhemi para një shembulli unikal në gjithë historinë botërore të artit realist, ku piktura fryshtohet plotësisht nga skulptura dhe operon me sukses me mjetet e plastikës, në një mënyrë që nxjerr vetiu të tepert

1. kapella (ital.) — kishë e vogël, kishëz.

çdo gjë të dorës së dytë tradicionale të pikturës. Në këtë mënyrë, vërejtja e famshme kritike e El Grekos për këtë kryevepër të fiorentinasit të madh është e vlefshme vetëm pér të vërtetuar se edhe gjenitë janë të njëjanshëm dhe subjektivë kur janë artistë. Pér të dhënë sadopak një përshtypje të asaj që ndien shikuesi duke parë këtë vepër të Mikeianxhelos, na duket e lejueshme të perifrazojmë: «E ndjeva veten të pushtuar nga pa-sione mbinjerëzore. Frymëmarrja e fuqishme e dikujt përtérinte frymëmarrjen time, më mbush-te me gëzim dhe pikëllim, që të dyja njësoj të dobishme, sepse dhe këto dhe ato çlrojnë forcë, dhe forca është përherë gëzim. Më dukej sikur shkulën prej meje zemrén time fëmijërore dhe ma zëvendësuan me një zemër hero» (R. Rolan).

Figurat e të rinjve, të piktuar këtu nga Mikeianxheloa, janë nga arritjet më të shkëlqyera të artit të rilindjes dhe të artit në përgjithësi. Ideali plastik i gjenisë së tij qe trupi i njeriut në rini, i zhvilluar përsosmërisht. Nuk është rastësi që nga dalta e tij doli një etalon i tillë i bukurisë dhe i forcës djaloshare si «Davidi». Trupi rihor i zhvilluar harmonikisht i një djali të ri e entuziazmonte Mikeianxhelon si artist njësoj sic e frymëzonte dhe e trondiste gjeninë e Rafaelit pamja e mrekullueshme dhe fisnike e një vajze a gruaje të re. Ashtu sic mund të nxirrte Rafaeli nga një model i tillë i gjallë një madonë-trupëzim të bukurisë, të mençurisë dhe fisnikërisë ideale fémërore, ashtu ishte në gjendje të nxirrte Mikeianxheloa (dhe vetëm ai) nga një djalë i ri modelin ideal të rinisë, të pastërtisë dhe të shpirtit heroik të rilindjes.

Një nga kompozimet më të bukura të këtij ansamblit piktorik është «Krijimi i Adamit». Dora e zgjatur e perëndisë, që i transmeton gjallërinë

materies së pajetë, sa e ka prekur dorën e Adamit, i cili, i shtrirë përtokë, nis të zgjohet nga gjumi kozmik dhe të kalojë nga forma e pajetë, në formën e gjallë. Pikërisht kjo pikë kohore e kalimit nga forma e vdekur në formën e gjallë, që nënkupton dhe të anasjelltë, kufirin e qenies me mosqenien, është këtu zbulimi më i madh ideoartistik i gjenisë poetike të Mikeianxhelos. Është një motiv që përsëritet nga ai tërë jetën, në çaste të ndryshme, në kohë të ndryshme dhe përbën lajmotivin e vërtetë të veprës së tij. Adami është trupi burrëror dhe elegant i mashkullit, ku s'ka asgjë vulgare dhe sensuale, ku çdo gjë është filtruar gjer në ideal, dhe në të njëjtën kohë ruan origjinën e tij. Me të drejtë, piktori gjerman Cornelius ka thënë pér këtë figurë se «që nga époka e Fidias, nuk është krijuar një figurë tjetër kaq e përsosur».

Gjatë dhjetëvjeçarit të dytë të shekullit XVI u krijuan statujat e dy skllavërve, si dhe ajo e Moisiut, të caktuara pér varrin e Julianit. Pa qëndruar te Moisiu, i cili është gjithashtu një kryevepër po përqendrohem më tepër te të dy skllavërit, që janë menduar dhe realizuar të soditen në kontrast dhe unitet me njëri-tjetrin. Vetë ideja e këtij uniteti dhe e mundësisë së pakufishme që fal ky unitet i të kundërtave, si dhe zhvillimi i secilës figurë në vecanti, është thellësisht poetike dhe karakteristike pér Mikeianxhelon. Duke qëndruar dhe konkretizuar ide të planit universal, me rëndësi të përgjithshme njërezo, Mikeianxheloa realizon te «skllavi që ngre krye» pasionin e papërbajtur pér liri, një shpirt heroik të trupëzuar në një figurë muskuloze të paraqitur në një tension të skajshëm. Është çasti para cilimit të plotë nga skllavëria, çasti i shpërthimit, por edhe i gjendjes së qenësish së robërisë, e

cila nuk durohet më. Fitorja është e padyshimtë, por edhe skllavëria mbetet ende realitet. Gjendje të tilla dualiteti gjemë vetëm tek artistët e mëdhjenj dhe janë shprehje e përqendrimit poetik në shkallën më të lartë, të pastruar nga çdo rastësi. Kënaqësia e thellë estetike që na fal Mikelanxhelova me pasurinë e madhe të plastikës që zbulon kjo figurë në pika të shumtë dhe të ndryshme të shikimit, buron nga zhvillimi i gjërë dhe i shumanshëm që arrin t'i japë mjeshtri idesë së tij. Në kontrast me figurën e parë, «skllavi që vdes» dalohet nga një brishtësi dhe gjendje tjetër. Koka që varet prapa, dora dhe krahu i majtë ngritur lart, që mundohet ta mbajë atë, sytë e mbyllur, e djathha që prek me dëshpërim kraharonin, ku zemra jep goditjet e saj të fundit të jetës së këtij trupi të ri, të gjitha flasin për një hero të dënuar me vdekje, për një qenie që kaq në mosqenie, për një jetë që ndërpritet tragjikisht dhe që është e bukur në mënyrë të pikelluar, e përsosur, në fqinjësi me vdekjen. Fytyra është e bukur dhe burrërore, ajo të prek me qetësinë e saj dhe të trondit me fatalitetin e shprehjes. Dhe megjithatë, te Mikelanxhelova edhe rënia është madhështore. Tragjikja zbërthehet nga mjeshtri gjenial me një mjeshtëri dhe madhështi, që nuk ia gjen shoqen në tërë artin e rilindjes.

Nuk dimë si punonte Mikelanxhelova. Pak gjëra që janë mbajtur shënim, nisen nga ato dëshmi përherë të diskutueshme që na kanë lënë bashkëkohësit, nga plotësimet edhe më të diskutueshme që na kanë lënë studiuesit më vonë etj. Dhe sa për atë vetë, ai i ka djegur në dy raste materialet e tij përgatitore, gjithë fondin e «përpunimit laboratorik» të veprave të tij, një herë më 1518, sa mbaroi tavanin e «Sikstinës», dhe herën tjetër pak ditë para se të vdiste. Dhe ishte një

fond tepër i madh, me vizatime, skica, etyde, kartona të një vlere të pallogaritshme. Ndaj të dhënët për të janë nxjerrë në mënyrë të tertiortë, duke iu referuar fakteve të veprës dhe të biografisë së tij.

P.sh., dihet se në tërë jetën e tij të gjatë Mikelanxhelova takoi vetëm një herë një djalosh, bukuria dhe fisnikëria e të cilit i bëri përshtypje të thellë. Ky ishte Tomazo Kavalieri, nga një familje me emër të mirë e qytetit të Romës. Nga Vazari dimë që «...Mikelanxhelon e tmerronte qoftë dhe ideja që të vizatojë një njeri nga natyra, me përashtim të rastit kur modeli ka një bukuri të jashtëzakonshme». Me Kavalierin u njo'hën më 1532. Ai ishte një djalë mjaft inteligjent dhe me pasion të fortë për artin. Miqësia e tyre vazhdoi më tepër nga tridhjetë vjet. Megjithatë nuk dihet ndonjë vepër e mjeshtrit ku ai ta ketë paraqitur me besnikëri portretin e tij. As portreti i Vitoria Kolonës, kësaj gruaje të jashtëzakonshme, që zuri një vend të madh në gjysmën e dytë të jetës së Mikelanxhelos, nuk i përgjigjet portretit të saj të vërtetë, dhe është më tepër një përfytyrim ideal.

Në vitet 30 Mikelanxhelova punoi mbi një grup skulpturash për varret e Mediçeve. Statuja e Lorencu Medicit, sikurse dhe ajo e të vëllait, Xhulianos, nuk ngajnjë fare me Lorencon dhe Xhulianon e vërtetë. Në këto dy skulptura mjeshtri na ka dhënë trupëzimin e natyrës së secilit, të «Njeriut të Mendimit» për Lorencon, dhe te «Njeriut të Venimit» për Xhulianon. Bukuria dhe forca shprehëse e secilës nga këto dy statuja përforcohet shumë nga kundërvënia e tyre e bërë me qëllim nga autori. Këto fakte të krijimtarisë së tij na bindin jo vetëm për qëndrimin e Mikelanxhelos ndaj artit të portretit, por edhe për

raportin origjinal tē atij vetē si artist ndaj modelit. Duhet pranuar qē ai e kuptonte këtë gjë nē mēnyrë thellésisht poetike.

Statujat e Lorenco dhe tē Xhuliano Mediçit shoqérohen nga katér figura tē tjera, tē vendosura nē mēnyrë simetrike dy nga dy. Janē katér figura femerore tē përsosura, qē simbolizojnē «Mëngjesin» dhe «Mbrëmjen» pér Lorencon, dhe «Ditën» e «Natën» pér Xhulianon. Ato nuk ilustrojnē ndonjē program ideor a vepér letrare tē caktuar. Janē simbole tē kohës qē këmbehet përjetësish. Ato kanë, nē tē njëjtën kohë, kuptime tē veçanta, tē trupëzuara nē karaktere po aq tē veçanta, dhe qē tē katra janē një konfirmim i ri i ndjeshmërisë sē tij titanike dhe i dashurisë sē përjetshme ndaj përsosmërisë sē bukurisë njerëzore. Kjo dashuri kthehet te Mikelanxheloa nē kënaqësi tē pakufishme, si dhe nē vuajtje tē thellë nē tē njëjtën kohë, nē një shkallë tē tillë, siç ka ndodhur edhe me natyra tē tjera tepër tē ndjeshme dhe tē fuqishme, si Gëtja dhe Tolstoi.

Térë jetën ai qe i dashuruar, térë jetën ndjeu pushtetin e pakundërshtueshém dhe tē mrekullueshém tē dashurisë. si dhe zgjedhën e saj. Figura e përsosur e një tē riu nē lulëzim, madhështia tronditëse e një gruaje tē re dhe, përbmi tē gjitha, mrekullia e një fytyre, «La forza d'un bel viso» (forca e fytyrës sē bukur), nē tē cilën sytë janë si një përqendrim magjik i gjithë bukurisë sē lartë njerëzore, është objekti i përjetshëm dhe burimi i drejtpërdrejtë i forcës sē gjenisë sē tij.

*La memoria degli occhi e la speranza,
per qui non sol vivo, ma beato...*

O Dio, e son pur belli!

(Kujtimi pér sytë dhe shpresa, pér hir tē tē cilëve jo vetëm jam gjallë, por edhe i lumtur... O zot, sa tē bukur qē janë!),

Sipas vërejtjes sē mprehtë tē Tomas Mannit, përparësia qē u jep syve Mikelanxheloa nē këtë dashurinë e tij tē zjarrtë pér bukurinë e njeriut, e mbush atë me një frymë tē lartë shpirtërore, i përbuz thellésisht ata qē e kuptojnë dashurinë si objekt vetëm tē ndjeshmërisë. Shpirti dhejeta e Mikelanxhelos, sikurse e gjithë krijimtaria e tij pa përjashtim, janë tē mbushur plot me këtë dashuri pértejseksuale, artistikisht platonike tē artistit. Kjo dashuri thellésisht shpirtërore e tij ndaj figurës sē zhveshur njerëzore nuk lakmon trupin dhe nē tē njëjtën kohë, si artist gjenial i bukurisë plastike, ai përulet dhe gjunjëzohet me adhurim pikërisht para këtij trupi tē zhveshur, i cili i zbulon syrit tē tij, nē një formë tē mrekullueshme, bukurinë e përjetshme, dëlirësinë dhe fisnikérinë e shpirtit njerëzor. «Do tē qe turp pér ne po tē dyshonim sadopak nē autenticitetin, ose, më saktë, nē vërtetësinë e lartë tē kuptimit tē tij pér dashurinë» (T. Mann).

«Kur tē vdes, do tē vdes pér dashurinë!»

Këtë pasion tē pashuar dhe platonizëm tē pacenuar tē dashurisë sē Mikelanxhelos pér bukurinë e njeriut, e gjemjë tē trupëzuar qē nē veprat e tii tē para, te «Beteja e kentaurve» dhe «Pieta», te sivilat e mrekullueshme tē Eritresë dhe tē Livilë, dhe te figurat poetike tē tē rinxve tē zhveshur dhe tē Amanit tē kryqëzuar nē tavanin e «Kapelas Sikstina», te «Madona»³ me foshnjën dhe te figurat tragjikisht tē bucura tē «Gjyqit tē fundit», gjer nē fund tē krijimtarisë sē tij.

Katér statujat e varrit tē Mediçëve janë nga më tē bukurat, qē kanë dalë nga dalta e mjeshtrit. «Mëngjesi» shpreh zgjimin e mundimshëm nga gjumi i rëndë. Aurora mundohet tē ngrihet,

3. Madona — e ëma e Krishtit

duke u mbështetur te këmba e majtë, por nuk ka fuqi. Dora e majtë, e cila largon vellon, i mbetet në ajër. Kokën nuk e mban dot drejt. Duke dëshur të zgjohet plotësisht e të ngrihet, ajo thuajse rrëshqet përsëri, gati për t'u fundosur në gjumin e rëndë. Si të rrëshqiste në shtrojën e pjerrët, gjymtyrët e saj rinore shprehin në të njëjtën kohë forcë dhe përgjumje, shprehja e fytirës — zgjimin dhe përhumbjen. Në këtë kontrast ndërmjet trupit vajzëror në lulëzim dhe shpirtit tmerësisht të lodhur, në trupëzimin me gjuhë plastike të përkryer të këtij kufiri ndërmjet zgjimit dhe përhumbjes, ndërmjet jetës dhe vdekjes, qëndron mrekullia e Aurorës së Mikelanxhelos.

Qenë vite të rënda për Italinë dhe për Mikelanxhelon. Në gusht 1530, pas një lufte, në të cilën rrëmbeu edhe ai armët në dorë krahas bashkë-qytetarëve të tij dhe drejtoi të gjitha punët fortifikuese, Firencia, qyteti i tij i lindjes, ra. I tronditur dhe i kërcënuar për vdekje, ai largohet fshehurazi për në Romë, ku jetoi si emigrant. E pushton tmerrri. Për këtë ndjenjë vuan më tepër vetë dhe e përbuz veten. E vëtmja dëshirë e tij është të vdesë. «...Në kohëra të tilla, të trembesh për shpirtin dhe për ekzistencën tënde nuk është aspak keq. Të tremburit nuk pengon kurrë...», shkruan ai. Ishte një rënje e përkohshme shpirtësore në vitet kur u shuan të gjitha shpresat politike dhe qytetare të Mikelanxhelos. Dhe notat dramatike të skulpturave të tij të varrit të Mediciëve i shohim të forcohen më tej, në vepra përherë e më tronditëse.

Ai realizoi për varrin e papa Julianit katër figura «skllevërish», që duken si të pambaruara («non finit»), por që në të vërtetë janë të përkryera. Atë që në pikturë Mikelanxheloja nuk e arrin dot, sepse e pengon natyra e tij prej skulptori

për të njobur deri në fund mundësitet e vërtetë të pikturës, e arrin në skulpturë. Në këto vepra, kundërvénieve, kontrasteve që krijon përmbyllja ai u shton në mënyrë organike kontrastet e skalashme që krijon forma, duke zbuluar edhe një herë arsenalin tepër të madh të mjeteve të shprehjës që zotëron, dhe fantazi e zhërvjelltësi të habitshme. Që nga guri thuajse i paprekur e dëmit modelimet e holla e të lëmuara gjer në përsosmëri, mjeshtri kalon me lehtësi një regjistër të plotë, që nga butësia dhe delikatesa më ëndërrimtare, deri te forca shpërthyese e skjashme e egër. Të katër «skllevërit» janë katër trupa njerëzorë që përpilen të çlironen dhe të shpëtojnë nga materia e ngurtë e pamëshirshme. Zhvillohet lufta tragjike ndërmjet trupit dhe shpirtit, në një përpjekje shkëputjeje për nga drita dhe liria, për nga lumturia. Nga njëra anë trupi i gjallë i skllavit, nga ana tjetër masa e ftohtë, amorfë dhe e pampostur e blloqueve të gurta.

Afreskun «Gjyqi i fundit» filloi ta piktuonte më 1535 dhe e mbaroi më 1541. Në ansamblin e brendshëm të «Kapelas Sikstina» ajo ruan një pamje të pavarur, dhe që në shikim të parë të trondit me dinamikën e saj, si dhe me përmasat e mëdha. Pamja përshkohet tejembanë nga ideja e një katastrofe të përgjithshme. Asgjë nuk i shpëton vorbullës së fatit. Megjithatë, te Mikelanxheloja edhe fataliteti vizatohet në forma heroike dhe madhështore. Personazhet e tij mbeten përherë heronj, por heronj që nuk kanë më shpëtim. Nga kjo ndeshje tragjike ndërmjet idesë thellësisht pesimiste dhe forcës kolosale të shprehjes, lind një tragjizëm krejt i veçantë. «Titanët e tij kanë humbur, të vetmen gjë që e ndihmon njeriun në luftën me forcat e verbra, vullnetin». Manieristët nxorën më vonë, nga figurat e «Gjyqit të fundit»,

lëvizje të gatshme, të shkëputura mekanikisht prej kontekstit të përgjithshëm. Kështu, ajo që te Mikelanxheloja del e fuqishme dhe organike, tek ata del e jashtme dhe formale.

Te «Gjyqi i fundit» mjeshtri vizatoi edhe Shën Bartolomeun, të cilin, sipas Biblës, prej trupit të gjallë i rrjepin lëkurën. Kështu e paraqiti edhe Mikelanxheloja, por në këtë lëkurë të rrjepur nga njeriu i gjallë ai piktuori portretin e tij. Kështu na dha ai, në mënyrë të figurshme, simbolin e vuajtjeve të tij, simbolin e zhgënjimeve dhe të shqetësimeve të tij qytetare.

«Gjyqi i fundit» shkaktoi një reaksion të fortë në qarqet katolike. Kështu, Pjetro Aretinoja shkruante në një nga letrat e tij se afresku i Mikelanxhelos, me trupat e tij të zhveshur, është më i përshtatshëm për të zbukuruar banjën e pa-pës sesa kishën e tij. Më në fund, më 1565, vëtëm një vit pas vdekjes së mjeshtrit, me urdhër të papa Piut IV, piktori Daniel da Volterra i mbuloi trupat e zhveshur me draperi (pala). Këtë pulë të turpshme e vazhduan edhe më vonë.

Një kapitull shumë interesant në krijimtarinë e Mikelanxhelos përbëjnë vizatimet e tij të viteve të fundit, Për nga forca ato mund të krahasonen të fundit, Shovetëm me vizatimet e fundit të Rembrandtit. Shohim që mjeshtri plak ka hequr dorë këtu prej kontrasteve të dritës me hijen, prej kontureve dha linjave të rrepta, prej kontrasteve të bujshme. Karboni i tij arrin një butësi të habitshme, një mjequllsi të veçantë, ndaj të gjitha volumet duken si të rrëthuara nga një atmosferë e lehtë e tejdukshme. Kjo mënyrë, që ishte e jashtëzakonshme për të, e lejonte mjeshtrin të shprehte përmbi letër edhe zhvillimet më të holla të ndjenjës. Kjo ndjenjë e butësisë së papritur dhe e një fokusi më të papercaktuar, shpreh edhe largimin gradual të

mjeshtrit plak nga gjithoka tokesore. Dhe me gjithatë, edhe kjo tërkueje e shpesh ndimtare ruan përmasat e saj grandioze, qënd monumentale, frymën e saj tragjike, shpesh heroikë, gjenisë së tij.

Në figurën e «Natës», të vendosur mihi sadko-fagun e Xhuliano Medicit, Mikelanxheloja pati skalitur njérën nga statujat më të madhë të tij. Për të Xhovani Strocci pati shkruar një epigram:

«Nata që fle kaq embël para teje
një gur i gjallëruar prej engjellit,
është e palëvizshme, por brenda saj

flak' e jetë.
Veç zgjojeni dhe ajo do të flasë.»

Ndërsa Mikelanxheloja iu përgjigj me këtë shënim:

«Caro m'e'l sonno, e piu l'esser di sasso
mentre che l'danno e la vergogna dura;
non veder, non sentir m'e gran ventura;
però nòn mi destar, deh, parla basso!»

Për mua ësht' i shtrenjtë gjumi dhe
edhe më i shtrenjtë të qenët gur,
përderisa vazhdon ligësia dhe turpi;
të mos kesh mundësi të shikosh,
të mos kesh mundësi të dëgjosh,
kjo është lumturia më e madhe;
ndaj mos më zgjo, sst, fol me zë të ulët!»

Dhe megjithatë, duke i dhënë të drejtë padashur Mikelanxhelos, ne largohemi nga ai në kohë dhe në botëkuptim, por duke e ndier veten themësish mirënjohës ndaj gjenisë së tij të pavdekshme.

PËRMBAJTJA

Thjeshtësia dhe larmia e traditës së vjetër	50
Artisti i popullit Odhise Paskali	53
Çfarë bëri dhe çfarë nuk bëri Vangjush Mioja	56
Mjeshtri i piktures Abdurrahim Buza	58
Në përmasa njerëzore	60
Integrimi liriko-epik i dritës	62
Lirizmi që merr jetë dhe gjen forcë të re në format monumentale	66
Shpirti kërkues i artistit	68
Eksposita e Skënder Kamberit	80
Mbi natyralizmin	91
Snobizmi — shfaqje e ndikimit të ideologjisë së huaj	96
Për ngjyrën mund të bëhej më shumë.. .	101
Para dy tablosh	103
Realiteti si ëndërr	104
Shënimë nga një ekspositë	122
Rafaeli	135
Rembrandti klasik dhe Rembrandti antiklasik	141
Mikeianxhelo Buonarroti	151

Blido, LL.

Shënime për pikturën dhe skulpturën.
Artikuj studime dhe ese. [Red.: I. Thoma.]
T., «Naim Frashëri», 1987.

172 f.

(B.m.) dhe
(B.v.): 75.03(496.5)
+ 73.03(496.5)
+ 75.03(4/9)
B. 67

Tirazhi 2000 kopje Format 49x78/16 Stash: 2204

Shtypur: Kombinati Poligrafik
Shtypshkronja e Re — Tiranë, 1987